Instituti për politikë evropiane. Shkup

# RAPORT NË HIJE PËR KAPITULLIN 23

PËR PERIUDHËN TETOR 2022 – SHTATOR 2023



# RAPORT NË HIJE PËR **KAPITULLIN 23**

PËR PERIUDHËN TETOR 2022 – SHTATOR 2023

# RAPORT NË HIJE PËR KAPITULLIN 23

PËR PERIUDHËN TETOR 2022 - SHTATOR 2023

Botues:
Instituti për Politikë Evropiane - Shkup

Për botuesin:
Dr. Simonida Kacarska

Redaktorë:
Dr. Simonida Kacarska
Dr. Ardita Abazi Imeri
M.Sc. Juliana Karai

Autorë:
Angella Delevska-
Beba Zhagar

Përkthyer nga gjuha maqedone në gjuhën shqipen:
Blerina Starova Zlatku

Dizajn grafik:
Relativ

Shkup, dhjetor 2023

Ky raport në hije është hartuar në kuadër të projektit "Ndërtojmë ura për një të ardhme të përbashkët: Sundimi i ligjit në kontekts të anëtarësimit në BE", financuar nga Bashkimi Evropian. Përmbajtja e këtij raporti është përgjegjësi vetëm e autorëve dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se përfaqëson pikëpamjet dhe opinionet e Bashkimit Evropian.

# Përmbajtje:

Hyrje....8
Metodologjia....10

1. Gjyqësori....11
   - Dokumente strategjike....12
   - Organet drejtuese....14
   - Pavarësia dhe paanshmëria....23
   - Përgjegjësi....34
   - Profesionalizmi dhe kompetenca....39
   - Cilësia e drejtësisë....46
   - Efikasiteti....54

2. Lufta kundër korrupsionit....59
   - Kuadri institucional....60
     - Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit....60
     - Prokuroria Publike....63
   - Kuadri ligjor....67

3. Të drejtat themelore....69
   - Praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane për të Drejtave të Njeriut....70
   - Avokati i Popullit....72
   - Tortura ose lloj tjetër i trajtimeve ose dënimeve mizore, çnjerëzore ose poshtërueset....73
   - Burgje dhe paraburgime....75
   - Mbrojtja e të dhënave personale....78
   - Liria e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë....80
   - Liria e shprehjes....80
     - Presion mbi gazetarë....82
   - Grupet e cenueshme dhe parimi i mosdiskriminimit....84
     - Komisioni për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi....84
     - Persona me aftësi të kufizuara....85
   - Gjinia....88
   - Gjuha e urrejtjes....91
     - Veprat e urrejtjes....91
   - LGBTI+....92
   - Romët....94

Bibliografi....97

# Lista e shkurtesave

| | |
|---|---|
| ASHMAA | Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele |
| AMDP | Agjencia për mbrojtjen e të dhënave personale |
| AKMIS | Sistem i automatizuar informatash për menaxhim me lëndët gjyqësore |
| AGJPP | Akademia për Gjykatës dhe Prokurorë Publikë |
| PBB | Prodhimi i Brendshëm Bruto |
| GRECO | Grupi i shteteve kundër korrupsionit |
| ESHS | Enti Shtetëror i Statistikës |
| KSHPK | Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit |
| KE | Komisioni Evropian |
| KEDNJ | Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut |
| ENER | Regjistri i vetëm kombëtar elektronik i rregulloreve |
| EPI | Instituti për Politikë Evropiane |
| ERA | Akademia e së Drejtës Evropiane |
| GJEDNJ | Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut |
| BE | Bashkimi Evropian |
| SHGM | Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë |
| TIK | Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit |
| IRI | Instituti Ndërkombëtar Republikan |
| IRL | Laboratori i Gazetarisë Hulumtuese |
| PPRMV | Prokuroria Publike e Republikës së Maqedonisë së Veriut. |
| KPMD | Komisioni për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi |
| LGBTI | Komuniteti lezbik, homoseksual, biseksual, trans dhe interseks |
| AMSHA | Akademia Maqedonase e Shkencave dhe Arteve |
| MPB | Ministria e Punëve të Brendshme |

për periudhën tetor 2022 – shtator 2023

| | |
|---|---|
| SHMJR | Shoqata Maqedonase e Juristëve të Rinj |
| AIM | Agjencia Informative Mediatike |
| MSHIA | Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës |
| MASH | Ministria e Arsimit dhe Shkencës |
| MD | Ministria e Drejtësisë |
| MRT | Radiotelevizioni Maqedonas |
| MPPS | Ministria e Punës dhe Politikës Sociale |
| OJQ | Organizatë joqeveritare |
| OSBE | Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë |
| PTHP | Prokuroria Themelore Publike |
| PTHPNKOK | Prokuroria Themelore Publike për Ndjekjen e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit |
| RMV | Republika e Maqedonisë së Veriut |
| SHBA | Shtetet e Bashkuara të Amerikës |
| LSDM | Lidhja Social Demokrate e Maqedonisë |
| CEPEJ | Komisioni Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë |
| PSP | Prokuroria Publike për ndjekjen e veprave penale që lidhen dhe rezultojnë nga përmbajtja e monitorimit të paligjshëm të komunikimeve (Prokuroria Speciale Publike) |
| KPPRMV | Këshilli i Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut |
| SPGM | Sindikata e pavarur e gazetarëve dhe punonjësve të medias |
| KGJRMV | Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut |
| DSK | Drejtoria për Siguri dhe Kundërzbulim |
| DULA | Drejtoria për udhëheqjen e librave amë |
| Sindikata e PAOGJSHQ | Sindikata e Punonjësve të Administratës, Organeve Gjyqësore dhe Shoqatave Qytetare të Republikës së Maqedonisë |
| DPF | Drejtoria e Policisë Financiare |
| KHDNJ | Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut |

# Hyrje

Ky raport në hije bashkon në një tërësi të vetme koherente të gjitha gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet që dolën nga monitorimi i fushave të përfshira në Kapitullin 23 – Gjyqësori dhe të drejtat themelore. Ky është raporti i tetë i tillë i publikuar nga Instituti për Politika Evropiane - Shkup (EPI), duke marrë parasysh komentet dhe opinionet e organizatave joqeveritare. Shtatë periudhat e mëparshme mbulojnë periudhat në vijim: tetor 2014 – korrik 2015,[1] korrik 2015 – prill 2016,[2] maj 2016 – janar 2018,[3] qershor 2018 – mars 2019,[4] prill 2019 – mars 2020,[5] prill 2020 – shtator 2021[6] dhe tetor 2021 – shtator 2022.[7]

Raporti mbulon periudhën nga fillimi i tetorit 2022 deri në fund të shtatorit 2023. Në raportin jepen të dhëna që janë relevante edhe para tetorit 2022, kur nevojiten për kontekstualizimin apo sqarimin e risive nga periudha aktuale raportuese, të cilat janë të rëndësishme për periudhën raportuese. Periudha raportuese e raportit korrespondon me periudhën raportuese të Komisionit Evropian (KE) për Republikën e Maqedonisë së Veriut (RMV). Ky draft-raport ndjek strukturën e Kapitullit 23, sipas raportit të KE-së. Në fund të çdo fushe, në kornizë janë ndarë rekomandimet dhe konkluzionet kryesore.

Periudha raportuese u pasua nga përfshirja e vendit në procesin e shqyrtimit, marrja e raportit të shqyrtimit për grupin e parë, “Vlerat bazë”,[8] si dhe përgatitja e dokumenteve strategjike

---

1 Neda Çalovska et al., “Gjyqësori dhe të drejtat themelore në Republikën e Maqedonisë”, („Правосудството и темелните права во Република Македонија“), Komiteti i Helsinkit për të drejtat e njeriut të Republikës së Maqedonisë, 2015<https://epi.org.mk/docs/Analiza_Mreza.pdf>.

2 Neda Çalovska, Voisllav Stojanovski dhe Aleksandar Jovanovski, “Raport në hije për Kapitullin 23 për periudhën nga korriku 2015 deri në prill 2016”, („Извештај во сенка за Поглавје 23 за периодот од јули 2015 до април 2016 година“), Komiteti i Helsinkit për të drejtat e njeriut të Republikës së Maqedonisë, 2016<https://epi.org.mk/docs/Izvestaj_mk.pdf>.

3 Velimir Dellovski et al., “Raport në hije për Kapitullin 23 për periudhën nga maji 2016 deri në janar 2018”, („Извештај во сенка за Поглавјето 23 за периодот од мај 2016 до јануари 2018 година“), Komiteti i Helsinkit për të drejtat e njeriut të Republikës së Maqedonisë, 2018<https://epi.org.mk/docs/Mreza23_izvestaj%20vo%20senka_2018.pdf>.

4 Iva Conevska et al., “Raport në hije për Kapitullin 23 për periudhën Qershor 2018 – Mars 2019”, („Извештај во сенка за Поглавјето 23 за периодот јуни 2018 – март 2019 година“), 2019.

5 Iva Conevska dhe Ismail Kamberi, “Raport në hije për Kapitullin 23 për periudhën qershor 2019 - mars 2020”, („Извештај во сенка за Поглавјето 23 за периодот јуни 2019 – март 2020“), Instituti për Politikë Evropiane - Shkup, 2020 ,<https://epi.org.mk/wp-content/uploads/2020/05/Izvestaj_vo_senka_2020.pdf> .

6 Iva Conevska Vangellova dhe Ismail Kamberi, “Raport në hije për kapitullin 23 për periudhën prill 2020- shtator 2021”, („Извештај во сенка за Поглавјето 23 за периодот април 2020 – септември 2021“), Instituti për Politikë Evropiane - Shkup, 16 dhjetor 2021, https://epi.org.mk/post/20027 .

7 Angella Delevska dhe Beba Zhagar, “Raporti në hije për kapitullin 23 për periudhën tetor 2021 – shtator 2022”, („Извештај во сенка за Поглавјето 23 за периодот октомври 2021 – септември 2022“), 29 dhjetor 2022, https://epi.org.mk/post/23011.

8 “Raporti i shqyrtimit të Maqedonisë së Veriut Grupi 1 – Bazat” (Screening Report North Macedonia Cluster 1 – Fundamentals), (Komisioni Evropian 20 korrik 2023), https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023-07/MK % 20Cluster_1% 20Draft %20screening %20report_external%20version.pdf.

për hapjen e grupit me të njëjtin emër,[9] paralelisht me polarizimin e theksuar ekzistues politik rreth "propozimit francez" dhe ndryshimeve kushtetuese dhe zhvillimeve shqetësuese në fushën e sundimit të ligjit. Për më tepër, u prezantua raporti i grupit të punës franko-gjerman për Reformën Institucionale të BE-së, duke e pozicionuar respektimin e sundimit të ligjit si një parim kushtetues të paprekshëm, thelbësor për funksionimin efektiv të BE-së dhe një parakusht për anëtarësim.[10] Me këtë, egziston nevojë për ndryshime të rëndësishme praktike që janë në përputhje me standardet evropiane dhe dëshmi të angazhimit të institucioneve për reformat në këtë fushë.

Ky raport në hije është përgatitur në kuadër të projektit "Ndërtojmë ura për një të ardhme të përbashkët: Sundimi i ligjit në kontekst të anëtarësimit në BE". Projekti financohet nga Bashkimi Evropian dhe synon të ndihmojë në krijimin e reformave të qëndrueshme për sundimin e ligjit në drejtim të anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

9 "SÇE i ul OJQ-të në tryezë, së bashku do të përgatisin dokumentet për negociatat me BE-në", („СЕП ги седна на маса невладините, заедно ќе ги подготвуваат документите за преговорите со ЕУ") MKD, 24 gusht 2023, https://m.mkd.mk/node/523612.

10 Olivier Costa et al., "RAPORTI I GRUPIT TË PUNËS FRANKO-GJERMAN PËR REFORMËN INSTITUCIONALE TË BE-së – Lundrim në det të hapur: Reformimi dhe Zgjerimi i BE-së për shekullin e 21-të" (REPORT OF THE FRANCO-GERMAN WORKING GROUP ON EU INSTITUTIONAL REFORM – Sailing on High Seas: Reforming and Enlarging the EU for the 21st Century), 18 shtator 2023, https://www.politico.eu/wp-content/uploads/2023/09/19/Paper-EU-reform.pdf.

# Metodologjia

Gjatë përgatitjes së këtij raporti është zbatuar metodologjia për monitorimin e fushave që janë në fokus të punës së "Rrjetit 23" – Gjyqësor, luftë kundër korrupsionit dhe të drejtat themelore,[11] e përpunuar në vitin 2015 dhe e aplikuar tashmë në raportet e mëparshme. Ajo përfshiu hulumtimin e burimeve zyrtare të shtetit dhe institucioneve gjyqësore, analizën e njoftimit mediatik të zhvillimeve të caktuara në këto fusha në periudhën në fjalë, analiza dhe raporte të shumta të përgatitura nga organizata të shoqërisë civile, si dhe të dhëna të marra përmes kërkesave të dërguara për qasje në informacionin publik.

Për përgatitjen e këtij raporti në hije janë bërë konsultime edhe me organizata të shoqërisë civile, institucione dhe ekspertë. Fillimisht u bënë konsultime për dorëzimin e analizave, raporteve dhe hulumtimeve përkatëse në lidhje me Kapitullin 23. Më pas, më 21 dhjetor 2023, u realizua një diskutim për vetë raportin, i cili bëri të mundur marrjen e një kontributi të rëndësishëm e thelbësor të përfaqësuesve përkatës të insitucioneve gjyqësore, shtetërore dhe organizatave civile në finalizimin e këtij dokumenti, me çka shënimet, pikëpamjet dhe komentet e tyre janë të përfshira në këtë raport në hije.

Disa nga të dhënat dhe zhvillimet e mbuluara në këtë raport janë paraqitur në mënyrë më të detajuar dhe janë analizuar në raportet tremujore të sundimit të ligjit në kontekst të anëtarë-simit në BE, të cilat i publikojmë rregullisht në faqen tonë të internetit gjatë gjithë vitit, të disponueshme në linkun e mëposhtëm: https://epi.org.mk/cat/mesecni-izvestai.

11 Natalija Shikova (red.), "Metodologjia për monitorimin dhe vlerësimin e politikave publike nga Kapitulli 23 - gjyqësori dhe të drejtat themelore nga legjislacioni i Bashkimit Evropian", („Методологија за мониторинг и евалуација на јавните политики од Поглавјето 23 – правосудство и фундаментални права од законодавството на Европската унија"), (Qendra për menaxhimin e ndryshimeve), <https://epi.org.mk/docs/Metodologija_mk.pdf>.



# 1. Gjyqësori

Në periudhën raportuese, zbatimi i reformave në sektorin e gjyqësorit ka ngecur, duke marrë parasysh kornizën kohore për zbatimin e Strategjisë për Reforma në Sektorin e Gjyqësorit 2017-2022, si dhe vonesën në Strategjinë e re të Zhvillimit për Sektorin e Gjyqësorit 2023-2027. Nga ana tjetër, veprimet e institucioneve gjyqësore në raste të veçanta me interes publik, edhe pse nuk kanë qenë të lidhura me zbatimin e Strategjisë, shkaktuan reagime negative mes publikut profesionist dhe të gjerë, gjë që ndikoi në procesin evrointegrues, në besimin e qytetarëve në proceset reformuese dhe në përgjithësi në gjyqësor. Të njëjtat reagime u shkaktuan nga Ligji për ndryshime në Kodin Penal në procedurë të shkurtuar, dispozitat e të cilit vënë në pikëpyetje angazhimin për luftën kundër krimit dhe korrupsionit.[12]

12 "Reagim me rastin e ndryshimeve në Kodin Penal me procedurë të shkurtuar", („Реакција по повод измените на Кривичниот законик во скратена постапка"), faqja zyrtare e Grupit Bluprint për Reforma në Gjyqësor, 6 shtator 2023, https://bit.ly/3RCwT6Z.

# DOKUMENTE STRATEGJIKE

Periudha pesëvjeçare e zbatimit të Strategjisë për Reforma në Sektorin Gjyqësor 2017-2022, sipas raportit të vlerësimit të Ministrisë së Drejtësisë për vitin 2022, përfundoi me 140 aktivitete të zbatuara plotësisht nga gjithsej 227.[13] Nga aktivitetet e mbetura, 18 janë në vazhdim, 14 janë të vonuara, 43 zbatohen vazhdimisht, gjashtë varen nga miratimi i mëparshëm i disa ndryshimeve ligjore dhe gjashtë janë të pazbatueshme për shkak të ndryshimit në qasje.[14] Lidhur me masat në Planin e Veprimit, 52% e tyre janë zbatuar plotësisht, 34% janë zbatuar pjesërisht dhe 14% nuk janë zbatuar.[15] Numri i masave dhe aktiviteteve të zbatuara dhe/ose pjesërisht të zbatuara lidhet kryesisht me ato që parashikonin ndryshime në ligjet ekzistuese ose miratimin e ligjeve të reja (të ashtuquajturat masa rregullatore), të cilat tashmë janë zbatuar ose janë në fazat përfundimtare të miratimit. Megjithatë, disa nga proceset për hartimin dhe miratimin e disa zgjidhjeve ligjore nuk kanë përfunduar ende[16] ose ka sfida të caktuara në zbatimin e atyre që tashmë janë miratuar.[17] Nga ana tjetër, detyrimi për sigurimin e një buxheti gjyqësor të pavarur në masën e parashikuar nga Ligji për Buxhetin Gjyqësor është ende larg përmbushjes dhe nuk janë ndërmarrë veprime të rëndësishme për përmirësimin e gjendjes me burimet njerëzore, nëpërmjet zbatimit  të Strategjisë së Burimeve Njerëzore për Rrjetin Gjyqësor[18] dhe Strategjisë së Burimeve Njerëzore për Rrjetin e Prokurorisë Publike[19].  Për më tepër, moszbatimi i disa prej masave dhe aktiviteteve, përveç faktorëve objektivë që lidhen me mjedisin politik dhe shoqëror, proceset e shpeshta zgjedhore dhe bllokimi në punën e Kuvendit, kontribuan në masë të madhe në përcaktimin e tyre joadekuat, mungesën e treguesve të qartë dhe të matshëm, afatet jo reale, burimet e fondeve të vlerësuara në mënyrë joadekuate, ndryshimin e masave dhe aktiviteteve të parashikuara në Planin e Veprimit gjatë periudhës së zbatimit dhe koordinimin e pamjaftueshëm të institucioneve/organeve

13 Ministria e Drejtësisë, "Raporti vjetor për zbatimin e Strategjisë për Reforma në Sektorin Gjyqësor 2017-2022 për vitin 2022", („Годишен извештај за имплементација на Стратегијата за реформа на правосудниот сектор 2017-2022 за 2022 година"),   2022, https://bit.ly/47VOYCn.

14 Ibid.

15 Enti Shtetëror për Revizion, "Raporti përfundimtar mbi kryerjen e revizionit të suksesit, 'Efektiviteti i zbatimit të Strategjisë për Reforma në Sektorin Gjyqësor 2017-2022 dhe zbatimi i Planit të Veprimit të Strategjisë'", („Конечен извештај за извршена ревизија на успешност, 'Ефективност на спроведување на Стратегијата за реформи во правосудниот сектор 2017-2022 и спроведување на Акцискиот план на стратегијата'"), 2022, https://bit.ly/3Jy04oh.

16 Ligji për Procedurën Civile, Ligji për Drejtësinë për Fëmijët, etj.

17 Sidomos në lidhje me zbatimin e disa dispozitave të Ligjit për Prokurorinë Publike, Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Ligjit për Ndihmë Juridike Falas. Bluprint grupi për reforma në Gjyqësor, PËRMBLEDHJE E DYTË MBIKËQYRËSE E GJYSËMVITIT: Monitorimi i zbatimit të Strategjisë për Reformën e Sektorit Gjyqësor 2017-2022 - periudha e monitorimit: janar 2022 - qershor 2022", („Втор полугодишен мониторинг бриф: Следење на спроведувањето на Стратегијата за реформа на правосудниот сектор 2017-2022 година – период на следење: јануари 2022 – јуни 2022"),  (Instituti për Politikë Evropiane - Shkup, 19 shtator 2022), https://bit.ly/3NnEySR.

18 "Strategjia e Burimeve Njerëzore për Rrjetin Gjyqësor", („Стратегија на човечки ресурси за судската мрежа"), shtator 2020, https://bit.ly/3trhzNE.

19 "Strategjia e Burimeve Njerëzore për Rrjetin e Prokurorisë Publike", („Стратегија на човечки ресурси за јавнообвинителската мрежа"), tetor 2020, https://bit.ly/3GcekBs.

kompetente dhe mbajtësve të masave dhe aktiviteteve.[20] Zbatimi jo i plotë i masave dhe aktiviteteve të parashikuara është gjithashtu pasojë e monitorimit dhe vlerësimit të pamjaftueshëm të procesit të përgjithshëm të reformave dhe zbatimit të Strategjisë.[21]

Problemet e identifikuara pritet të tejkalohen me Strategjinë e re të Zhvillimit të Sektorit Gjyqësor dhe Planin e Veprimit 2023-2027, miratimi i të cilit u njoftua për fillimin e verës 2023,[22] por ende nuk është miratuar. Grupi i punës për përgatitjen e Strategjisë së Zhvillimit u mblodh në maj 2023, pas së cilës draft strategjia dhe plani i veprimit u dërguan për mendim dhe propozime në institucionet kompetente, më 21 gusht u dërguan për mendim në ekipin e ekspertëve të projektit "Mbështetja e BE-së për sundimin e ligjit",[23] dhe më 12 shtator dhe në KE.[24] Sipas deklaratave të Ministrisë së Drejtësisë, pas marrjes së mendimit të KE-së, ajo do të paraqitet për miratim në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut.[25]

Ekziston nevoja për të përcaktuar nevojën dhe rëndësinë e masave dhe aktiviteteve të parealizuara dhe pjesërisht të realizuara nga Plani i Veprimit 2017-2022 dhe përfshirjen e tyre në Strategjinë e re të Zhvillimit për Sektorin e Gjyqësorit me një Plan Veprimi për 2023-2027 për vazhdimin e reformave në sektorin Gjyqësor;

Organet kompetente për zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e Strategjisë së re të Zhvillimit dhe Planit të Veprimit 2023-2027 duhet të krijohen duke përcaktuar kompetencat e tyre, sipas metodologjisë dhe rregullave të përcaktuara të procedurës, duke punuar në mënyrë të koordinuar, transparente dhe gjithëpërfshirëse;

Të përcaktohen tregues të qartë dhe të matshëm duke zbatuar standardet përgjithësisht të pranuara, afatet reale, burimet e mjeteve financiare, aktivitetet dhe për ndryshimin e tyre të raportohet në mënyrë transparente dhe periodike.

20 Enti Shtetëror për Revizion, "Raporti përfundimtar mbi kryerjen e revizionit të suksesit, 'Efektiviteti i zbatimit të Strategjisë për Reforma në Sektorin Gjyqësor 2017-2022 dhe zbatimi i Planit të Veprimit të Strategjisë'", („Конечен извештај за извршена ревизија на успешност, 'Ефективност на спроведување на Стратегијата за реформи во правосудниот сектор 2017-2022 и спроведување на Акцискиот план на Стратегијата'"), 2022, https://bit.ly/3Jy04oh.

21 Ibid.

22 "Hartimi i strategjisë për reforma, gjegjësisht zhvillim të gjyqësorit 2023-2027", („Изготвена стратегијата за реформа односно развој на правосудството 2023-2027"), 24 vesti, 23 prill 2023, https://24.mk/details/izgotvena-strategijata-za-reforma-odnosno-razvoj-na-pravosudstvo-to-2023-2027.

23 Sipas aktiviteteve kryesore të komponentit 1 të Projektit – Gjyqësori: Përmirësimi i kapacitetit të autoriteteve gjyqësore për të ofruar drejtësi në mënyrë transparente dhe të përgjegjshme, https://gmr.lbg.ac.at/wp-content/uploads/sites/12/2022/05/leaflet_a4_mk.pdf.

24 "Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me ekipin nga projekti për sundimin e ligjit organizoi takim pune me anëtarët e grupit të punës për planifikimin e aktiviteteve për finalizimin e propozim- Strategjisë për zhvillimin e Sektorit Gjyqësor 2023-2027", („Министерството за правда во соработка со тимот од Проектот за владеење на правото организираше работна средба со членовите на работната група за планирање на активностите за финализирање на Предлог – Развојната стратегија за правосуден сектор 2023-2027"), faqja zyrtare e Ministrisë së Drejtësisë, 19 tetor 2023, https://www.pravda.gov.mk/vest/6607.

25 Ibid.

# ORGANET DREJTUESE

Periudha raportuese mbulon periudhën pas ndërhyrjes së gjerë, por të shpejtë legjislative,[26] e cila konfirmoi paqartësinë ekzistuese të ligjeve që rezultojnë në interpretimin arbitrar të tyre, si dhe praninë e ndikimit politik në punën e autoriteteve gjyqësore, në veçanti në punën e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut (KGJRMV).

Kjo u konstatua së pari nga dorëheqja e Kryetarit të KGJRMV,[27] i cili mori detyrën në prill 2021[28] për shkak të pretendimit të ˝presionit nga elitat e biznesit politik˝,[29] dhe si rezultat i reagimeve ndaj nominimit dhe emërimit të anëtarëve dhe zëvendës anëtarëve të Bordit të ri Drejtues të Akademisë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë (AGJPP), Komisionit për provimin hyrës për gjeneratën e nëntë të pjesëmarrësve në trajnimin fillestar në AGJPP dhe Komisionit për provimin përfundimtar për gjeneratën e shtatë të pjesëmarrësve në trajnimin fillestar në AGJPP.[30] Në veçanti, reagimet fillestare u ngritën nga anëtarët e mbetur të Këshillit për shkak të një liste kinse të paracaktuar të kandidatëve nga Kryetari i Këshillit, pa mundësinë e diskutimit të tyre dhe pa mundësinë e propozimit të kandidatëve nga anëtarët e mbetur të Këshillit.[31] Reagimet rezultuan në një propozim dhe përzgjedhje të kandidatëve të rinj për Bordin Drejtues të AGJPP dhe dy komisioneve në AGJPP,[32] [33] të cilat, nga ana tjetër, shkaktuan

26 Me qëllim të promovimit të pavarësisë dhe paanshmërisë të sistemit të drejtësisë, si masa për zbatimin e Strategjisë për Reforma në Sektorit Gjyqësor 2017-2022, në vitin 2019 dhe 2020 u miratua grupi i tretë i ndryshimeve në Ligjin për Gjykatat dhe Ligjin e ri për Këshillin Gjyqësor. Në drejtim të rritjes së pavarësisë së gjyqësorit, janë në fuqi edhe Ligji për Prokurorinë Publike dhe Ligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Këshillin e Prokurorëve Publikë.

27 "Njoftim nga seanca e 422-të të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut – 05.12.2022", („Соопштение од 422. седница на Судскиот совет на РСМ – 05.12.2022 година"), faqja zyrtare e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, https://bit.ly/3G2etpH.

28 "Pavlina Crvenkovska zgjidhet njëzëri si kryetare e re e Këshillit Gjyqësor", („Павлина Црвенковска едногласно избрана за нов претседател на Судскиот совет"), Akademik, 28 prill 2021, https://akademik.mk/pavlina-crvenkovska-ednoglasno-izbrana-za-nov-pretsedatel-na-sudski-ot-sovet/.

29 Sipas një deklarate të dhënë për mediat, ish-kryetarja e Këshillit Gjyqësor, Pavlina Crvenkovska, dha dorëheqjen për shkak të shpërndarjes së informacionit të rremë tek gazetarët, si dhe pengimit dhe vonesës së qëllimshme të proceseve të brendshme në Këshill, të cilat janë thelbësore për përfundimin me sukses të detyrave dhe për funksionimin e gjyqësorit. "Dha dorëheqje Kryetarja e Këshillit Gjyqësor, Crvenkovska", („Претседателката на Судски совет, Црвенковска поднесе оставка"), Civil Media, 29 nëntor 2022, https://civilmedia.mk/pretsedatelk-ata-na-sudski-sovet-tsrvenkovska-podnese-ostavka/.

30 "Njoftim nga seanca e 420-të të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut – 24.11.2022", („Соопштение од 420. седница на Судскиот совет на РСМ – 24.11.2022 година"), faqja zyrtare e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, https://bit.ly/3XsfCxZ.

31 "Trazira në Këshillin Gjyqësor, anëtarët e zgjedhur nga gjyqtarët penguan një listë të gatshme votimi për postet kryesore në Akademinë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë", („Бунт во Судскиот совет, членовите избрани од судиите спречија да помине готов список за гласање за клучни места во Академијата за судии и јавни обвинители"), Sakam da kazam, 26 nëntor 2022, https://bit.ly/3GDIqfu.

32 "Njoftim nga seanca e 420-të të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut – 24.11.2022", („Соопштение од 420. седница на Судскиот совет на РСМ – 24.11.2022 година"), faqja zyrtare e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, https://bit.ly/3XsfCxZ.

33 "Njoftim nga vazhdimi i seancës së 420-të të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut – 07.12.2022", („Соопштение од продолжението на 420. седница на Судскиот совет на РСМ – 07.12.2022 година"), faqja zyrtare e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, https://bit.ly/47wRM8D.

reagime të reja në publik, si dhe nga Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK),[34] për konflikt të interesit[35] dhe një përqendrim të madh të pushtetit të dhënë personave të zgjedhur.[36]

Reagime të ngjashme u shkaktuan nga vendimi i Këshillit të Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut (KPPRMV) për zgjedhjen e dy anëtarëve të prokurorëve publikë në Këshillin Drejtues të AGJPP-së, përfshirë Prokurorin e ri Themelor Publik të Prokurorisë Themelore Publike për Ndjekjen e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit (PTHPNKOK).[37] Konkretisht, publiku reagoi se zgjedhja e tij hap mundësinë e ndikimit dhe anëmbajtjes në kryerjen e provimit përfundimtar dhe vlerësimin e brezit të shtatë të pjesëmarrësve në trajnimin fillestar në AGJPP, mes të cilëve ishte edhe bashkëshortja e tij.[38] Për shkak të reagimeve, kreu i ri i PTHPNKOK u tërhoq nga pozicioni.[39] Në këtë drejtim, kandidati nga pozita e ushtruesit të detyrës drejtor i AGJPP-së[40] dhe kandidat për kryetar të ri të Këshillit Gjyqësor, u tërhoq edhe kanditati i propozuar nga Këshilli Gjyqësor, i cili mbeti vetëm në pozicionin fillestar për të cilin u zgjodh – anëtar i Këshillit Drejtues të AGJPP.[41]

---

34 "Antikorrupsioni kundër Gerasimovskit: Ai nuk është konsultuar me ne, një gjyqtar nuk mund të kryejë tre funksione", („Антикорупциска контра Герасимовски: Не се консултирал со нас, не може судија да извршува три функции"), A1 on, 2 dhjetor 2022, https://a1on.mk/macedonia/antikorupciska-kontra-gerasimovski-ne-se-konsultiral-so-nas-ne-mozhe-sudija-da-izvrshuva-tri-funkcii/.

35 "Këshilli Gjyqësor nuk sheh problem se anëtari i tyre Gerasimoski kryen dy funksione njëkohësisht", („Судскиот совет не гледа проблем што нивниот член Герасимоски извршува две функции истовремено"), MKD.mk, 18 dhjetor 2022, https://www.mkd.mk/makedonija/sudstvo/sudskiot-sovet-ne-gleda-problem-shto-nivniot-chlen-gerasimoski-izvrshuva-dve.

36 "Gerasimovski mori një post të tretë, u bë drejtor i Akademisë: Nuk heq dorë nga asnjë, gjithçka është e pastër", („Герасимовски доби и трета функција, стана директор на Академијата: Не се откажувам од ниедна, сè е чисто"), A1 on, 30 nëntor 2022, https://a1on.mk/macedonia/sudijata-gerasimovski-dobi-i-treta-funkcija-stana-direktor-na-akademijata-ne-se-otkazhuvam-od-niedna-se-e-chisto/.

37 "Procesverbali i seancës së 69-të të Këshillit të Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut", („Записник од 69. седница на Советот на јавни обвинители на Република Северна Македонија"), faqja zyrtare e Këshillit të Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut, https://bit.ly/46lPrfM.

38 "Gerasimovski dhe Rajevska të zgjedhur në mënyrë të paligjshme në Këshillin Administrativ, Gjyqësor dhe Prokurorial si në pazar me interpretimin e ligjeve", („Герасимовски и Рајевска незаконски избрани во Управен, судскиот и обвинителски совет како на пазарче со толкувањето закони"), A1 on, 27 nëntor 2022, https://a1on.mk/macedonia/gerasimovski-i-rajevska-nezakonski-izbrani-vo-upraven-sudskiot-i-vinitelski-sovet-kako-na-pazarche-so-tolkuvanjeto-zakoni/.

39 Zgjedhja e Kryetares të Gjykatës së Lartë si anëtare e Këshillit Drejtues të AGJPP-së, ku kunata e saj mori pjesë në trajnimin fillestar, shkaktoi të njëjtat reagime si zgjedhja e Prokurorit Publik Themelor të PTHPNKOK për të njëjtin pozicion. Megjithatë, ajo nuk u tërhoq. "Abazi është tërhequr nga akademia por Besa Ademi nuk e ka atë qëllim," („Абази се повлече од академијата ама Беса Адеми нема таква намера"), Allfa TV, 12 nëntor 2022, https://bit.ly/3MJUKPI.

40 "Shpallja e seancës konstituive të Bordit Drejtues të Akademisë", („Соопштение за одржана конститутивна седница на Управниот одбор на Академијата"), faqja zyrtare e Akademisë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë "Pavell Shatev", 30 nëntor 2022, https://bit.ly/3SJ6WDG.

41 "Gerasimovski dha dorëheqjen si Drejtor i Akademisë për Gjyqtarë dhe Prokurorë", („Герасимовски поднесе оставка од функцијата директор на Академијата за судии и обвинители"), A1 on, 5 dhjetor 2022, https://a1on.mk/macedonia/gerasimovski-podnese-ostavka-od-funkcijata-direktor-na-akademijata-za-sudii-i-obviniteli/.

Shkaku i dorëheqjes së kryetares të KGJRMV-së as nuk është hetuar dhe as nuk është shtjelluar.[42] Më 5 dhjetor 2022, u zgjodh kryetarja e re e KGJRMV-së,[43] e cila pas vetëm katër muajsh nga zgjedhjet, në kundërshtim me Ligjin për Këshillin Gjyqësor[44] dhe Rregulloren e punës së Këshillit Gjyqësor,[45] në mungesë të një procedure të rregullt shkarkimi dhe pa shumicën e nevojshme, u shkarkua nga detyra.[46] Shkarkimi i kryetares të re të Këshillit u iniciua nga shtesa e diskutueshme në rendin e ditës së seancës[47] dhe pa respektimin e rregulloreve ligjore për fillimin e përgjegjësisë disiplinore të një anëtari të këshillit. Domethënë, në rregulloret ekzistuese, parashikohet procedura dhe kushtet për zgjedhjen e Kryetarit të Këshillit, por jo procedura, kushtet dhe arsyet për shkarkimin nga detyra të Kryetarit të Këshillit,[48] domethënë ka vetëm dispozita që rregullojnë procedurën disiplinore dhe përgjegjësinë e një anëtari të Këshillit.[49] Kështu, nëse zbatonte vazhdimisht rregulloret përkatëse, Këshilli Gjyqësor nuk mund të merrte vendim për shkarkimin e kryetares pa një vendim të mëparshëm për shkarkimin e saj si anëtare e Këshillit Gjyqësor. E njëjta gjë vlen edhe për dorëheqjen e kryetarit të mëparshëm.[50] Gjithashtu, vendimi i shkarkimit u mor me një shumicë të pamjaftueshme votash nga anëtarët e Këshillit, pra, në vend të tetë votave, vendimi u mor me shtatë vota, njëra prej të cilave ishte vota e anëtarit që inicioi kërkesën për shkarkim.[51]

42 Bluprint grupi për reforma në Gjyqësor, "Si të rivendoset besimi i qytetarëve në Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut? Midis status quo-së dhe reformave rrënjësore – Rekomandime për përmirësimin e kuadrit ligjor dhe institucional në të cilin vepron Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut", („Како да се врати довербата на граѓаните во Судскиот совет на РСМ? Помеѓу статус кво и коренити реформи – Препораки за унапредување на правната и институционалната рамка во која дејствува Судскиот совет на РСМ"), 2023, i pabotuar.

43 "Njoftim nga seanca e 422-të e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut – 05.12.2022", („Соопштение од 422. седница на Судскиот Совет на РСМ – 05.12.2022 година").

44 "Ligji për Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut", („Закон за Судски совет на Република Северна Македонија"), Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr. 102/2019, neni 34, 35, 36.

45 "Rregullorja e punës së Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut", („Деловник за работата на Судскиот совет на Република Северна Македонија"), Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr. 274/2019, neni 12, 13.

46 Kryetarja e Këshillit Gjyqësor u shkarkua për refuzimin e vendosjes së një pike votimi në rendin e ditës, si dhe për akuzën e fshehjes së një shkrese të dërguar nga Ambasadori i SHBA në Këshillin Gjyqësor më 11 prill, duke kritikuar punën e gjykatave. "Njoftim nga seanca e 438-të e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut – 26.04.2023", („Соопштение од 438. седница на Судскиот совет на РСМ – 26.04.2023 година"), faqja zyrtare e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, https://bit.ly/3IVSi6t.

47 Për propozimin e plotësimit të rendit të propozuar të ditës, Këshilli votoi nëpërmjet sistemit elektronik që përdor. Me gjashtë vota pro dhe gjashtë kundër, propozimi nuk u miratua fillimisht, pas së cilës një anëtar i Këshillit deklaroi se dyshonte në rezultatet e votimit elektronik dhe kërkoi që votimi të përsëritej duke ngritur dorën. Gjatë rivotimit, propozimi u votua me shtatë vota "për" dhe pesë vota "kundër" nga anëtarët e pranishëm në seancë, me të drejtë vote. Gjithashtu, nuk është dhënë asnjë shpjegim për dyshimet në rezultate, si dhe nuk është dhënë asnjë shpjegim për diferencën në rezultatet e votimit. «Raporti për seancën e 438-të të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut të mbajtur më 26 prill 2023», („Извештај за 438. седница на Судскиот совет на Република Северна Македонија одржана на 26 април 2023 година"), Koalicioni "Të gjithë për gjykim të drejtë", https://drive.google.com/file/d/1Vrpta0K7JBPkocvnLh-Cmrypm5-M-6mV/view?fbclid=IwAR2_hEZIifzdgHnpuF99SYyJtQo5-Sno5u8KAVA7KIlYuGTJRUhLgwzYh0M

48 Ligji për Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, neni 34, 35, 36.

49 Ibid.

50 Kryetarja e mëparshme nuk mund të jepte dorëheqjen vetëm nga posti i kryetarit të Këshillit Gjyqësor, në përputhje me dispozitat që rregullonin atë çështje.

51 "Raport për seancën e 438-të të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut të mbajtur më 26 prill 2023", („Извештај за 438. седница на Судскиот совет на Република Северна Македонија одржана на 26 април 2023 година"), Koalicioni "Të gjithë për gjykim të drejtë", https://drive.google.com/file/d/1Vrpta0K7JBPkocvnLh-Cmrypm5-M-6mV/view?fbclid=IwAR2_hEZIifzdgHnpuF99SYyJtQo5-Sno5u8KAVA7KIlYuGTJRUhLgwzYh0M.

Më 4 maj 2023, anëtarët e Këshillit "ligjëruan" vendimin e tyre duke shkelur përsëri dispozitat e ligjit dhe Rregulloren e punës në lidhje me përjashtimin e publikut nga seancat e KGJRMV-së,[52] duke e nxjerrë vendimin fillestar jashtë funksionit[53] dhe duke siguruar një numër të përshtatshëm votash.[54] Për më tepër, në një nga tre seancat, e cila ishte e vetmja publike, u zgjodhën kryetari dhe nënkryetari i ri i Këshillit,[55] për herë të parë nga radhët e gjyqtarëve, dhe në përputhje me vendimin e Gjykatës Kushtetuese të 7 marsit 2023, i cili i dha mundësinë që për kryetar dhe nënkryetar të Këshillit të zgjidhen edhe anëtarë të Këshillit që janë gjyqtarë.[56]

Procedurat e mësipërme të Këshillit Gjyqësor iu nënshtruan analizës dhe shkaktuan shqetësime dhe reagime në drejtim të legjitimitetit dhe transparencës,[57] nga aktorët vendas[58] dhe ndërkombëtarë.[59] U kërkua dorëheqja e anëtarëve të Këshillit[60] dhe u ndaluan projektet dhe mjetet financiare të destinuara për të nga misionet diplomatike.[61] Në të njëjtën kohë,

52 Në dy nga tre seancat e mbajtura më katër maj 2023, publiku u përjashtua në mënyrë të paligjshme duke iu referuar nenit 39 paragrafi 2 të Ligjit për Këshillin Gjyqësor, sipas të cilit publiku mund të përjashtohet vetëm dhe vetëm «për mbrojtjen e reputacionit dhe integritetit të gjyqtarit ose kandidatit për gjyqtar», gjë që nuk ishte rasti. Marrëdhëniet ndërpersonale midis anëtarëve të KGJRMV-së nuk janë dhe nuk mund të jenë bazë për përjashtimin e publikut. Gjithashtu, nga kjo mënyrë veprimi e Këshillit, ka pasur edhe një veprim kontradiktor të Këshillit në të njëjtën situatë. Kështu, në seancën e mbajtur më 26 prill 2023, e njëjta pikë ishte publike dhe qytetarët mund të ndiqnin diskutimin dhe vendimin për të. Bluprint grupi për reforma në gjyqësor, "Këshilli Gjyqësor vazhdon me trajtimin e paligjshëm dhe jotransparent – Reagim ndaj ngjarjeve në Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut në seancën e mbajtur më 4 maj 2023", („Судскиот совет продолжува со незаконитото и нетранспарентното постапување – Реакција по повод случувањата во Судскиот совет на РСМ на седницата одржана на 4 мај 2023"), 5 maj 2023, https://bit.ly/47pkAjX.

53 Ligji për Këshillin Gjyqësor nuk parasheh mundësi që anëtarët e Këshillit, të shfuqizojnë një vendim të marrë, por vetëm ta anulojnë.

54 "Njoftimi i Seancës së mbyllur urgjente të 440-të të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut – 04/05/2023", („Соопштение од 440. итна затворена седница на Судскиот совет на РСМ – 04/05/2023"), faqja zyrtare e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, https://bit.ly/3CtcJEh; "Njoftimi i Seancës së Mbyllur Emergjente të 441-të të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut – 04/05/2023", faqja zyrtare e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, https://bit.ly/3RanHX5.

55 "Njoftim nga vazhdimi i seancës së 439-të urgjente të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut – 04.05.2023", („Соопштение од продолжение на 439. итна седница на Судскиот совет на РСМ – 04.05.2023 година"), faqja zyrtare e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 4 maj 2023, https://bit.ly/3ukXxIg.

56 "Shfuqizohet një pjesë e nenit 8 të Ligjit për Këshillin Gjyqësor në lidhje me zgjedhjen e kryetarit", („Укинат дел од член 8 од Законот за Судски совет што се однесува на изборот на претседател"), faqja zyrtare e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 7 mars 2023, https://ustavensud.mk/?p=23710.

57 Bluprint grupi për reforma në Gjyqësor, "Këshilli Gjyqësor vazhdon trajtimin e tij të paligjshëm dhe jotransparent – Reagimi ndaj ngjarjeve në Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut në seancën e mbajtur më 4 maj 2023", („Судскиот совет продолжува со незаконитото и нетранспарентното постапување – Реакција по повод случувањата во Судскиот совет на РСМ на седницата одржана на 4 мај 2023").

58 "Ministri Lloga propozoi shpërbërjen e Këshillit Gjyqësor", („Министерот Лога предложи распуштање на Судскиот совет"), TV 21, 19 qershor 2023, https://en.tv21.tv/ministerot-loga-predlozhi-raspushtane-na-sudskiot-sovet/; "Pendarovski: Këshilli Gjyqësor është i turpëruar", („Пендаровски: Судскиот совет се посрамоти"), Deutsche Welle, 29 maj 2023, https://www.dw.com/mk/pendarovski-celiot-sostav-na-sudskiot-sovet-se-posramoti-vo-ocite-na-javnosta/a-65763482.

59 "Ageler: Këshilli Gjyqësor nuk ka përmbushur detyrimet e tij ligjore", („Агелер: Судскиот совет не ги исполни своите законски обврски, 8 ноември 2023"), 8 nëntor 2023, https://www.slobodnaevropa.mk/a/32676162.html.

60 Platforma e organizatave të shoqërisë civile për luftën kundër korrupsionit, "Kërkesë për dorëheqjen e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor", („Барање за поднесување на оставка на членовите на Судскиот совет"), 10 maj 2023, https://transparency.mk/wp-content/uploads/2023/05/reakczi%D1%98a-sudski-sovet-1.pdf.

61 "Holanda pezullon projektin me Këshillin Gjyqësor për shkak të skandaleve", („Холандија стави во мирување проект со Судскиот совет поради скандалите"), Radio Evropa e Lirë, 26 maj 2023, https://bit.ly/3uAgg2z.

ish-kryetarja ka paraqitur një kallëzim penal dhe një padi që kundërshton vendimin e shkarkimit,[62] ndërsa nga ana tjetër, Këshilli Gjyqësor diskutoi një konflikt të mundshëm interesi gjatë mandatit të saj.[63] Deri në fund të periudhës raportuese, Gjykata Administrative nuk ka vendosur ende për padinë e paraqitur.[64]

Si rezultat i këtyre reagimeve, dy anëtarët e Këshillit nga radhët e gjyqtarëve (përkatësisht Rrethi i Apelit të Shkupit dhe Gjykatat Administrative dhe Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut (GJSRMV)) dhanë dorëheqjen[65] nga detyra,[66] pas së cilës u botua një shpallje për t'i zëvendësuar ato.[67] Me qëllim të zbatimit të duhur të procedurës për zgjedhjen e anëtarëve të rinj, Këshilli lëshoi një thirrje publike për shoqatat dhe fondacionet në fushën e sundimit të ligjit në mënyrë që ata të emërojnë përfaqësues (anëtar dhe zëvendës anëtar) që do të jenë pjesë e Komisionit për zbatimin e zgjedhjeve.[68] Si rezultat i veprimeve të paligjshme të Këshillit që i paraprinë procedurës së shpallur të zgjedhjeve, shoqatat bojkotuan thirrjen.[69] Me qëllim të plotësimit të Komisionit Përzgjedhës, Këshilli iu drejtua Odës së Avokatëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut, nga e cila u propozua anëtar dhe zëvendës

62 "Kryetarja e Këshillit Gjyqësor, Vesna Dameva, paraqiti ankesë penale në Prokurorinë e Shkupit dhe ankesë në Gjykatën Administrative për shkarkimin e saj", („Експретседателката на Судскиот совет, Весна Дамева, поднесе кривична пријава до Скопско обвинителство и тужба до Управниот суд за нејзино разрешување"), Sakam da kazam, 19 maj 2023, https://bit.ly/3sIsplH.

63 Doli informacioni se ish-kryetarja e Këshillit ka marrë pjesë në procedurat për përcaktimin e përgjegjësisë për gjyqtarët, ku bashkëshorti i saj është paraqitur si palë. Sipas Këshillit Gjyqësor, bashkëshorti i Damevës, Mlladen Damev, kryetar i Bordit Drejtues dhe Drejtor i Përgjithshëm i "Skopski Pazar", u paraqit si palë e dëmtuar dhe si paditës në disa lëndë që ishin dhe janë ende duke u ndjekur në Gjykatën Penale dhe Gjykatën e Apelit. "Këshilli Gjyqësor diskutoi për konfliktin e interesit të ish-kryetares Dameva", („Судскиот совет расправаше за судир на интереси на експретседателката Дамева"), Meta.mk, 5 qershor 2023, https://meta.mk/sudskiot-sovet-raspravashe-za-sudir-na-interesi-na-ekspretsedatelkata-dameva/.

64 "Diskutimi i Raportit në hije për Kapitullin 23 për periudhën tetor 2022 – shtator 2023", („Дискусија за Извештајот во сенка за Поглавје 23 за периодот октомври 2022 – септември 2023 година"), faqja zyrtare e Institutit të Politikave Evropiane – Shkup, 22 dhjetor 2023, https://epi.org.mk/post/25506.

65 "Njoftim për seancën e 444-të urgjente të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut – 08.06.2023", („Соопштение за 444. итна седница на Судскиот совет на РСМ – 08.06.2023 година"), faqja zyrtare e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, https://bit.ly/3SSV3v9.

66 Në seancën në të cilën atyre iu konstatua përfundimi i mandatit, dy anëtarë shpjeguan shkurtimisht arsyet e dorëheqjes së tyre si anëtar të Këshillit Gjyqësor. Nga prezantimet e tyre është e qartë se, ndër të tjera, dorëheqja është për shkak të mosmarrëveshjes në lidhje me mënyrën e veprimit dhe vendimit të Këshillit, dhe se ata mund të kontribuojnë shumë më tepër si gjyqtarë brenda gjykatave në të cilat punojnë sesa si anëtarë të Këshillit.
"(Video) Të dy anëtarët u larguan nga Këshilli Gjyqësor: Gjykatësi Suprem vuri në dukje vendimet e paligjshme, Gerasimovski drejtoi gishtin nga trazirat, ", („(Видео) Двајцата членови го напуштија Судскиот совет: Врховната судијка укажа на незаконски одлуки, Герасимовски впери прст во превирањата"), Makfax News Agency, 8 qershor 2023, https://bit.ly/3SSYgdX.

67 "Shpallje për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor nga radhët e gjyqtarëve, si në vijim: Një anëtar i gjyqtarëve nga rajoni i Apelit të Shkupit dhe një anëtar i gjyqtarëve nga Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut", („Оглас за избор на членови на Судскиот совет од редот на судиите, и тоа: Еден член од редот на судиите од Апелациско подрачје Скопје и еден член од редот на судиите од Врховен суд на РСМ"), Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr. 120/2023.

68 "Thirrje publike për shoqatat dhe fondacionet në fushën e të drejtave të njeriut dhe sundimit të ligjit", („Јавен повик до здруженијата и фондациите во областа на човековите права и владеењето на правото"), faqja zyrtare e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 13 qershor 2023, https://bit.ly/46otYmt.

69 Platforma e organizatave të shoqërisë civile për luftën kundër korrupsionit dhe bluprint grupi për reforma në Gjyqësor, "Emërimi i anëtarëve në Komisionin e zhvillimit të zgjedhjeve për anëtarët e Këshillit Gjyqësor", („Номинација на членови во комисијата за спроведување на избори за членови на Судскиот совет"), 23 qershor 2023, https://bit.ly/40SmHdJ.

i tij.[70] Listat përfundimtare të kandidatëve për zgjedhjen e anëtarëve të rinj të Këshillit nga radhët e gjyqtarëve u përcaktuan pas pranimit të kundërshtimit nga gjyqtari dhe kryetari i Gjykatës Themelore Kavadar,[71] me të cilin, nga ana tjetër, u konstatua veprim jokonsistent i anëtarëve të Këshillit, kur bëhet fjalë për "formalitetin" e tyre në lidhje me pranimin e kushteve për plotësimin e dokumenteve të listuara të nevojshme për kandidim për anëtar të Këshillit.[72]

Zgjedhjet u zhvilluan më 13 korrik 2023, duke zgjedhur dy anëtarë të rinj të Këshillit Gjyqësor.[73] Domethënë, u zgjodh edhe kandidati i vetëm nga zona zgjedhore e GJSRMV-së, për të cilin më parë u publikuan më shumë informacione në media për të ndaluar procedurën e filluar nga Këshilli për punën e tij joprofesionale dhe të pamatur,[74] si dhe procedurën para prokurorisë për veprime korruptive gjatë kryerjes së funksionit të gjyqtarit në Gjykatën Themelore Strumicë dhe Gjykatën e Apelit Shtip.[75] Ndër të tjera, zgjedhja e tij tregoi një dobësi tjetër sistematike në modelin për zgjedhjen e anëtarëve të KGJRMV, të rrënjosur në Ligjin për Këshillin Gjyqësor, i cili nuk ka dispozita për kritere të detyrueshme për pjesëmarrje dhe pragje specifike zgjedhore për kandidatët.[76] Konkretisht, për kandidatin e përzgjedhur, votuan vetëm gjashtë gjyqtarë nga gjithsej 16 gjyqtarë të regjistruar në Drejtorinë Zgjedhore të Gjykatës për këtë gjykatë.[77] Në zgjedhje votuan 13 gjyqtarë, nga të cilët shumica (shtatë) dhanë fletëvotime të pavlefshme, të cilat mund të konsiderohen si formë e bojkotit zgjedhor.[78] Kjo situatë u rën-

70 Kontributi në Raportin në hije nga Koalicioni "Të gjithë për gjykim të drejtë", 17.11.2023.

71 "Njoftim nga seanca e 448-të e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut", („Соопштение од 448. седница на Судскиот совет на Република Северна Македонија"), faqja zyrtare e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, https://bit.ly/3Ge8RJ8.

72 Instituti për të Drejtat e Njeriut, "Raport mbi monitorimin e punës së Këshillit Gjyqësor për periudhën janar-korrik 2023", („Извештај од следењето на работата на Судскиот совет за периодот јануари-јули 2023 година"), gusht 2023, https://bit.ly/3ZuDLpr.

73 "Nakje Georgiev dhe Antoaneta Dimovska të zgjedhur nga radhët e gjyqtarëve si anëtarë të rinj të Këshillit Gjyqësor", („Наќе Георгиев и Антоанета Димовска избрани од редот на судиите за нови членови на Судскиот совет"), faqja zyrtare e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 17 korrik 2023, https://bit.ly/45cJt0h.

74 "Këshilli Gjyqësor konfirmon se ka ndërprerë procedurat kundër gjyqtarit suprem Nakje Georgiev, nuk ka informacion në lidhje me kryetarin e Gjykatës Administrative, Burim Sejdini", („Судски совет потврди дека ја запрел постапката против врховниот судија Наќе Георгиев, нема информација за претседателот на Управен, Бурим Сејдини"), 360 stepeni, 4 korrik 2023, https://360stepeni.mk/sudski-sovet-potvrdi-deka-ja-zaprel-postapkata-protiv-vrhovniot-sudija-nake-georgiev-nema-informatsija-za-pretsedatelot-na-upraven-burim-sejdini/.

75 "Gjyqtarë me procedurë në Këshillin Gjyqësor dhe Prokurori konfirmohen si kandidatë për anëtarë të këshillit", („Судии со постапки во Судскиот совет и обвинителство потврдени за кандидати за членови на советот"), TV Tellma, 5 korrik 2023, https://telma.com.mk/2023/07/05/sudii-so-postapki-vo-sudski-sovet-i-obvinitelstvo-potvrdeni-za-kandidati-za-chlenovi-na-sovetot/.

76 Bluprint Grupi për reforma në Gjyqësor, "Reagim me rastin e zgjedhjes së dy anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut nga radhët e gjyqtarëve dhe zgjedhja e prokurorëve publikë nga Këshilli i Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut", („Реакција по повод избори на два члена на Судскиот совет на РСМ од редот на судиите и изборот на јавни обвинители од Советот на јавни обвинители на РСМ"), 14 korrik 2023, https://bit.ly/3Gc86jB.

77 Ibid.

78 "Gjyqtarët Suprem shkarravitën fletët e votimit dhe bojkotuan Nakje Georgiev, por ai u zgjodh anëtar i ri i Këshillit Gjyqësor me vetëm 6 vota. Është zgjedhur edhe Antoaneta Dimovska", („Врховните судии ги испочкртаа гласачките ливчиња и го бојкотираа Наќе Георгиев, но тој со само 6 гласа сосе неговиот е избран за нов член на Судскиот совет. Избрана е и Антоанета Димовска"), Sakam da kazam, 13 korrik 2023, https://sdk.mk/index.php/makedonija/vrhovnite-sudii-gi-ispochkrtaa-glasachkite-livchina-i-go-bojkotiraa-nake-georgiev-no-toj-so-samo-6-glasa-sose-negoviot-e-izbran-za-nov-chlen-na-sudskiot-sovet-izbrana-e-i-antoaneta-dimovska/.

dua më tej nga fakti se anëtari i zgjedhur në mënyrë të paligjshme dha dorëheqjen në mënyrë të parevokueshme pas disa ditësh[79] për shkak të faktit se ai duhej të zgjidhte si gjyqtar një anëtarë të familjes së tij.[80] Më pas, u publikuan dy shpallje për plotësimin e vendit vakant,[81] të cilat dështuan për shkak të faktit se asnjë gjyqtar nga GJSRMV nuk ishte paraqitur, duke treguar mungesën e besimit të gjyqtarëve në Këshillin Gjyqësor.

Në përgjigje të zhvillimeve të mësipërme në Këshillin Gjyqësor, Bashkimi Evropian dërgoi një mision vlerësimi,[82] për të zbuluar mangësitë në punën e Këshillit[83] dhe për të ofruar rekomandime për hapat e ardhshëm që çojnë në reformën e tij të plotë.[84]

Diçka që mund të ndahet si pozitive në punën e Këshillit Gjyqësor ishte miratimi i Kodit të ri të Etikës për anëtarët e tij[85], i cili përfshin një nen të ri: Sjellja etike në rrjetet sociale.[86] Më tej, pas kritikave nga publiku ekspert dhe duke theksuar nevojën për të përmirësuar Programin dhe Planin e Veprimit për parandalimin dhe monitorimin e korrupsionit në Gjyqësor 2022-2025,[87] Këshilli Gjyqësor në dhjetor 2022 iu afrua ndryshimit të tij në përputhje me rekomandimet.[88] Gjithashtu, më 29 shtator 2023, ai nënshkroi një Memorandum bashkëpunimi me KPPRMV për koordinimin, planifikimin dhe zbatimin e ndërsjellë të aktiviteteve të përbashkëta: parashikimet për raportin e kandidatëve për gjyqtarët e ardhshëm dhe prokurorët publikë në

79 "Njoftim nga seanca e 450-të e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut – 25.07.2023", („Соопштение од 450. седница на Судскиот совет на РСМ – 25.07.2023 година"), faqja zyrtare e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, https://bit.ly/3Rz2Hdp.

80 "Rrugëtimi i paqartë" i gjyqtarit suprem Nakje Georgiev – Pas më pak se dy javësh, anëtari i ri i Gjykatës dha dorëheqjen, në mënyrë që djali të mund të bëhej gjyqtar ", („Нејасната 'турнеја' на врховниот судија Наќе Георгиев – По нецели две недели новиот член на Судски поднесе оставка, за синот да стане судија"), Prisma – Rrjeti Ballkanik i Gazetarëve Hulumtues (BIRN) Maqedoni, 25 korrik 2023, https://prizma.mk/nejasnata-turneja-na-vrhovniot-sudija-nake-georgiev/.

81 "Shpallje për zgjedhjen e 1 (një) anëtari nga radhët e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut", („Оглас за избор на 1 (еден) член од редот на судиите од Врховниот суд на Република Северна Македонија"), Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr. 252/2023; "Shpallje për zgjedhjen e 1 (një) anëtari nga radhët e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut", („Оглас за избор на 1 (еден) член од редот на судиите од Врховниот суд на Република Северна Македонија"), Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr. 203/2023.

82 "Këshilli Gjyqësor prej nesër 'nën vëzhgim' të BE-së – fillon misioni i vlerësimit", („Судски совет од утре 'под лупа' на ЕУ – почнува оценската мисија"), Kanall 5, 26 korrik 2023, https://kanal5.com.mk/sudski-sovet-od-utre-pod-lupa-na-eu-pochnuva-ocenskata-misija/a592935.

83 Gjatë vizitës të misionit vlerësues, ekipi i tij i ekspertëve pati diskutime me aktorët kryesorë nga vendi, përfshirë Institutin e Politikave Evropiane (EPI) – Shkup, veçanërisht si pjesë e Grupit Blueprint për reforma në Gjyqësor.

84 "Raporti i misionit vlerësues të BE-së do të shqyrtohet në mënyrë transparente para mediave, njoftoi kryetari i Këshillit Gjyqësor", („Извештајот на оценската мисија на ЕУ ќе биде разгледуван транспарентно пред медиумите, најави претседателот на Судскиот совет"), 360 stepeni, 25 shtator 2023, https://360Stepeni.mk/izveshtajot-na-otsenskata-misija-na-eu-ke-bide-razgleduvan-transparentno-pred-mediumite-najavi-pretsedatelot-na-sudskiot-sovet/.

85 "Njoftim nga seanca e 417-të e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut – 19.10.2022", („Соопштение од 417. седница на Судскиот совет на РСМ – 19.10.2022 година"), faqja zyrtare e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, https://bitly./3X106J6.

86 Kodi i Etikës për anëtarët e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr. 228/2022.

87 Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut, «Programi dhe Plani i Veprimit për Parandalimin dhe Monitorimin e Korrupsionit në Gjyqësor 2022-2025», („Програма и Акционен план за превенција и следење на корупцијата во судството 2022-2025"), 7 shtator 2022, https://bit.ly/3DNooPw.

88 "Njoftim për vazhdimin e seancës së 421-të të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut", („Соопштение од продолжението на 421. седница на Судскиот совет на РСМ"), faqja zyrtare e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, https://bit.ly/3kkhKsK.

regjistrimin e pjesëmarrësve të rinj në AGJPP, një paraqitje e përbashkët para institucioneve shtetërore për sigurimin e kushteve më të mira materiale dhe financiare për punë, autonomi më të madhe në buxhetim dhe promovimin e statusit të shërbimit profesional.[89]

Sa i përket KPPRMV, Këshilli plotësoi vendet e lira të vjetra dhe të reja për anëtarët në Këshill dhe në përputhje me rrethanat punon në mënyrë të plotë. Konkretisht, më 10 janar 2023, ai zgjodhi anëtarin e Këshillit nga radhët e prokurorëve publikë për fushën e Prokurorisë së Lartë Publike Gostivar,[90] dhe më 26 prill 2023, ai zgjodhi anëtarin e Këshillit, që i përkiste komuniteteve në vend.[91] Dy anëtarët e mbetur të Këshillit u zgjodhën nga Kuvendi më 18 korrik[92] dhe 26 korrik 2023.[93] Zgjedhja e fundit e një anëtari të Këshillit provokoi reagime nga opozita,[94] si dhe nga publiku,[95] si rezultat i faktit se në vitin 2009, sipas ligjit të atëhershëm,[96] nuk u rizgjodh në postin e prokurorit publik themelor për shkak të një vendimi për kryerjen joprofesionale dhe të pandërgjegjshme të funksionit.[97] Për më tepër, më 27 shtator 2023, mandati i Kryetarit aktual të Këshillit u ndërpre, duke zgjedhur kështu kryetaren e re në të njëjtën seancë.[98] Në këtë drejtim, është jashtëzakonisht e rëndësishme të theksohet se vetëm kryetari aktual kishte një propozim për kandidat për kryetar të ri, ndërsa anëtarët e tjerë të Këshillit nuk kishin fare propozime, kështu që praktikisht nuk kishte konkurrencë se kush do të ishte kryetari i ri i Këshillit.[99]

89 "Memorandum – një fillim i ri bashkëpunimi midis Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit të Prokurorëve Publikë", („Меморандум – нов почеток на соработка на Судски совет и Совет на јавни обвинители"), faqja zyrtare e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 27 shtator 2023, https://bit.ly/3PysYWB.

90 "Njoftim", („Соопштение"), faqja zyrtare e Këshillit të Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 10 janar 2023, https://bit.ly/43h4kj4.

91 "Njoftim", („Соопштение"), faqja zyrtare e Këshillit të Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 27 prill 2023, https://bit.ly/3sXALps; "Shpallja e zgjedhjeve", faqja zyrtare e Këshillit të Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut, https://bit.ly/3Gd1Zvl.

92 "Dhënie e deklaratës solemne", („Давање свечена изјава"), faqja zyrtare e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 25 korrik 2023, https://www.sobranie.mk/ns-newsarticle-davane-svecena-izjava-25-juli-2023.nspx.

93 "Keti Petkova dha deklaratë solemne si anëtare e re e Këshillit të Prokurorëve Publik", („Кети Петкова даде свечена изјава како нов член на Советот на јавни обвинители"), 360 stepeni, 26 korrik 2023, https://360stepeni.mk/foto-keti-petkova-dade-svechena-izjava-kako-nov-chlen-na-sovetot-na-javni-obviniteli/.

94 "Deputetët e VMRO-DPMNE-së kundër propozimit që Keti Petkova të bëhet anëtare e Këshillit të Prokurorëve Publikë", („Пратениците на ВМРО-ДПМНЕ против предлогот Кети Петкова да стане член на Советот на јавни обвинители"), A1 on, 19 korrik 2023, https://a1on.mk/macedonia/pratenicite-na-vmro-dpmne-protiv-predlogot-keti-petkova-da-stane-chlen-na-sovetot-na-javni-obviniteli/.

95 "Si do të zgjedhë dhe shkarkojë tani prokurorja e 'shkarkuar' Keti Petkova?", („Како 'разрешената' обвинителка Кети Петкова сега ќе бира и разрешува обвинители?"), 360 stepeni, 27 korrik 2023, https://360stepeni.mk/kako-razreshenata-obvinitelka-keti-petkova-sega-ke-bira-i-razreshuva-obviniteli/.

96 Sipas ligjit të atëhershëm, prokurorët zgjidheshin për një mandat prej gjashtë vjetësh dhe secili prokuror i zgjedhur aplikonte për (ri)zgjedhje/zgjatje të mandatit, para se të skadonin ato gjashtë vjet. Në atë kohë, Këshilli i Prokurorëve Publikë ishte organi që vendoste për zgjatjen e mandateve të prokurorëve publikë. Seanca e Këshillit e datës 20 korrik 2009 është seanca e fundit në të cilën kjo çështje është vendosur në përputhje me këtë ligj, për shkak se funksioni i prokurorit publik u bë i përhershëm me ligjin e ri të asaj kohe.

97 "Vendim për ndërprerjen e detyrës së prokurorit publik", („Одлука за престанок на функцијата јавен обвинител"), Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 90/2009.

98 "Njoftim", („Соопштение"), faqja zyrtare e Këshillit të Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 27 shtator 2023, https://bit.ly/3t2Q3Jh.

99 Kontribut në Raportin në hije nga Koalicioni "Të gjithë për gjykim të drejtë", 17.11.2023.

Është e nevojshme të rishikohet procedura për përcaktimin e përgjegjësisë disiplinore për një anëtar të Këshillit Gjyqësor me qëllim forcimin e bazave për fillimin e procedurës dhe zgjerimin e rrethit të subjekteve që mund të paraqiten si kërkues për procedim disiplinor;

Nevojiten ndryshime në dispozitat e Ligjit për Këshillin Gjyqësor për të ndryshuar dhe qartësuar procedurën e zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit, si nga radhët e gjyqtarëve ashtu edhe nga Kuvendi. Lidhur me mënyrën e parë të zgjedhjes, është e nevojshme të krijohet një census i detyrueshëm, pra një përqindje minimale e pjesëmarrjes së gjyqtarëve në mënyrë që zgjedhjet të jenë të vlefshme, si dhe të përcaktohet shumica e nevojshme e votave në mënyrë që të konsiderohet se kandidati si i zgjedhur. Për më tepër, në lidhje me mënyrën e dytë të zgjedhjes, është e nevojshme të vendoset një kontroll paraprak me përfshirje dhe në një seancë të gjërë të KGJRMV në të cilën marrin pjesë të gjithë gjyqtarët e KGJRMV dhe kryetarët e të gjitha gjykatave në vend. Përveç kësaj, procedura e përzgjedhjes duhet të përfshijë një intervistë të detyrueshme para trupit punues kompetent në Kuvend, në të cilin do të merrnin pjesë përfaqësues të subjekteve të përmendura më parë, si dhe organizata të shoqërisë civile;[100]

Kërkohet gjithashtu një kontroll paraprak dhe një intervistë e detyrueshme për kandidatët për anëtarë të Këshillit të Prokurorëve Publikë, për të paraqitur arritjet, programin e punës dhe motivimin e tyre për të qenë anëtar të Këshillit.

100 Bluprint grupi për Reforma në Gjyqësor, “Si të rivendoset besimi i qytetarëve në Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut? Midis status quo-së dhe reformave rrënjësore – Rekomandime për përmirësimin e kuadrit ligjor dhe institucional në të cilin vepron Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut”, („Како да се врати довербата на граѓаните во Судскиот совет на РСМ? Помеѓу статус кво и коренити реформи – Препораки за унапредување на правната и институционалната рамка во која дејствува Судскиот совет на РСМ“).

# PAVARËSIA DHE PAANSHMËRIA

Korniza ligjore, si garanci për pavarësinë e gjyqësorit, është mirë e vendosur dhe e zbatuar plotësisht,[101] me përjashtim të pjesës së pavarësisë financiare të buxhetit gjyqësor. Megjithatë, pavarësisht kornizës ligjore të përcaktuar, mosbesimi i qytetarëve në gjyqësor është në rritje, siç tregohet nga sondazhi i fundit nga Barometri Ballkanik, ku Republika e Maqedonisë së Veriut, krahasuar me vitin e kaluar, regjistroi një rritje të mosbesimit me 10%.[102] Këtë e dëshmojnë të dhënat nga sondazhi i fundit i Institutit Ndërkombëtar Republikan (IRI), ku 80% e qytetarëve të anketuar nuk besojnë ose kanë dyshime në institucione që janë në luftë të drejtpërdrejtë kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, dhe në të njëjtën kohë nuk ndihen as të sigurt se mund të marrin mbrojtje adekuate të të drejtave të tyre para gjykatave.[103] Një rol kyç në forcimin e besimit të qytetarëve në gjyqësor luajnë autoritetet legjislative dhe ekzekutive, media, KGJRMV dhe KPPRMV, përmes transparencës në veprimin e tyre, inkurajimit të transparencës së procedurave gjyqësore, zbatimit të vendimeve, dhe kështu ruajtjes së besimit të publikut në pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqësorit.[104]

Përmirësimi i transparencës mbetet një sfidë për të dy këshillat. Në periudhën raportuese, seancat e Këshillit Gjyqësor ishin kryesisht publike dhe u ndoqën nga përfaqësues të medias dhe sektorit civil.[105] Megjithatë, pas shkarkimit të paligjshëm të Kryetarit të Këshillit, praktika aktuale e pjesëmarrjes publike në seanca ndryshoi, dhe pati një përpjekje për të ndryshuar praktikën në përputhje me të cilën mediat kanë mundësi të incizojnë të gjithë rrjedhën e seancave. Lidhur me të parën, nëse një person është i interesuar të ndjek seancat publike të KGJRMV, është e nevojshme të merret miratimi paraprak nga KGJRMV.[106] Ky ndryshim, pa ekzistencën e një arsyeje legjitime, bie në kundërshtim të drejtpërdrejtë me parimin e

101 Një pjesë e aktiviteteve dhe masave të përcaktuara në Strategjinë për reforma në Sektorin Gjyqësor 2017-2022 që i referohen pavarësisë dhe paanësisë janë zbatuar me miratimin e grupit të tretë të ndryshimeve në Ligjin për Gjykatat dhe Ligjin e ri për Këshillin Gjyqësor. Në drejtim të rritjes së pavarësisë së gjyqësorit, janë në fuqi edhe Ligji për Prokurorinë Publike dhe Ligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Këshillin e Prokurorëve Publikë. Grupi i tretë i ndryshimeve në Ligjin për Gjykatat dhe Ligjin e ri për Këshillin Gjyqësor kontribuan në veçanti në zbatimin e rekomandimeve të grupit të ekspertëve të kryesuar nga Pribe dhe rekomandimeve të dhëna nga Komisioni i Venecias.

102 "Barometri Publik Ballkanik – Tabela e Rezultateve",(Balkan Public Barometer – Results Table)", Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal (KBR) [Regional Cooperation Council (RCC)], https://www.rcc.int/balkanbarometer/results/2/public.

103 Instituti Ndërkombëtar Republikan (IRI), "Anketa Kombëtare e Maqedonisë së Veriut | Prill – Maj 2023", (National Survey Of North Macedonia | April – May 2023), 10 korrik 2023, https://www.iri.org/resources/national-survey-of-north-macedonia-april-may-2023/.

104 Ledi Bianku dhe Hana Smith, "Pavarësia dhe paanshmëria e gjyqësorit - një pasqyrë e praktikës përkatëse gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut", („Независност и непристрасност на судството – преглед на релевантната судска практика на Европскиот суд за човекови права"), 2021 <https://www.rolplatform.org/wp-content/uploads/2021/09/independence-and-impartiality-of-judiciary-mkd.pdf>.

105 Kontribut në Raportin në hije nga Koalicioni "Të gjithë për gjykim të drejtë", 17.11.2023.

106 Ivana Petkovska dhe Lejla Tutikj, "Raporti vjetor i monitorimit mbi punën e Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit të Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut", („Годишен мониторинг извештај за работата на Судскиот совет и Советот на јавни обвинители на Република Северна Македонија") (Koalicioni "Të gjithë për gjykim të drejtë", 2023), https://all4fairtrials.org.mk/wp-content/uploads/2023/12/63-MISo-2023.pdf.

transparencës dhe hapjes së institucioneve.[107] Lidhur me të dytën, përpjekja u bë në seancën e mbajtur më 9 maj 2023, në të cilën mediave iu lejua të incizonin vetëm inserte të shkurtra, pas së cilës kamerat u kërkuan të hiqeshin nga dhoma, me arsyetimin se nuk kishte hapësirë të mjaftueshme në sallën e konferencave, dhe se kamerat ndikuan në përqendrimin e anëtarëve të Këshillit.[108] Ky vendim u ndryshua të nesërmen, me arsyetimin se incizimi do të lejohej,[109] dhe rrjedhimisht seancat e Këshillit do të transmetohen drejtpërdrejt nga Agjencia Informative Mediatike (AIM).[110] Seancat e mbetura të Këshillit nuk ishin publike, për shkak të vendimit të Këshillit për përjashtimin e publikut. Në seancat jopublike u vu re një standard i pabarabartë i trajtimit dhe interpretimit të dispozitave përkatëse që rregullojnë këtë çështje, madje edhe shkelja e tyre. Konkretisht, Ligji për Këshillin Gjyqësor përcakton saktësisht se në cilat situata Këshilli mund të vendosë të përjashtojë publikun nga seancat.[111] Konkretisht, në nenin 39 pika 2 thuhet se publiku mund të përjashtohet me qëllim mbrojtjen e reputacionit dhe integritetit të gjyqtarit ose kandidatit për gjyqtar, dhe në përputhje me pikën 3, kur Këshilli merr një vendim të tillë, është i detyruar të njoftojë publikun për arsyet e këtij vendimi. Përveç kësaj, nëse është një rast në të cilin Këshilli duhet të marrë një vendim të caktuar për pikën për të cilën do të përjashtohej publiku, votimi i vendimit duhet të jetë publik, si dhe vendimi për përjashtimin e publikut.[112] Duke u nisur nga kjo mënyrë e organizimit të publikut për punën e Këshillit Gjyqësor, në seancat 440 dhe 441 të Këshillit, u konstatua shkelje e dispozitave, me përjashtim të publikut, pa shpallje publike paraprake për zhvillimin e seancave dhe pa një shpjegim të dhënë më parë të arsyeve për një vendim të tillë.[113] Arsyeja e përjashtimit të publikut u deklarua të ishte një temë e ndjeshme – marrëdhëniet ndërpersonale, dhe kur bëhej fjalë për dy çështje jashtëzakonisht të rëndësishme – shfuqizimi i vendimit për shkarkimin e kryetares, si dhe marrja e një vendimi të ri për ri-shkarkimin e saj.[114] Nga ana tjetër, në seancën e 438-të të Këshillit, kur kryetarja fillimisht u shkarkua, qytetarët mundën të ndiqnin diskutimin dhe vendimin për të.[115] Trajtimi i pabarabartë u vërejt edhe në përjashtimin

107 Ibid.

108 "Këshilli Gjyqësor ka detyrim të jetë transparent për publikun", („Судскиот совет има обврска да биде транспарентен кон јавноста"), faqja zyrtare e Shoqatës së Gazetarëve të Maqedonisë, 9 maj 2023, https://bit.ly/47MxWq8.

109 "Kamera në Këshillin Gjyqësor do të ketë si deri tani, ashtu edhe më tutje", („Камери во Судскиот совет како досега, така и отсега натаму, ќе има"), faqja zyrtare në facebook e Këshillit Gjyqësor dhe Medial në Shoqatën e Gjyqtarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 19 maj 2023, https://www.facebook.com/SMSovet/posts/pfbid031EpGHec59Gs2bRg6jo8pDR153g4w4HePbYLZsSJ7iAtDhyc47a3apkp1WYRrt966l.

110 „Georgiev: Kjo përbërje e Këshillit Gjyqësor do të jetë jashtëzakonisht transparente", („Георгиев: Овој состав на Судскиот совет ќе биде исклучително транспарентен"), Agjencia Informative Mediatike – AIM, 10 maj 2023, https://bit.ly/3MYWZyi.

111 Ligji për Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

112 Ibid.

113 Bluprint grupi për reforma në Gjyqësor, "Këshilli Gjyqësor vazhdon trajtimin e tij të paligjshëm dhe jotransparent – Reagimi ndaj ngjarjeve në Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut në seancën e mbajtur më 4 maj 2023", („Судскиот совет продолжува со незаконитото и нетранспарентното постапување – Реакција по повод случувањата во Судскиот совет на РСМ на седницата одржана на 4 мај 2023").

114 Ibid.

115 Koalicioni "Të gjithë për gjykim të drejtë", "Raport i veçantë për seancën e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut të mbajtur më 04.05.2023", („Посебен извештај за седницата на Судскиот совет на РСМ одржана на 04.05.2023 година"), https://drive.google.com/file/d/1PbXN-6QrSYuTbew4gEH4tilrgKxNmj8g3/view.

e publikut nga seanca e 454-të, e mbajtur më 14 shtator 2023, për shkak të një raporti që përmbante informacione në lidhje me punën e kryetarit të Gjykatës Themelore Kavadar, i cili u përgatit në bazë të pretendimeve të paraqitura në Këshill, dhe të paraqitura nga qytetarët, KPPRMV, KSHPK dhe palë të tjera.[116] Konkretisht, nuk u shpjegua qartë pse Këshilli vlerësoi se ky raport do të rrezikonte reputacionin e gjyqtarit, pra kryetarit të gjykatës, prandaj është e nevojshme të merret një vendim për përjashtimin e publikut, kur raportet për funksionimin e një gjykate specifike ose të një kryetari të një gjykate janë paraqitur gjithmonë publikisht.[117]

Shkelje e drejtpërdrejtë e dispozitave ligjore dhe dispozitave të Rregullores së punës së KGJRMV[118] në lidhje me transparencën dhe publicitetin në punën e Këshillit u konstatua edhe në seancën kur u zgjodh Kryetari i ri i Këshillit, duke thirrur seancën jashtë orarit të punës së Këshillit dhe pesëmbëdhjetë minuta para fillimit të seancës.[119]

Si sfidë mbetet vazhdimi i mirëmbajtjes së kolegjiumit nga anëtarët e KGJRMV-së.[120] Kjo çon në përfundimin se anëtarët e Këshillit diskutojnë pikat e rëndësishme të rendit të ditës “pas dyerve të mbyllura”, dhe pastaj me pikëpamje të harmonizuara i afrohen një seance publike, në të cilën ata marrin vendime të dakorduara më parë pa ose me diskutim minimal, në mënyrë që të lënë një përshtypje pozitive tek publiku i pranishëm.[121] Ekziston gjithashtu nevoja për aplikim më të madh të incizimeve audio dhe audio-vizuele të seancave dhe gjykimeve, të cilat edhe pse janë obligim ligjor, në praktikë nuk zbatohen në mënyrë të vazhdueshme dhe të rregullt.[122]

116 Petkovska dhe Tutikj, “Raporti vjetor i monitorimit për punën e Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit të Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut”, („Годишен мониторинг извештај за работата на Судскиот совет и Советот на јавни обвинители на Република Северна Македонија“).

117 Ibid.

118 Në bazë të nenit 38 të Ligjit për KGJRMV dhe nenit 11 të Rregullores së punës së KGJRMV, dita e mbajtjes së seancës së Këshillit publikohet në faqen e internetit të Këshillit, menjëherë pas caktimit të seancës, në të njëjtën kohë me dorëzimin e ftesës anëtarëve të Këshillit. Ftesa do të dorëzohet të paktën shtatë ditë para ditës së seancës, por ekziston mundësia që seanca të caktohet në një kohë më të shkurtër për shkak të çështjeve urgjente.

119 Bluprint grupi për reforma në Gjyqësor, “Këshilli Gjyqësor vazhdon trajtimin e tij të paligjshëm dhe jotransparent – Reagimi ndaj ngjarjeve në Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut në seancën e mbajtur më 4 maj 2023”, („Судскиот совет продолжува со незаконитото и нетранспарентното постапување – Реакција по повод случувањата во Судскиот совет на РСМ на седницата одржана на 4 мај 2023“).

120 Opcioni për mbajtjen e mbledhjeve të punës (kolegjiume) u mundësua me Rregulloren e Këshillit Gjyqësor të vitit 2015, ku në nenin 15 parashikohej se kryetari i Këshillit mund të mbledhë dhe të mbajë kolegjiume çdo herë që e vlerëson të nevojshme. Në Rregulloren e punës që është aktualisht në fuqi, kjo dispozitë pasqyrohet në nenin 19. “Rregullorja e punës së Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut”, („Деловник за работата на Судскиот совет на Република Северна Македонија“), Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr. 274/2019.

121 Petkovska dhe Tutikj, “Raporti vjetor i monitorimit për punën e Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit të Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut”, („Годишен мониторинг извештај за работата на Судскиот совет и Советот на јавни обвинители на Република Северна Македонија“).

122 Për një periudhë të caktuar pas shkarkimit të ish-kryetares, mund të vërehet përsëri se sistemi elektronik për regjistrimin e zërit dhe votimit nuk ishte në funksion, ndryshe nga më parë, ashtu që anëtarët votonin duke ngritur duart. As ish-nënkryetari Selim Ademi, i cili udhëhoqi seancat deri në zgjedhjen e kryetarit të ri, as kryetari i ri Sashko Georgiev nuk shpjeguan pse sistemi nuk ishte funksional në atë kohë. Instituti për të Drejtat e Njeriut, “Raport mbi monitorimin e punës së Këshillit Gjyqësor për periudhën janar-korrik 2023”, („Извештај од следењето на работата на Судскиот совет за периодот јануари-јули 2023 година“).

Pozitive në punën e KGJRMV-së vazhdoi të jetë publikimi i seancave të planifikuara dhe të zhvilluara, vendimeve të marra, mbledhjeve dhe takimeve të realizuara, raporteve të përgatitura, procesverbaleve dhe materialeve të tjera që lidhen me punën e Këshillit në faqen e internetit të Këshillit. Në përputhje me atë që është thënë është edhe angazhimi i një nëpunësi të marrëdhënieve me publikun,[123] si dhe takime më të shpeshta me Këshillin Gjyqësor-Mediatik me qëllim përmirësimin e transparencës së Këshillit,[124] rezultatet e të cilave duhet të shihen në periudhën që vijon.

Masa të rëndësishme për përmirësimin e transparencës së gjyqësorit u morën nga Këshilli Gjyqësor Mediatik dhe KGJRMV. Përmes mbështetjes dhe bashkëpunimit të tyre të ndërsjellë, fillimisht u miratua një qëndrim parimor për zbulimin publik të vendimeve që nuk janë në fuqi (aktgjykimeve dhe vendimeve) nga ana e gjykatave, në lidhje me lëndët me interes publik,[125] dhe u paraqit një iniciativë në Ministrinë e Drejtësisë për të ndryshuar nenin 9 të Ligjit për Lëvizjen dhe Menaxhimin e Lëndëve[126] dhe nenin 99 paragrafi 5 të Ligjit për Gjykatat,[127] i cili do të mundësonte zbatimin e këtij qëndrimi parimor. Pas kësaj, u miratua një qëndrim parimor për akreditimin e mediave në lidhje me miratimet për incizim dhe fotografim në lëndë specifike.[128] Në këtë drejtim, Këshilli Gjyqësor Mediatik gjithashtu miratoi Planin e Punës së Këshillit për 2023-2025 për të promovuar transparencën dhe bashkëpunimin midis gazetarëve dhe gjyqtarëve,[129] sipas të cilit caktoi anëtarë përgjegjës për komunikimin me Këshillin e Buxhetit Gjyqësor për të siguruar fonde për angazhimin e stafit të marrëdhënieve me publikun në Gjykatat e Apelit dhe gjykatat e juridiksionit të zgjeruar,[130] si dhe për të kryer trajnime për aftësitë e komunikimit për 40 gjyqtarë dhe zëdhënës të gjykatës.[131]

123 "Njoftim", („Соопштение"), faqja zyrtare e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 19 maj 2023, https://bit.ly/3GmG19a.

124 "Mbledhja e Këshillit Gjyqësor me anëtarët e Këshillit Gjyqësor-Mediatik", („Средба на Судскиот совет со членови на Судско-медиумскиот совет"), faqja zyrtare e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 19 maj 2023, https://bit.ly/3uFqJK5.

125 Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, "Qëndrim parimor për publikimin e vendimeve gjyqësore në faqet e internetit të gjykatave", („Начелен став за објавување на донесените судски одлуки на интернет-страниците на судовите"), 21 dhjetor 2022, https://bit.ly/3GLvZP1.

126 "Ministria e Drejtësisë ka pranuar iniciativën e Këshillit Gjyqësor-Mediatik", („Министерството за правда ја прифати иницијативата на Судско-медиумскиот совет"), faqja zyrtare në Facebook e Këshillit Gjyqësor-Mediatik në Shoqatën e Gjyqtarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 22 qershor 2023, https://bit.ly/49UKzkJ.

127 "Njoftim nga Seanca e Përgjithshme e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut", („Соопштение од одржана Општа седница на Врховниот суд на Република Северна Македонија"), faqja zyrtare e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 30 dhjetor 2022, https://bit.ly/3iJcVsN.

128 "Gjykata Supreme ka krijuar një qëndrim parimor për akreditimet e mediave", („Врховниот суд утврди начелен став за акредитациите на медиумите"), faqja zyrtare e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 14 korrik 2023, https://bit.ly/3rY1C4n.

129 "Njoftim", („Соопштение"), faqja zyrtare në facebook e Këshillit Gjyqësor dhe Mediatik në Shoqatën e Gjyqtarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 28 prill 2023, https://www.facebook.com/SMSovet/posts/pfbid0bMBkxevhhx8z1fhFzQmmabKYV2pjBR9ktec8fbEwqRdPXi2ePTgnyFV7DLnBLXVl.

130 Ibid.

131 "Njoftim", („Соопштение"), faqja zyrtare në facebook e Këshillit Gjyqësor-Mediatik në Shoqatën e Gjyqtarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 8 nëntor 2023, https://bit.ly/3sRTwe4.

Me qëllim përmirësimin e profesionalizimit dhe kompetencës së gjyqtarëve, si dhe në drejtim të kryerjes së duhur të detyrave gjyqësore, është e nevojshme që gjyqtarët t'i drejtohen më shpesh Trupit Këshillëdhënës të Etikës Gjyqësore. Nga periudha e mëparshme raportuese deri në shtator 2023, Organi Këshillimor nuk ka marrë asnjë kërkesë për mendime këshilluese.[132]

Sa i përket transparencës së punës së KPPRMV, mund të thuhet se seancat janë të hapura për publikun dhe mund të ndiqen në të gjitha pikat, përveç atyre ku publiku është i përjashtuar sipas ligjit.[133] Në seanca, anëtarët hyjnë në diskutim, por nuk kanë iniciativën për të propozuar pika në rendin e ditës që do të shqyrtoheshin dhe diskutoheshin më tej.[134] Sa i përket publikimit në faqen e internetit, njoftimet për zhvillimin e seancave publikohen në kohën e duhur, duke respektuar afatin e përcaktuar. Megjithatë, KPPRMV vazhdon me praktikën e publikimit të parregullt të procesverbaleve të seancave të mbajtura. Për më tepër, procesverbalet e publikuara përmbajnë vetëm të dhëna të përgjithshme dhe nuk pasqyrojnë diskutimin aktual që u zhvillua në seancë, as nuk janë botuar në një format të përshtatshëm.[135] Të njëjtat vërejtje kanë të bëjnë edhe me publikimin e vendimeve të arsyetuara për përzgjedhjen, ngritjen në detyrë dhe shkarkimin e prokurorëve publikë, si dhe vendimeve të tjera të marra nga ai, që është plotësisht në kundërshtim me Rregulloren e punës së KPPRMV-së. [136] Mungon gjithashtu transparenca aktive në sektorin e marrëdhënieve me publikun dhe publikimi i informacionit në lidhje me aktivitetet e përditshme të KPPRMV-së. Në këtë drejtim, në faqen e internetit mungojnë të dhënat e kontaktit për personin për marrëdhënie me publikun, si dhe të dhënat për personin përgjegjës për qasje të lirë në informacione me karakter publik, gjë që është në kundërshtim me nenin 10 të Ligjit për qasje të lirë në informacione me karakter publik.

132 "Pyetje dhe përgjigje", („Поставени прашања и одговори"), Faqja zyrtare e Trupit Këshillëdhënës i Etikës Gjyqësore, https://sudiskaetika.mk/#-sudija.

133 KPPRMV mund t'a përjashtojë publikun vetëm me vendim, për të mbrojtur reputacionin dhe integritetin e prokurorit publik. Sipas nenit 14 të Rregullores së KPPRMV, Këshilli mund të vendosë të përjashtojë publikun nga seancat me shumicë prej dy të tretave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve. Nëse Këshilli merr një vendim të tillë, ai është i detyruar të informojë publikun për arsyet e përjashtimit të publikut.

134 Petkovska dhe Tutikj, "Raporti vjetor i monitorimit për punën e Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit të Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut", („Годишен мониторинг извештај за работата на Судскиот совет и Советот на јавни обвинители на Република Северна Македонија").

135 Procesverbalet e seancës publikohen në formatin e imazhit në vend të formatit të dokumentit, duke e bërë të pamundur që publiku t'i marrë ato në mënyrë që ata të kenë më lehtë qasje në informacionin që u nevojitet. Ibid.

136 Në nenin 16 paragrafi 7 i Rregullores për punën e KPPRMV-së, thuhet se vendimet e Këshillit duhet të shpjegohen dhe të njëjtat të publikohen në ueb faqen e Këshillit. «Ligjet dhe aktet nënligjore», Faqja zyrtare e Këshillit të Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut, https://bit.ly/3v8rfgH.

Pavarësisht që me vite u kritikuan dhe u kundërshtuan ndryshimet e formulimeve të caktuara të nenit 10 të Kodit të Etikës të Prokurorëve Publikë,[137] të cilat kufizojnë të drejtën e prokurorëve publikë për të komentuar mbi rastet dhe për të diskutuar publikisht punën e KPPRMV-së dhe të prokurorit publik republikan,[138] gjatë periudhës raportuese ato filluan të zbatohen.[139] Kështu, kur një prokuror publik kritikoi publikisht punën e Këshillit, gjatë një konference shkencore,[140] Këshilli ia referoi çështjen Këshillit Etik të Prokurorëve Publikë për të përcaktuar nëse prokurori duhet të mbajë përgjegjësi për këto vërejtje.[141] Formulimet, si dhe veprimet e Këshillit, janë në kundërshtim me veprimin transparent dhe të përgjegjshëm të Këshillit, si dhe kufizojnë lirinë e shprehjes dhe mundësinë e dhënies së mendimit kritik nga prokurorët publikë. Nevoja për ndryshimin e Kodit të Etikës u vërejt edhe nga Grupi i Shteteve kundër Korrupsionit (GRECO), pas së cilës, një propozim për ndryshimin e tij u përgatit më pas nga Shoqata e Prokurorëve Publikë.[142] Konkretisht, propozimi i Shoqatës ndjek rekomandimin e GRECO-s për ndryshimin e nenit 7 për futjen dhe shpjegimin e termit “mikpritje”, si dhe ndryshim në ndalimin e rreptë në nenin 10.[143]

Me zgjedhjen e autoriteteve të reja,[144] Shoqata gjithashtu ndërmori një sërë aktivitetesh për të përmirësuar transparencën dhe integritetin e prokurorëve publikë. Më saktësisht,

137 Iva Conevska Vangellova dhe Ismail Kamberi, “Raporti në hije për kapitullin 23 për periudhën midis prillit 2020 dhe shtatorit 2021”, („Извештај во сенка за Поглавјето 23 за периодот помеѓу април 2020 и септември 2021 година“), Shkup, 2021, https://bit.ly/3DQ0hOx; Angella Delevska dhe Beba Zhagar, “Raporti në hije për kapitullin 23 për periudhën tetor 2021 – shtator 2022”, („Извештај во сенка за Поглавјето 23 за периодот октомври 2021 – септември 2022“), Shkup, 29 dhjetor 2022, https://epi.org.mk/post/23011.

138 “Kodi i etikës së prokurorëve publikë në Republikën e Maqedonisë së Veriut”, („Етички кодекс на јавните обвинители во Република Северна Македонија“), Prokuroria Publike e Republikës së Maqedonisë së Veriut, 5 maj 2021,https://jorm.gov.mk/wp-content/uploads/2021/05/etichki-kodeks-na- %D1%98avnite-obviniteli-2021.pdf.

139 Koalicioni “Të gjithë për gjykim të drejtë”, “Raport për seancën e 78-të të Këshillit të prokurorëve publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut të mbajtur më 27.04.2023”, („Извештај за 78. седница на Советот на јавните обвинители на РСМ одржана на 27.04.2023 година“), https://drive.google.com/file/d/1qIOHQu2NZR0MkwoFz1o1iq8fG537RNFP/view.

140 “Lenqe Ristoska: Këshilli i Prokurorëve Publikë është burim i tregtisë me ndikim dhe duhet të reformohet”, („Ленче Ристоска: Советот на јавни обвинители е извор на тргување со влијание и треба да се реформира“), Tellma TV, 25 prill 2023, https://telma.com.mk/2023/04/25/lenche-ristoska-sovetot-na-javni-obviniteli-e-izvor-na-trguvanje-na-vlijanie-i-treba-da-se-reformira/.

141 “Këshilli i Prokurorëve Publikë u zemërua me Lenqe Ristovska që tha se po tregtonin me ndikim”, („Советот на јавни обвинители ѝ се налути на Ленче Ристовска за изјавата дека тргуваат со влијание“), Sakam da kazam, 27 prill 2023, https://sdk.mk/index.php/makedonija/sovetot-na-javni-obviniteli-se-naluti-na-lenche-ristoska-za-izjavata-deka-trguvaat-so-vlijanie/.

142 Kontributi në Raportin në hije nga Shoqata e Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 29.11.2023.

143 KPPRMV në seancën e tetëdhjetë e nëntë, të mbajtur më 08.11.2023, miratoi propozimin e Shoqatës së Prokurorëve Publikë për ndryshimin dhe plotsimin e Kodit të Etikës së Prokurorëve Publikë dhe miratoi Kodin e Etikës për ndryshimin dhe plotsimin e Kodit të Etikës së Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut. “Njoftim”, („Соопштение“), faqja zyrtare e Këshillit të Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 8 nëntor 2023, https://bit.ly/3GmL1ul.

144 “Zgjidhen organet e reja të Shoqatës së Prokurorëve Publik”, („Избрани нови органи на Здружението на јавните обвинители“), faqja zyrtare e Prokurorisë Publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 22 dhjetor 2022, https://jorm.gov.mk/izbrani-novi-organi-na-zdruzhenieto-na-javnite-obviniteli/.

ajo përmirësoi bashkëpunimin me institucione të caktuara,[145] oda[146] dhe organizata të shoqërisë civile,[147] përfshirë Shoqatën e Gazetarëve të Maqedonisë (SHGM),[148] dhe iu afrua zhvillimit të një faqeje të re në internet në të cilën do të vendoseshin informacione me interes publik.[149]

Siç u tha në raportet e mëparshme në hije , një aspekt i rëndësishëm i pavarësisë së sistemit gjyqësor është sigurisht pavarësia financiare. Konkretisht, pavarësia financiare dhe rritja e pagave në gjyqësor janë temë diskutimi prej disa vitesh. Megjithatë, ka konsistencë në politikat e autoriteteve legjislative dhe ekzekutive në moszbatimin e garancive ligjore për pavarësinë financiare të sistemit gjyqësor, duke mos siguruar 0.8% të PKB-së së detyrueshme në asnjë buxhet të shtetit që nga miratimi i Ligjit për Buxhetin Gjyqësor në 2010.[150] Madje, buxheti i gjykatave shënoi rënie në krahasim me vitin e kaluar, ku për vitin 2022 ishte 0.3% e PBB-së, ndërsa për vitin 2023 ishte 0.296% e PBB-së, që është 60% më pak se kufiri i përcaktuar ligjor.[151] Për këtë arsye buxheti i gjykatave është i pamjaftueshëm për të mbuluar të gjitha nevojat e gjyqësorit dhe gjithashtu nuk lejon investime më të mëdha financiare për funksionalitet më të madh, prandaj gjykatat funksionojnë me kushte minimale të punës. Është e nevojshme të shtohen fondet që i ndahen Prokurorisë Publike, si organ kyç për luftimin e krimit dhe korrupsionit. Shuma e miratuar e fondeve të caktuara për Prokurorinë Publike për vitin 2022 është 0.22% e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut,[152] kundrejt 0.4% të Buxhetit të përcaktuar ligjërisht të Republikës së Maqedonisë së Veriut,[153] i cili vazhdimisht nuk i plotëson nevojat e tij.

145 "Shoqata e Prokurorëve Publikë – iniciator i një protokolli për bashkëpunim midis Prokurorisë Publike dhe Ministrisë të Punëve të Brendshme", („Здружението на јавните обвинители – иницијатор на протокол за соработка меѓу Јавното обвинителство и МВР"), faqja zyrtare e Shoqatës së Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 30 mars 2023, http://212.13.72.102/mk/news/index/5.

146 "Nënshkruhet Memorandum bashkëpunimi midis Shoqatës së Prokurorëve Publikë dhe Shoqatës së Avokatëve", („Потпишан Меморандум за соработка меѓу Здружението на јавните обвинители и Адвокатската комора"), faqja zyrtare e Shoqatës së Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 23 maj 2023, http://212.13.72.102/mk/news/index/6.

147 "Takimi midis EPI dhe kryetarit të Shoqatës së Prokurorëve Publikë", („Средба помеѓу ЕПИ и претседателот на Здружението на јавните обвинители"), faqja zyrtare në facebook e Institutit të Politikave Evropiane (EPI) – Shkup, 3 shkurt 2023, https://www.facebook.com/EPI.Skopje/posts/pfbid031LhbM6fk8hFESvYtx5yKpND5PneZwy5H8vziVmZFsppe6QugsRfuSxvTvjWDKl.

148 "Bashkëpunimi për forcimin e transparencës – takimi me SHGM", („Соработка за јакнење на транспарентноста – средба со ЗНМ"), faqja zyrtare e Shoqatës së Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 18 shkurt 2023, http://212.13.72.102/mk/news/index/1.

149 Faqja e internetit do të jetë funksionale nga janari 2024. Kontributi në Raportin në hije nga Shoqata e Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 29.11.2023.

150 Qendra për Hulumtime dhe Analiza Juridike, "Plani për përmirësimin e punës dhe kushteve në gjykatat themelore", („План за подобрување на работата и условите во основните судови"), 2021, https://bit.ly/3h0kZUN.

151 Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut, «Përgjigje ndaj kërkesës për qasje të lirë në informacione publike», („Одговор по барање за слободен пристап до информации од јавен карактер"), 15 dhjetor 2023

152 Ibid.

153 Ligji për Prokurorinë Publike, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr. 42/2020.

## Digjitalizimi i gjyqësorit dhe AKMIS

Procesi i dixhitalizimit në gjyqësor është zbatuar përmes Këshillit për koordinimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në organet gjyqësore (Këshilli i TIK) pranë Ministrisë së Drejtësisë. Në periudhën raportuese, sipas Planit operacional për digjitalizimin e autoriteteve gjyqësore, dhe me mbështetjen e Misionit të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) në Shkup, përfundoi pajisja e pesë gjykatave në gjykatat themelore në Strumicë, Shtip, Kavadar, Gjykatën Themelore Civile Shkup dhe Gjykatën Themelore Penale Shkup (e cila u lansua zyrtarisht më 28 tetor 2022).[154] Pastaj, më 30 nëntor 2022, me mbështetjen e BE-së, u hap zyrtarisht gjykata digjitale më e madhe dhe më e pajisur në insitucionin ndëshkues-korrektues të Idrizovës.[155] Megjithatë, gjatë seancës së parë në gjykatë më 14 dhjetor 2022[156], u shfaqën reagime të caktuara, për shkak të mosrespektimit të parimit të publicitetit të procedimit penal.[157] Konkretisht, ka pasur një reagim ndaj njoftimit të parakohshëm të publikut për seancën, kohën dhe vendndodhjen e saktë të seancës në kalendarin e gjykimit në faqen zyrtare të gjykatës, si dhe mungesa e qasjes në gjykatën.[158] Prandaj, megjithëse gjykatat mund të devijojnë nga parimi i publicitetit për arsye të caktuara ligjore, përfshirë sigurinë e pjesëmarrësve në procedime, masat e sigurisë duhet të përshtaten dhe të jenë në përputhje me parimin e proporcionalitetit, pasi të shqyrtohen të gjitha alternativat e mundshme për të garantuar sigurinë në gjykatën.[159]

Deri në fund të periudhës raportuese, asnjë seancë tjetër nuk u mbajt në gjykatën digjitale në Institucionin ndëshkues-korrektues të Idrizovës. Përveç kësaj, pajisjet e prokuruara për pesë gjykatat e lartpërmendura përdoren vetëm nga Gjykata Themelore Penale Shkup dhe Gjykata Themelore Kavadar.[160]

Megjithatë, Këshilli i TIK-ut vazhdoi aktivitetet e tij të digjitalizimit. Këshilli i Buxhetit Gjyqësor miratoi kërkesën e Këshillit për të siguruar fonde për prokurimin e 46 licencave femida

154 "Njoftim publik: Projekti i përfunduar – Promovimi i gjykatës së re në Gjykatën Themelore Penale Shkup", („Соопштение за јавност: Завршен проект – Промоција на новата судница во Основниот кривичен суд Скопје"), portali gjyqësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut, 28 tetor 2022.

155 "Fillimi zyrtar i gjykatës më të madhe digjitale në vend", („Официјален почеток на најголемата дигитална судница во државата"), faqja zyrtare e Ministrisë së Drejtësisë, 30 nëntor 2022, https://www.pravda.gov.mk/vest/6453.

156 "Njoftim publik: Gjykimi i parë në gjykatëne re digjitale në kuadër të Burgut të Idrizovës", („Соопштение за јавност: Прво судење во новата дигитална судница во рамки на КПУ Идризово"), Portali Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut, 14 dhjetor 2022, https://bit.ly/3T57Vye.

157 Koalicioni "Të gjithë për gjykim të drejtë", "Ekonomia e procedurës nuk duhet të jetë në kurriz të publikut dhe transparencës", („Економичноста на постапката не смее да биде на сметка на јавноста и транспарентноста"), 2022, https://all4fairtrials.org.mk/wp-content/uploads/2023/04/25-JR-122022.pdf.

158 Ibid.

159 Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, Krestovski kundër Rusisë, nr. 14040/03, [Krestovskiy v. Russia (Application no. 14040/03)], 28 tetor 2010, https://hudoc.echr.coe.int/app/conversion/pdf/?library=ECHR&id=001-101314&filename=001-101314.pdf&TID=ihgdqbxnfi.

160 "Diskutimi i Raportit në hije për Kapitullin 23 për periudhën tetor 2022 – shtator 2023", („Дискусија за Извештајот во сенка за Поглавје 23 за периодот октомври 2022 – септември 2023 година"), faqja zyrtare e Institutit të Politikave Evropiane – Shkup, 22 dhjetor 2023, https://epi.org.mk/post/25506.

për incizim audio dhe tetë licenca për incizim audioviziv për gjykatat, dhe u mor vendim për zëvendësimin e të gjithë kompjuterëve që përdorin sistemin operativ XP.[161] Gjithashtu u ndërmorën aktivitete për të bërë më të shpejtë shërbimin e lëshimit elektronik të certifikatave nga regjistrat penalë për personat fizikë dhe juridikë.[162] Aktivitetet për përmirësimin e formës së certifikatave nga regjistrat penalë gjithashtu janë intensifikuar dhe rritur, me nevojën për të evidentuar numër arkivor, emrin e gjykatës dhe emrin e kryetarit të gjykatës, dhe si rezultat i indikacioneve nga gjykatat dhe pamundësisë së lëshimit të një apostile për certifikatat elektronike.[163]

Më 1 janar 2023, filloi zbatimi i detyrueshëm i sistemit të menaxhimit të lëndëve nga prokuroritë publike,[164] dhe në shtator 2023, Ministria e Drejtësisë, duke ndjekur shembullin e mbikëqyrjes së rregullt të Sistemit të Informacionit të Automatizuar për Menaxhimin e Lëndëve Gjyqësore (AKMIS), njoftoi mbikëqyrjen mbi sistemin për ndarjen elektronike të lëndëve në prokuroritë publike.[165] Në periudhën në vijim , pritet projektligji që plotëson Ligjin për Prokurorinë Publike për këtë qëllim të publikohet në Regjistrin Kombëtar Elektronik të Rregulloreve të Republikës së Maqedonisë së Veriut (ENER).[166]

Sipas raporteve[167] dhe planit për mbikëqyrje mbi funksionalitetin e AKMIS-it,[168] mbikëqyrja e funksionimit të AKMIS-it kryhet rregullisht. Gjegjësisht, sipas të dhënave të publikuara nga Ministria e Drejtësisë, në gjykata për vitin 2022 është kryer mbikëqyrja e 11 gjykatave,[169] dhe deri në shtator 2023 është bërë mbikëqyrja e dhjetë gjykatave.[170] Po ashtu, në raportin vjetor për zbatimin e Strategjisë së Ministrisë së Drejtësisë për vitin 2022, vërehet se mbikëqyrjet e rregullta japin rezultate, përkatësisht se është shënuar progres në organizimin e gjykatave rreth sistemit AKMIS.[171] Megjithatë, nga raportet në dispozicion të publikut të vizitave të punës në gjykata nga Këshilli Gjyqësor, u gjetën një sërë parregullsish në lidhje me shpërn-

161 Ministria e Drejtësisë, "Draft raporti gjysmëvjetor për punën e Këshillit për Koordinimin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në Autoritetet Gjyqësore për janar/qershor 2023", („Предлог полугодишен извештај за работа на Совет за координирање на информатичко-комуникациска технологија во правосудните органи за јануари/јуни 2023 година") https://bit.ly/412Y2D6.

162 Ibid.

163 Ibid.

164 "Nga 1 janari 2023, sistemi i menaxhimit të lëndëve në prokuroritë publike do të jetë i detyrueshëm", („Од 1 јануари 2023 година задолжително ќе се применува системот за управување со предмети во јавните обвинителства"), faqja zyrtare e Ministrisë së Drejtësisë, 1 janar 2023, https://pravda.gov.mk/vest/6465.

165 "Ministria e Drejtësisë do të mbikëqyrë sistemin për shpërndarjen elektronike të lëndëve në prokuroritë publike", („Министерството за правда ќе врши надзор над системот за електронска распределба на предметите во јавните обвинителства"), faqja zyrtare e Ministrisë së Drejtësisë, 16 shtator 2023, https://pravda.gov.mk/vest/6595.

166 Ibid.

167 „Procesverbale nga këqyrje në gjykata", („Записници од увид во судови"), Faqja zyrtare e Ministrisë së Drejtësisë, https://www.pravda.gov.mk/resursi/22.

168 Plani i mbikëqyrjes 08-1001/1 nga 12.02.2020 dhe Plani i mbikëqyrjes 08-33/4 nga 31.01.2022.

169 Ministria e Drejtësisë, "Raporti vjetor për zbatimin e Strategjisë për Reformë në Sektorin Gjyqësor 2017-2022 për vitin 2022", („Годишен извештај за имплементација на Стратегијата за реформа на правосудниот сектор 2017-2022 за 2022 година"), 2022, https://bit.ly/47VOYCn.

170 Ministria e Drejtësisë, "Procesverbal nga këqyrje në gjykata", („Записници од увид во судови"), https://www.pravda.gov.mk/resursi/22.

171 Ibid.

darjen e lëndëve përmes sistemit AKMIS dhe manipulimin e tij.[172] Ky është rasti me Gjykatën Themelore të Kumanovës, ku, përveç abuzimit me sistemin AKMIS nga ushtruesi i detyrës së kryetarit të gjykatës, mbikëqyrja e kryer në shkurt 2023 gjeti shkelje të reputacionit të gjyqësorit, si dhe shkelje të rënda të parimit të mosdiskriminimit.[173] Në qershor të vitit 2023, ndaj kryetarit të Gjykatës Administrative Shkup është bërë kallëzim penal nga punonjësit e gjykatës për abuzim të sistemit AKMIS.[174] Abuzimet e identifikuara të sistemit AKMIS më pas iu nënshtruan akuzave dhe zhvendosjes së përgjegjësisë midis Ministrit të Drejtësisë dhe Këshillit Gjyqësor.[175]

Dobësitë e regjistruara të sistemit AKMIS janë gjithashtu për shkak të vjetërsisë së tij që ka nevojë për ndërhyrje më të mëdha.[176] Për këtë qëllim, u identifikua nevoja për përditësimin e sistemit ekzistues ose futjen e një sistemi të ri softuerik, për të cilin u premtua një donacion në vlerë prej 6.8 milionë euro nga Mbretëria e Norvegjisë.[177] Më pas, u organizuan edhe vizita studimore në Mbretërinë e Norvegjisë për të njohur gjyqtarët maqedonas dhe anëtarët e Këshillit të TIK-ut me karakteristikat e sistemit norvegjez të menaxhimit të lëndëve gjyqësore, i cili në të ardhmen do të shërbente si shembull për zhvillimin e sistemit të ri AKMIS në vend.[178] Megjithatë, për shkak të fondeve të padisponueshme nga shteti për mirëmbajtjen e sistemit të ri AKMIS, implementimi ka stagnuar.[179]

172 "Raportet (mujore, tremujore, gjysmëvjetore, vjetore)", („Извештаи (месечен, квартален, полугодишен, годишен)"), faqja zyrtare e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, https://bit.ly/3uYoTnO.

173 Marrëdhëniet ndërpersonale të përkeqsuara në gjykatën e Kumanovës", („Разгорени" меѓучовечките односи во кумановскиот суд"), Radio Evropa e Lirë, 12 korrik 2023, https://www.slobodnaevropa.mk/a/razgoreni-megjuchovechkite-odnosi-vo-kumanovskiot-sud-/32498983.html.

174 Punonjësit e gjykatës dyshojnë në ndarjen manuale të lëndëve, parashkrimin e qëllimshëm të mbi 190 lëndëve nga viti 2021 deri në vitin 2023, kryesisht çështje financiare nga Drejtoria Doganore dhe Drejtoria e të Ardhurave Publike, si dhe punësimin e të afërmve të ngushtë. Denoncimi penal i është përcjellë Kryeministrit, Zëvendëskryeministrit përgjegjës për politikat e mirëqeverisjes, Policisë Financiare dhe Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit. Kryetari i akuzuar i gjykatës i hodhi poshtë pretendimet si të njëanshme. Deri më tani, vetëm Policia Financiare ka hapur një çështje për të hedhur dritë mbi pretendimet, pa një afat kohor për veprime të mëtejshme. "Akuza penale kundër kreut të Gjykatës Administrative, Burim Sejdini", („Кривична пријава против шефот на Управниот суд, Бурим Сејдини"), Alsat M, 9 korrik 2023, https://alsat.mk/en/krivichna-prijava-protiv-shefot-na-upravniot-sud-burim-sejdini/.

175 Ministri i Drejtësisë vuri në dukje se kishin kaluar pesë muaj nga vizita në Këshillin e Gjykatës dhe një kërkesë urgjente ishte paraqitur në Këshillin Gjyqësor, por ende nuk ishte marrë asnjë masë. Në përgjigje, Këshilli Gjyqësor sqaroi se AKMIS është nën juridiksionin e Ministrisë, e cila kryen mbikëqyrje të rregullt dhe të jashtëzakonshme të gjykatave në lidhje me të. Nëse identifikohen devijime ose parregullsi, Ministria mund të përgatisë një raport për të filluar procedurat e duhura. "Njoftim", („Соопштение"), faqja zyrtare e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 12 korrik 2023, https://bit.ly/3Q1cvKy.

176 "Diskutim për Raportin në hije për kapitullin 23 për periudhën tetor 2021 - shtator 2022", („Дискусија за Извештајот во сенка за Поглавје 23 за периодот октомври 2021 – септември 2022 година"), Uebfaqja zyrtare e Institutit për Politikë Evropiane - Shkup, 25 nëntor 2022, https://epi.org.mk/post/ 22609.

177 "Norvegjia do të dhurojë 6.8 milion euro për një sistem të ri AKMIS", („Норвешка ќе донира 6,8 милиони евра за нов АКМИС систем"), Kanall 5, 19 shtator 2022, https://kanal5.com.mk/norveshka-kje-donira-6-8-milioni-evra-za-nov-akmis-sistem/a547593.

178 "Përfaqësuesit e Gjykatës Supreme bënë një vizitë studimore në Osllo për promovimin e sistemit AKMIS", („Претставници на Врховниот суд оствариja студиска посета во Осло за унапредувањето на системот АКМИС"), faqja zyrtare e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 26 tetor 2022, https://bit.ly/3D27b3Y.

179 "Diskutimi i Raportit në hije për Kapitullin 23 për periudhën tetor 2022 – shtator 2023", („Дискусија за Извештајот во сенка за Поглавје 23 за периодот октомври 2022 – септември 2023 година"), faqja zyrtare e Institutit të Politikave Evropiane – Shkup, 22 dhjetor 2023, https://epi.org.mk/post/25506.

Edhe krahas kornizës ligjore të vendosur që së bashku me Kushtetutën e RMV-së garantojnë pavarësinë e gjyqësorit dhe parimin e ndarjes së pushtetit, mosbesimi i qytetarëve tek gjyqësori është në rritje, siç tregohet nga hulumtimi i fundit i Barometrit Ballkanik, ku krahasuar me vitin paraprak, Maqedonia e Veriut ka shënuar rritje të mosbesimit me 10%. As besimi në prokurorinë publike nuk është i lartë.

Ka nevojë për zbatim konsistent të dispozitave ligjore dhe dispozitave të Rregullores së punës së KGJRMV-së në lidhje me transparencën dhe publicitetin në punën e Këshillit Gjyqësor, si dhe shfuqizimin e praktikës së marrjes së vendimeve për zgjedhjen dhe shkarkimin e gjyqtarëve pa argumentim dhe pas dyerve të mbyllura;

Publikimi i vendimeve të arsyetuara për zgjedhjen, ngritjen në detyrë dhe shkarkimin e prokurorëve publikë, si dhe vendimet e tjera të Këshillit të Prokurorëve Publikë , është i një rëndësie të veçantë për kthimin e besimit të qytetarëve në prokurorinë publike. Nevojitet transparencë aktive edhe në pjesën e marrëdhënieve me publikun dhe publikimin e informacionit në lidhje me aktivitetet e përditshme të Këshillit të Prokurorëve Publikë me qëllim afrimin e punës së Këshillit me publikun dhe afirmimin e kompetencave të Këshillit.;

Nevojitet rritje e buxhetit të gjyqësorit dhe prokurorisë publike. Masat në Strategjinë për reforma në Sektorin Gjyqësor 2017-2022, të cilat parashikojnë rritjen e buxhetit gjyqësor, nuk janë zbatuar ende. Ligji për buxhetin gjyqësor në lidhje me ndarjen e PBB-së për gjyqësorin nuk zbatohet prej vitesh;

Nevojitet të analizohet aplikimi aktual i sistemit AKMIS dhe të përcaktohet nëse duhet të futet një sistem i ri softuer ose të përmirësohet ai ekzistuesi. Në këtë drejtim, është e nevojshme të përcaktohen fondet në dispozicion nga shteti në mënyrë që të mirëmbahet vazhdimisht sistemi. Ekziston gjithashtu nevoja për mbikëqyrje më të plotë të funksionalitetit të sistemit, si dhe ndëshkim në kohë për abuzimet e tij.

# PËRGJEGJËSI

Sipas ndryshimeve ligjore të vitit 2019,[180] në periudhën raportuese janë marrë tre vendime për shkarkime të gjyqtarëve.[181] Baza për shkarkimin në dy prej vendimeve është kryerja joprofesionale dhe e pamatur e funksionit – ekzekutimi i qëllimshëm dhe i pajustifikuar i një gabimi të madh profesional në interpretimin e ndryshëm të ligjit dhe fakteve, ndërsa në vendimin e tretë, baza për shkarkimin është mosplanifikimi i seancave për lëndët e caktuara.[182] Në periudhën raportuese, asnjë kryetar gjykate nuk është shkarkuar. Për më tepër, në periudhën raportuese, KGJRMV nuk ka filluar procedim disiplinor ndaj gjyqtarëve dhe kryetarëve të gjykatave, si dhe ndaj anëtarëve të KGJRMV.[183]

Lidhur me procedimin e parashtresave, në periudhën raportuese KGJRMV ka proceduar mbi 446 parashtresa nga shtetas dhe persona juridikë për punën e gjykatave, kryetarëve të gjykatave dhe gjyqtarëve, nga të cilat 372 parashtresa ose 85% janë refuzuar si të paarsyeshme.[184] Shumica e parashtresave të paraqitura, njësoj si në periudhat e mëparshme raportuese, janë refuzuar si të paarsyeshme sepse parashtruesit në parashtresë bëjnë pretendime ankimore, për *të cilat* kanë juridiksion vetëm shkallët më të larta gjyqësore.[185]Prandaj, është e qartë se me kalimin e viteve ka mbizotëruar i njëjti problem, domethënë qytetarët nuk e kuptojnë konceptin dhe qëllimin e parashtresave, dhe KGJRMV është jashtëzakonisht pasive në lidhje me problemin. Në lidhje me mënyrën se si KGJRMV vepron në lidhje me parashtresat, praktika e referimit të parashtresës nga një anëtar i Këshillit me disa fjali pa hyrë në pjesën thelbësore dhe arsyet pse parashtresa konsiderohet e arsyeshme ose e paarsyeshme dhe më pas e njëjta miratohet njëzëri nga anëtarët e KGJRMV-së sipas propozimit të raportuesit që e referon parashtresën.[186] Parashtresat që janë të arsyeshme, nga ana tjetër, nuk kanë mundësinë të hulumtohen më tutje.[187] Informacioni rreth tyre mungon edhe në raportet vjetore për punën e Këshillit Gjyqësor, brenda të cilit gjendet vetëm numri i përgjithshëm i parashtresave të arsyeshme, pa dhënë llogari se pse ato janë të arsyeshme, si dhe çfarë masash janë marrë

180 "Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Gjykatat", („Закон за изменување и дополнување на Законот за судовите"), Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr. 96/2019; "Ligji për Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut", („Закон за Судски совет на Република Северна Македонија"), Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 102/2019.

181 Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut, «Përgjigje ndaj kërkesës për qasje të lirë në informacione publike», („Одговор по барање за слободен пристап до информации од јавен карактер"), 15 dhjetor 2023.

182 Ibid.

183 Ibid.

184 Petkovska dhe Tutikj, "Raporti vjetor i monitorimit për punën e Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit të Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut", („Годишен мониторинг извештај за работата на Судскиот совет и Советот на јавни обвинители на Република Северна Македонија").

185 Ibid.

186 Ibid.

187 Ibid.

nga koordinatori i caktuar gjatë atij viti për gjykatën në fjalë, i cili është kompetent për të monitoruar punën e gjyqtarit të cilit i është referuar parashtresa e paraqitur. Prandaj, është e nevojshme të rriten përpjekjet nga ana e KGJRMV-së për të edukuar qytetarët për përdorimin e duhur të këtij mekanizmi, si dhe për të informuar në mënyrë adekuate qytetarët në lidhje me trajtimin e parashtresave të arsyeshme, në mënyrë që të rritet besimi në gjyqësor.

Sipas ndryshimeve ligjore të vitit 2020,[188] në periudhën raportuese nuk është shkarkuar asnjë prokuror publik.[189]

Pas kryerjes së procedurës disiplinore ndaj tre prokurorëve publikë të përfshirë në kontrollin e Drejtorisë të Policisë Financiare[190] dhe shqyrtimit të raportit të prokurorit-raportuese, më 30 mars 2023, Komisioni për Përcaktimin e Përgjegjësisë Disiplinore të një prokurori publik në kryerjen e funkcionit të prokurorit publik në PPRMV miratoi vendim për konstatimin se drejtoresha e mëparshme e PTHPNKOK kishte kryer një vepër të rëndë disiplinore, në përputhje me të cilën ajo paraqiti një propozim për shkarkimin e saj në KPPRMV.[191] Prokurorja e dytë publike e PTHPNKOK mori një ulje prej 30% të pagës së saj mujore për një periudhë prej gjashtë muajsh si masë disiplinore, dhe prokurorja e tretë publike u lirua nga përgjegjësia.[192] Për propozimin për shkarkim, ish-drejtoresha e PTHPNKOK tha në një emision debati në televizionin kombëtar se bëhej fjalë për presion dhe kërcënime që të dorëhiqet,[193] pasi kishte nisur hetimin kundër ish-Sekretarit të Përgjithshëm të Qeverisë për prokurimin e softuerëve për kundërvajtje në komunikacion.[194]

Paralajmërimet rreth procedurave të mundshme disiplinore ndaj prokurorëve publikë me mungesa të shumta të pajustifikuara u dërguan nga Prokurori Publik i Prokurorisë Publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut (PPRMV), si rezultat i raportit të miratuar nga KGJRMV nga

188 "Ligji për Prokurorinë Publike", („Закон за јавно обвинителство"), Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr. 42/2020; "Ligji për ndryshimin e Ligjit për Këshillin e Prokurorëve Publikë", („Закон за изменување и дополнување на Законот за советот на јавни обвинители"), Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr. 42/2020.

189 Këshilli i Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut, «Përgjigje ndaj kërkesës për qasje të lirë në informacionin publik», („Одговор по барање за слободен пристап до информации од јавен карактер"), 5 dhjetor 2023.

190 "Njoftim", („Соопштение"), faqja zyrtare e Prokurorisë Publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 1 gusht 2022.

191 "Njoftim", („Соопштение"), faqja zyrtare e Prokurorisë Publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 30 mars 2023, https://jorm.gov.mk/sooopshtenie/.

192 Ibid.

193 Villma Ruskovska, Top Tema, Tellma TV, 3 prill 2023, https://www.youtube.com/watch?v=9elwuTJvUXI&t=488s.

194 Villma Ruskovska tregoi në emisionin e debatit se asaj iu ofrua posti i Zëvendës Prokurores së Përgjithshme të PPRMV në këmbim të dorëheqjes së saj. Në të kundërt, nipit të motrës së saj, një prokuror publik në Prokurorinë Themelore Publike në Kumanovë, iu premtua një punë në Prokurorinë e Lartë Publike në Shkup. Ajo theksoi se masa disiplinore ndaj saj dhe propozimi për shkarkimin e saj kishin për qëllim ta "ngjisin për muri".

një vizitë pune në Gjykatën Themelore Penale Shkup.[195] Raporti i vizitës së punës në gjykatë tregoi një zgjatje të shumëfishtë të seancave gjyqësore për shkak të mungesës së prokurorëve publikë, pas së cilës Prokurori Publik i Prokurorisë Publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut kërkoi një raport të detajuar nga KGJRMV për vonesat e seancave dhe justifikimet për mungesat nga prokurorët publikë.[196]

Sa i përket veprimit mbi parashtresat, në vitin 2022, KPPRMV ka vepruar mbi të gjitha 182 parashtresat e paraqitura, të cilat, nga ana tjetër, paraqesin ulje të numrit të parashtresave të paraqitura me 78% në krahasim me vitin paraprak.[197] Shumica e parashtresave janë dorëzuar nga personat e dëmtuar për shprehjen e pakënaqësisë së tyre me kohëzgjatjen e procedurës dhe mosveprimi në kohë nga ana e prokurorit publik që ka vepruar në një lëndë konkrete, si dhe vendimet e prokurorit publik për refuzimin e rastit.[198] I parëndësishëm është numri i parashtresave në të cilat shprehet pakënaqësia për shkak të parashkrimit së ndjekjes penale dhe pamundësisë së prokurorit publik për të ndërmarrë veprime për kallëzimin penal. Në lidhje me trajtimin e parashtresave gjatë seancave, nga ana tjetër, mund të thuhet se KPPRMV rrallë paraqet, shpjegon apo drejton ndonjë lloj diskutimi në lidhje me një parashtresë gjatë seancave.[199] Gjithashtu, në Raportin Vjetor të KPPRMV-së për vitin 2022 thuhet se gjatë verifikimit të pretendimeve nga parashtresat, ka pasur lëshime në veprimet e prokurorëve publikë të natyrës formale, dhe në një pjesë të vogël mosveprime të natyrës thelbësore.[200]

Gjatë periudhës raportuese, u ngritën shqetësime nga ana e organizatave të shoqërisë civile në lidhje me mungesën e njohurive të KPPRMV-së me punën dhe trajtimin e lëndëve nga dy prokurorë publikë të cilët, pas katër vitesh punë në Prokurorinë Speciale Publike (PSP), u kthyen në prokurorinë amë. Ky shqetësim është shprehur pas shkresës së Prokurorit Publik nga Prokuroria Publike në Kumanovë, ndërsa lajmi është publikuar nga Koalicioni "Të gjithë për gjykim të drejtë".[201]

195 "Prokurori Publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut i dërgoi një kërkesë me shkrim Këshillit Gjyqësor", („Јавниот обвинител на РСМ испрати писмено барање до Судскиот совет"), faqja zyrtare e Prokurorisë Publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 1 shtator 2023, https://jorm.gov.mk/javniot-obvinitel-na-rsm-isprati-pismeno-barane-do-sudskiot-sovet/.

196 Ibid.

197 Këshilli i prokurorëve publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut, «Raporti vjetor për punën e Këshillit të prokurorëve publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2022», („Годишен извештај за работата на Советот на јавни обвинители на Република Северна Македонија за 2022 година"), mars 2023, https://bit.ly/3RzdmEm.

198 Ibid.

199 Emilia Spasovska, "Raport nga monitorimi i Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit të Prokurorëve Publikë në vitin 2022", („Извештај од мониторингот на Судскиот совет и Советот на јавни обвинители во 2022 година"), (Koalicioni "Të gjithë për gjykim të drejtë", 2022).

200 Këshilli i prokurorëve publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut, «Raporti vjetor për punën e Këshillit të prokurorëve publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2022», („Годишен извештај за работата на Советот на јавни обвинители на Република Северна Македонија за 2022 година"), mars 2023, https://bit.ly/3RzdmEm.

201 "Raport nga seanca e 78-të e Këshillit të Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut të mbajtur më 27.04. 2023", („Извештај од 78. седница на Советот на јавни обвинители на РСМ одржана на 27.04. 2023"), Koalicioni "Të gjithë për gjykim të drejtë", https://drive.google.com/file/d/1qIOHQu2NZR0MkwoFz1o1iq8fG537RNFP/view?fbclid=IwAR195t3PmzVIkX6vRSZCzAU6r1Dwde4kSYLEthrnETYIj2B8dVm-IW_8qRc.

Neni 9 i Ligjit për Këshillin e Prokurorëve Publikë[202] përcakton kompetencat e Këshillit, përfshirë detyrimin për shqyrtimin dhe vlerësimin e raporteve vjetore nga prokuroritë publike, kështu që është shqetësuese se si gjatë vlerësimit të raporteve nga prokuroritë, ku janë caktuar këta prokurorë, Këshilli nuk pa asnjë lëshim. Përveç kësaj, një nga prokurorët publikë në fjalë është gjithashtu përgjegjës për zyrën ndërlidhëse me Eurojust, e cila kërkon përgatitjen e raporteve të veçanta për punën e tyre në lidhje me atë funksion. Në këtë drejtim, Prokurori Publik i Prokurorisë Publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut ka marrë vendime të veçanta me çka prokurorëve publikë të lartpërmendur iu jipen detyra dhe detyrime në lidhje me kujdesin e materialeve, inventarit dhe ambienteve të përdorura nga ish PSP-ja.[203]

Reagimet publike të shkaktuara nga anulimi i vendimeve të shkallës së parë në rastet "Target-Fortresa"[204] dhe "Trezor"[205] nga Gjykata e Apelit Shkup dhe kthimi i tyre në rigjykim rezultuan në fillimin e një hetimi nga Këshilli Gjyqësor.[206] Me hetimin u përcaktua një shtyrje e pajustifikuar të lëndëve në përputhje me të cilat u shkelën afatet ligjore.[207] Edhe pse gjyqtari-raportues në rastin e parë përmendi numrin e madh të lëndëve të planifikuara të profilit të lartë si një shpjegim për këtë situatë, hetimi zbuloi se shumica e lëndëve të planifikuara ishin zgjidhur, duke përfshirë lëndë më të reja nga viti 2022.[208] Janë përcaktuar mangësi në lidhje me shtyrjen e lëndës nga i njëjti gjyqtar-raportues edhe për lëndën "Transportues".[209] Nga ana tjetër gjyqtari-raportues për lëndën e dytë nuk ka dhënë asnjë shpjegim se përse i janë dashur 5 muaj për të shkruar vendimin. Sipas gjetjeve, në periudhën në vijim pritet një vendim i drejtë nga Këshilli Gjyqësor.[210]

202 "Ligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Këshillin e Prokurorëve Publikë", („Закон за изменување и дополнување на Законот за Советот на јавните обвинители"), Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr. 42/2020.

203 Ibid.

204 "Njoftim për publikun", („Соопштение за јавност"), Gjykata e Apelit Shkup – Portali Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut, 16 dhjetor 2022, https://bit.ly/3Rg4S3H.

205 "Njoftim për publikun", („Соопштение за јавност"), Gjykata e Apelit Shkup – Portali Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut, 25 nëntor 2022, https://bit.ly/3R0Z2m5.

206 "Njoftim nga seanca e 427-të e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut – 11.01.2023", („Соопштение од 427. седница на Судскиот совет на РСМ – 11.01.2023 година"), faqja zyrtare e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, https://bit.ly/3oazSaw.

207 Ibid.

208 "Gjyqi i Apelit në mënyrë të pajustifikuar ka mbajtur në një sirtar lëndën e Mijallkovit e cila është afër parashkrimit, konstatoi Këshilli Gjyqësor, ndërsa lëndët më të reja u zgjidhën", („Апелација неоправдано го чувала во фиока предметот за Мијалков кој е блиску да застари констатираше Судски совет, а се решавале понови предмети"), A1 on, 11 janar 2023, https://a1on.mk/macedonia/apelacija-neopravdano-go-chuvala-vo-fioka-predmetot-za-mijalkov-koj-e-blisku-da-zastari-konstatirashe-sudski-sovet-a-se-reshavale-ponovi-predmeti/.

209 Lëshimet në lëndën "Allfa", vrasje e ndodhur 14 vjet më parë, dhe ende po vendoset për lëndën. Verdikti i shkallës së fundit është dhënë në vitin 2019, dhe gjyqtar-raportues është Zoran Dimitrievski. «Lëshime të përcaktuara tek gjyqtarët në Apel në katër lëndë, por asnjë përgjegjësi deri më tani», („Утврдени пропусти кај судии во Апелација во четири предмети, но одговорност засега нема"), Fokus, 11 janar 2023, https://fokus.mk/utvrdeni-propusti-na-svvvudii-vo-apelatsija-vo-chetiri-predmeti-no-odgovornost-zasega-nema/.

210 "A do të ketë përgjegjësi?", („Ќе има ли одговорност?"), TV 24, 12 janar 2023, https://24.mk/details/kje-ima-li-odgovornost.

Këshilli Gjyqësor vazhdon të refuzojë shumicën e parashtresave të qytetarëve, kryesisht për shkak të edukimit të pamjaftueshëm të qytetarëve për qëllimin e parashtresave. Prandaj, është e nevojshme të rriten përpjekjet nga ana e KGJRMV-së për të edukuar qytetarët për përdorimin e duhur të këtij mekanizmi, si dhe për të informuar në mënyrë adekuate qytetarët në lidhje me trajtimin e parashtresave të arsyeshme, në mënyrë që të rritet besimi në gjyqësor;

Vazhdoi trendi rritës i parashtresave të paraqitura në Këshillin e Prokurorëve Publikë, por Këshilli nuk luan rol të madh në mbikëqyrjen e punës së prokurorëve publikë, duke pasur parasysh se nëse anëtarët e Këshillit konsiderojnë se parashtresat janë të arsyeshme, thjesht dërgojnë ato te Prokurori Publik i RMV-së, i cili më pas duhet të ndërmarrë veprime për kontrollimin e prokurorëve publik. Nga ana tjetër, edhe Prokuroria Publike ka kompetencë për pranimin e parashtresave nga qytetarët, kështu që shtrohet pyetja, cila është nevoja që të ketë dy institucione kompetente për të vepruar mbi parashtresat? Kjo mund të jetë gjithashtu habitëse për qytetarët që nuk do të dinin se ku të paraqesnin një parashtresë. Në atë drejtim duhet dhënë më shumë kompetencë në trajtimin e parashtresave Këshillit të Prokurorëve Publikë, aq më tepër që është vërejtur se PPRMV nuk u përgjigjet parashtresave të paraqitura dhe në të njëjtën kohë do të ishte më racionale dhe efikase si për qytetarët ashtu edhe për prokurorët publikë, të paraqiten përmes një institucioni.

Është e nevojshme që të dy këshillat të paraqesin, shpjegojnë ose udhëheqin një diskutim në lidhje me parashtresat gjatë seancave, si dhe shpalljen e rezultatit të procedurës pas një parashtrese që është miratuar si e arsyeshme. Kjo do të rriste transparencën në punën e dy këshillave, si dhe besimin e qytetarëve tek gjyqësori.

# PROFESIONALIZMI DHE KOMPETENCA

Kuadri ligjor, si dhe garancitë për zbatimin e drejtë të sistemit të meritës, tashmë janë krijuar[211] dhe janë shënuar në raportet e mëparshme në hije.[212]

Në periudhën raportuese, Këshilli Gjyqësor përfundimisht, pas një periudhe të gjatë kohore, duke zbatuar kriteret e reja për zgjedhjen e gjyqtarëve në një gjykatë më të lartë, si dhe duke kryer një vlerësim të jashtëzakonshëm të kandidatëve për gjyqtarë, zgjodhi gjyqtarë në GJSRMV dhe në Gjykatën e Apelit Gostivar.[213] Konkretisht, në seancën e mbajtur më 29 mars 2023, u zgjodhën dy gjyqtarë për fushën civile të GJSRMV-së dhe dy gjyqtarë për fushën penale në Gjykatën e Apelit Gostivar.[214] Asnjë nga pesë kandidatët për fushën penale të GJSRMV nuk mori numrin e kërkuar të votave për t'u zgjedhur.[215] Në votim, nuk ka pasur asnjë diskutim dhe shpjegim nga anëtarët e KGJRMV për arsyen e votimit kundër të gjithë kandidatëve të regjistruar.[216] Nuk u dha shpjegim adekuat për përzgjedhjen e kandidatëve të renditur në vendin e pestë dhe gjashtë nga renditja përfundimtare për kandidatët për gjyqtarë për fushën penale në Gjykatën e Apelit Gostivar.[217] Ndër të tjera, procedura për zgjedhjen e tetë gjyqtarëve në Gjykatën e Apelit të Shkupit, e filluar më pesë korrik 2021 nuk ka përfunduar ende. Një nga arsyet e dhëna për bllokimin e procedurës ishte mungesa e një institucioni të akredituar për

211 Me miratimin e ndryshimeve dhe plotësimeve të fundit në Ligjin për Gjykatat, Ligjin e ri për Këshillin Gjyqësor, Ligjin për Prokurorinë Publike dhe ndryshimet dhe plotësimet në Ligjin për Këshillin e Prokurorëve Publikë, u krijua një kuadër ligjor që është kryesisht në përputhje me standardet ndërkombëtare në lidhje me përzgjedhjen e gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë bazuar në një sistem meritash. Akademia për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë është e vetmja pikë hyrëse për krijimin e personelit të ri në gjyqësor dhe prokurorinë publike. Përsa i përket mbrojtjes ligjore të gjyqtarëve për masa të caktuara që ndërmerren ndaj gjyqtarëve, si një lloj garancie u fut e drejta e apelit në Këshillin e Apelit pranë Gjykatës së Lartë, si në lidhje me (mos)zgjedhjen e gjyqtarëve edhe të kryetarëve të gjykatave ashtu edhe në lidhje me vendimin për vlerësim.

212 "Raportet në hije mbi Kapitullin 23, botime", („Извештаи во сенка за Поглавје 23, изданија"), faqja zyrtare e Institutit të Politikave Evropiane (EPI) – Shkup, https://bit.ly/3tUCPMR.

213 "Njoftim nga seanca e 436-të e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut – 29.03.2023", („Соопштение од 436. седница на Судскиот совет на РСМ – 29.03.2023 година"), faqja zyrtare e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, https://bit.ly/40MIq5U.

214 Ibid.

215 Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Enver Bexheti ishte një nga kandidatët e refuzuar për fushën penale të Gjykatës së Lartë. Bexheti u bë i njohur për publikun si gjyqtar-hetues, i cili, sipas analizës së Këshillit Gjyqësor, për muaj të tërë e fshehu lëndën "Target-Fortresa" në një sirtar, dhe në të cilin Sasho Mijallkov, Nikolla Gruevski dhe ish-punonjës të tjerë të Administratës së Sigurisë dhe Kundërzbulimit u akuzuan për veprën e përgjimit të paligjshëm. Pavarësisht zbulimit të zgjatjes së procedurave gjyqësore dhe politikës së publikuar të Këshillit Gjyqësor për të përcaktuar përgjegjësinë e mundshme për lëshime, Bexheti përsëri mori katër vota, dy herë më pak se sa ishte e nevojshme. Kandidatët e tjerë morën të njëjtin numër votash, pra katër pro dhe tetë kundër, me përjashtim të kandidates për gjyqtare supreme Danka Ristova, e cila mori gjashtë vota pro. "Gjykata Supreme mbetet me vetëm pesë gjyqtarë", („И Врховниот суд останува со само петмина судии"), Slloboden Peçat, 29 mars 2023, https://www.slobodenpecat.mk/i-vrhovniot-sud-ostanuva-so-samo-petmina-sudii/.

216 Këshilli vetëm arriti në përfundimin se asnjë gjykatës penal nuk u zgjodh në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, pa dhënë asnjë shpjegim të shkurtër se pse anëtarët besojnë se asnjë nga kandidatët nuk duhet të ngrihet në detyrë. Në këtë drejtim, është e qartë se ligji nuk parashikon një detyrim për anëtarët për të shpjeguar vendimin e tyre kundër zgjedhjes së një kandidati për gjyqtar, siç kërkohet prej tyre kur mbështesin zgjedhjen e një kandidati të veçantë për gjyqtar, megjithatë, kjo nuk do të thotë asesi se ata nuk mund dhe nuk duhet ta bëjnë këtë.

217 "Këshilli Gjyqësor zgjodhi Daut Rustemi dhe Aleksandar Milosheski si gjyqtarë në Gjykatën e Apelit Gostivar", („Судскиот совет ги избра Даут Рустеми и Александар Милошески за судии во Апелациски суд Гостивар"), A1 on, 29 mars 2023, https://a1on.mk/macedonia/sudskiot-sovet-gi-izbra-daut-rustemi-i-aleksandar-milosheski-za-sudii-vo-apelacionen-sud-gostivar/.

kryerjen e testit psikologjik dhe testit të integritetit të kandidatëve.[218] Megjithatë, pas marrjes së mendimit nga Qeveria më 15 qershor 2023, KGJRMV lidhi një marrëveshje të re aneksi për një vit me kompaninë "Vista Group" dhe Institutin për Kërkime Sociologjike dhe Politiko-Ligjore, të cilat deri më tani kanë kryer testet.[219] Kjo është një zgjidhje e përkohshme derisa një institucion ose organ tjetër të marrë akreditimin.[220]

Pas zgjatjes së kontratës me kompaninë e lartpërmendur dhe institutin, janë përzgjedhur të gjithë 30 kandidatët për gjyqtarë të brezit të shtatë të pjesëmarrësve në trajnimin fillestar në AGJPP.[221] Gjegjësisht, më 25 korrik 2023, njëzet e katër gjyqtarë u zgjodhën në shumicën e gjykatave themelore në vend, duke përfshirë Gjykatën Themelore Manastir, Gjykatën Themelore Sveti Nikollë, Gjykatën Themelore Strumicë, Gjykatën Themelore Tetovë, Gjykatën Themelore Civile Shkup, Gjykatën Themelore Penale Shkup dhe Gjykatën Themelore Strumicë. Procesi i përzgjedhjes[222] u bazua në thirrjet e publikuara më 6 prill[223] dhe më 30 maj 2023.[224] Gjashtë gjyqtarët e mbetur u zgjodhën më 26 shtator 2023,[225] bazuar në thirrjen e lëshuar më 8 gusht 2023.[226] Sipas shpalljeve të publikuara për zgjedhje në gjykatat themelore dhe kërkesave të paraqitura nga kandidatët që kanë përfunduar me sukses trajnimin fillestar në AGJPP, përshtypja e përgjithshme është se nuk ka interes për aplikimin e tyre në shpalljen për zgjedhjen e gjyqtarëve për gjykatat themelore në qytetet më të vogla në vend. Pra, në shumë prej

218 Pas skadimit të aneksit të fundit të kontratës më 16 dhjetor 2022, ish-kryetarja e Këshillit Gjyqësor i kërkoi Qeverisë një mendim për vazhdimin e bashkëpunimit, për të cilin Instituti për Akreditim tha se kompania dhe instituti i mësipërm nuk janë të akredituar dhe nuk ka asnjë institucion në vend me akreditimin e nevojshëm. Gjithashtu, Ministria e Drejtësisë i është përgjigjur Këshillit se problemi është zgjidhur dhe se testi psikologjik dhe testi i integritetit duhet të bëhen në AGJPP. Por qëndrimi i AGJPP-së ishte se testet e tyre janë vetëm për kandidatët për gjyqtarë dhe prokurorë publikë dhe se ata nuk mund t'i japin testet institucioneve të tjera (domethënë ato nuk janë të akredituara). "Testet psikologjike – frenim për përzgjedhjen e gjyqtarëve të rinj", („Психолошките тестови – кочница за избор на нови судии"), Prizma/BIRN Maqedoni, 7 qershor 2023, https://prizma.mk/psiholoshkite-testovi-kochnitsa-za-izbor-na-novi-sudii/?fbclid=IwAR17HMxWY8jMj3kADNMaVL9AiHolSUZrBopXUdEZcSDQD-P0RjMEYQYgcLKQ.

219 "Njoftim nga seanca e 445-të e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut", („Соопштение од 445. седница на Судскиот совет на Република Северна Македонија"), faqja zyrtare e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 15 qershor 2023, https://avbc.me/Z9n9luMk.

220 "Këshilli Gjyqësor do të vazhdojë të njëjtat teste për gjyqtarët, megjithëse nuk ka asnjë institucion të akredituar në vend për ta", („Судскиот совет ќе продолжи со истите тестови за судиите, иако во земјава нема акредитирана институција за нив"), 360 stepeni, 15 qershor 2023, https://360stepeni.mk/sudskiot-sovet-ke-prodolzhi-so-istite-testovi-za-sudiite-iako-vo-zemjava-nema-akreditirana-institutsija-za-niv/.

221 "Publikimi i renditjes me rezultatet përfundimtare të provimit përfundimtar në Akademinë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë për gjeneratën e shtatë të pjesëmarrësve në trajnimin fillestar dhe renditjen përfundimtare të kandidatëve për gjyqtarë dhe prokurorë publikë", („Објавување на ранг-листата со конечни резултати од полагањето на завршниот испит во Академијата за судии и јавни обвинители за седмата генерација слушатели на почетна обука и конечната ранг-листа на кандидати за судии и јавни обвинители"), faqja zyrtare e Akademisë për Gjyqtarë dhe Prokurorë "Pavell Shatev", 20 shkurt 2023, https://bit.ly/3KhfOul.

222 "Njoftim nga seanca e 450-të e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut – 25.07.2023", („Соопштение од 450. седница на Судскиот совет на РСМ – 25.07.2023 година"), faqja zyrtare e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, https://bit.ly/3FgKmKV.

223 "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 73/2023.

224 "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 112/2023.

225 "Njoftim nga seanca e 455-të e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut – 26.09.2023", („Соопштение од 455. седница на Судскиот совет на РСМ – 26.09.2023 година"), faqja zyrtare e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, https://bit.ly/3PWNRfz.

226 Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 168/2023.

gjykatave themelore, ku, sipas analizës të gjendjes, situata është alarmante, nuk janë përzgjedhur gjyqtarët e nevojshëm[227] . Këshilli u përpoq ta zgjidhte këtë problem përmes referimit të përkohshëm për një periudhë një vjeçare dhe sipas këtij vendimi gjykatat themelore në Berovë, Delçevë, Kërçovë, Kumanovë, Prilep dhe Strugë morën gjyqtarë.[228] Në periudhën e ardhshme do të shihet realizueshmëria e kësaj mase, duke marrë parasysh karakterin e përkohshëm të saj. Përveç gjyqtarëve të gjeneratës të shtatë të pjesëmarrësve në trajnimin fillestar në AGJPP, në periudhën raportuese u zgjodhën edhe gjashtë gjyqtarë, katër kryetarë gjykatash dhe 50 juristë.[229]

Më 20 shkurt 2023, Këshilli Gjyqësor emëroi një gjyqtar të ri kushtetues,[230] si rezultat i përfundimit të mandatit të gjykatësit të mëparshëm në dhjetor 2022.[231] Konkretisht, u miratua kandidati i parë i propozuar, me numrin e kërkuar të votave, por jo njëzëri, si dhe pa u dhënë mundësi dy kandidatëve të tjerë të propozuar t'i nënshtrohen vendimit, në kundërshtim me nenin 23 paragrafi 3 të Rregullores së Punës së Këshillit Gjyqësor. Kjo pasohet nga fakti se në këtë procedurë nuk ka renditje, domethënë nuk ka procedurë aplikimi, pas së cilës do të përgatitet renditja dhe propozimet do të hidhen në votim. Në këtë procedurë, anëtarët e KGJRMV-së nxjerrin në pah propozimet për gjyqtarët, të cilët plotësojnë kushtet e kërkuara nga ligji. Si rezultat, propozimet hidhen në votim, sipas radhës në të cilën janë theksuar gjatë seancës.[232] Mosvotimi i dy kandidatëve të mbetur shkaktoi zemërim publik dhe kundërshtim nga opozita kur shqyrtoi propozimin.[233] Megjithatë, kandidati i propozuar më 10 prill 2023 u zgjodh nga Kuvendi.[234]

227 "Njoftim nga seanca e 432-të e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut – 28.02.2023", („Соопштение за 432. седница на Судскиот совет на РСМ – 28.02.2023 година"), faqja zyrtare e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, https://bit.ly/481NKFQ.

228 "Njoftim nga seanca urgjente e 453-të e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut – 06.09.2023", („Соопштение од 453. итна седница на Судскиот совет на РСМ – 06.09.2023 година"), faqja zyrtare e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, https://bit.ly/3NeWRuD.

229 Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut, «Përgjigje ndaj kërkesës për qasje të lirë në informacione publike», („Одговор по барање за слободен пристап до информации од јавен карактер"), 15 dhjetor 2023.

230 "Njoftim nga seanca e 431-të e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut – 20.02.2023", ("Соопштение од 431. седница на Судскиот совет на РСМ – 20.02.2023"), faqja zyrtare e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, https://bit.ly/47D8Iux.

231 "Ka përfunduar mandati i gjyqtares Vangjelina Markudova, Gjykata Kushtetuese ka mbetur me 6 gjyqtarë nga 9 të paraparë", („Заврши мандатот на судијата Вангелина Маркудова, Уставниот суд остана со 6 судии од предвидени 9"), A1 on, 9 dhjetor 2022, https://bit.ly/3K943pG.

232 Petkovska dhe Tutikj, "Raporti vjetor i monitorimit për punën e Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit të Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut", („Годишен мониторинг извештај за работата на Судскиот совет и Советот на јавни обвинители на Република Северна Македонија").

233 "Debat parlamentar për zgjedhjen e Dukovskës si gjyqtare e Gjykatës Kushtetuese, opozita shkeli Kushtetutën", („Собраниска расправа за изборот на Дуковска за судија на Уставен суд, за опозицијата прекршен е Уставот"), A1 on, 22 mars 2023, https://a1on.mk/macedonia/sobraniska-rasprava-za-izborot-na-dukovska-za-sudija-na-ustaven-sud-za-opozicijata-prekrshen-e-ustavot/.

Si rezultat i hapjes së gjashtë pozitave për gjyqtarë nga ana e Gjykatës Penale Ndërkombëtare në Hagë, duke përfshirë dy për Evropën Lindore dhe Qëndrore, për herë të parë u nominua një kandidat nga Republika e Maqedonisë së Veriut, gjyqtare nga GJSRMV.[235]

Në periudhën raportuese, në prokuroritë e Republikës së Maqedonisë së Veriut janë zgjedhur 40 prokurorë publikë.[236] Ndër zgjedhjet janë 24 prokurorë publikë në Prokuroritë Themelore Publike (PTHP) në të gjithë vendin, nga kandidatët nga gjenerata e shtatë e pjesëmarrësve në trajnimin fillestar në AGJPP.[237] Në periudhën e ardhshme, nga lista e akademikëve të kompletuar, mbeten të zgjidhen edhe dy prokurorë publikë në Prokurorinë Publike Tetovë, një prokuror publik në Prokurorinë Publike Shkup dhe një prokuror publik në Prokurorinë Publike Strugë.[238]

Një konstatim i përgjithshëm për të gjithë prokurorët publikë të zgjedhur është se praktika e zgjedhjes së tyre pa shpjegime për arsyet e zgjedhjes dhe mungesës së diskutimit ka vazhduar, pra vetëm duke votuar "për" dhe "kundër". Në raste të rralla kur ka një diskutim rreth përzgjedhjes, nga ana e anëtarëve të KPPRMV më së shpeshti përdoren konkluzione të përgjithshme me shpjegime abstrakte . Listat e kandidatëve për zgjedhje nuk u bënë publike në faqen e internetit të Këshillit, përveç listës së kandidatëve të gjeneratës së shtatë të pjesëmarrësve në trajnimin fillestar në AGJPP.[239] Mënyra e krijimit të listave të kandidatëve, nga ana tjetër, është e paqartë, pasi nuk ka renditje të kandidatëve në përzgjedhjen e prokurorëve publikë, dhe ato nuk krijohen sipas rendit alfabetik të kandidatëve.[240] Sidoqoftë, qasja e KPPRMV-së në përzgjedhjen e prokurorëve publikë është pozitive, ndryshe nga veprimet e KGJRMV-së, duke qenë se votohen të gjithë kandidatët në listë, pavarësisht nëse disa kandidatë kanë marrë shumicën e nevojshme të votave për t'u zgjedhur.[241]

---

235 "Nga seanca e 138-të e Qeverisë: Vendim për ngrirjen e çmimeve të vezëve të pulës dhe orizit; përfundim në drejtim të sigurisë së furnizimit me ngrohje në Qytetin e Shkupit; Konferenca Rajonale Evropiane e Interpolit do të mbahet në vend për herë të parë ", („Од 138. владина седница: Одлука за замрзнување на цените на јајцата од кокошка и оризот; заклучок во насока на сигурност на снабдувањето на топлинска енергија во Град Скопје; Европска регионална конференција на Интерпол за прв пат ќе се одржи во земјава"), faqja zyrtare e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, 21 mars 2023, https://vlada.mk/node/32594.

236 Këshilli i Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut, "Përgjigje ndaj kërkesës për qasje të lirë në informacionin publik", („Одговор по барање за слободен пристап до информации од јавен карактер"), 5 dhjetor 2023.

237 Ibid.

238 Kontribut në dokumentin e shkurtër "Sundimi i ligjit në kontekst të pranimit në BE – korrik-shtator 2023" („Владеење на правото во контекст на пристапувањето кон ЕУ – јули-септември 2023 година"), nga Koalicioni "Të gjithë për gjykim të drejtë", 02.10.2023.

239 "Kandidatë për prokurorë publikë, Shpallje – Gazeta Zyrtare, nr. 93/23 datë 02.05.2023", („Кандидати за јавни обвинители, Оглас – Сл. весник, бр. 93/23 од 02.05.2023 година"), faqja zyrtare e Këshillit të Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut, https://bit.ly/3ReoDsl; "Kandidatët për prokurorë publikë, Shpallje – Gazeta Zyrtare, nr. 93/23 datë 02.05.2023", („Кандидати за јавни обвинители, Оглас – Сл. весник, бр. 93/23 од 02.05.2023 година"), faqja zyrtare e Këshillit të Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut, https://bit.ly/47PbA7X.

240 Petkovska dhe Tutikj, "Raporti vjetor i monitorimit për punën e Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit të Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut", („Годишен мониторинг извештај за работата на Судскиот совет и Советот на јавни обвинители на Република Северна Македонија").

241 "Reagim për zgjedhjen e dy anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut nga radhët e gjyqtarëve dhe zgjedhjen e prokurorëve publikë nga Këshilli i Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut", („Реакција по повод избори на два члена на Судскиот совет на РСМ од редот на судиите и изборот на јавни обвинители од Советот на јавни обвинители на РСМ"), faqja zyrtare e Grupit Blueprint për Reforma në Gjyqësor, 14 korrik 2023, https://bit.ly/3Gc86jB.

Zgjedhja e pasuksesshme e katër prokurorëve publikë në PTHPNKOK) më 27 tetor 2022[242] shkaktoi mbivendosjen e kompetencave midis Prokurorit Publik të Prokurorisë Publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe KPPRMV-së.[243] Konkretisht, KPPRMV nuk zgjodhi asnjë nga gjashtë kandidatët e regjistruar në thirrje, dy prej të cilëve ishin ish-prokurorë në të njëjtën prokurori, me mandat të skaduar, duke mos e shpjeguar votimin e tillë.[244] Një rizgjedhje u mbajt më 12 korrik 2023, ku u zgjodhën tre prokurorë publikë,[245] edhe pse njoftimi i publikuar i referohej katër pozicioneve të hapura për prokurorët publikë. Gjatë këtij vakumi tetë mujor, Prokurori Publik i Prokurorisë Publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut, pa njoftim të duhur të Këshillit, referoi një nga prokurorët publikë të pazgjedhur në thirrjen e parë të përmendur në PTHPNKOK. Një veprim i tillë nga Prokurori Publik i Prokurorisë Publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut hapi pyetjet në lidhje me zbatimin e parimeve të hierarkisë dhe varësisë si parime themelore mbi të cilat bazohet funksionimi i Prokurorisë Publike në vend.[246] Gjithashtu, mund të ndikojë negativisht në sistematizimin e numrit të prokurorëve publikë pas prokurorive publike në vend, si dhe në planin për zgjedhjen e prokurorëve publikë dhe shpërndarjen e tyre të duhur.[247]

Pas pezullimit të Prokurorit Publik Themelor të PTHPNKOK,[248] më 7 nëntor 2022, u zgjodh një drejtues i ri i institucionit.[249] Për herë të parë, zgjedhja e Prokurorit Themelor Publik të PTHPNKOK u krye nga të gjithë prokurorët publikë në vend, duke zbatuar nenin 66 të Ligjit të

242 "Nga gjashtë të paraqitur, Këshilli i Prokurorëve Publikë nuk zgjodhi asnjë për Prokurorinë Publike për Ndjekjen e Krimit të Organizuar", („Од шест пријавени, Советот на јавни обвинители не избра ниту еден за ОЈО за гонење организиран криминал"), 360 stepeni, 27 tetor 2022, https://360stepeni.mk/od-shest-prijaveni-sovetot-na-javni-obviniteli-ne-izbra-nitu-eden-za-ojo-za-gonene-organiziran-kriminal/.

243 Petkovska dhe Tutikj, "Raporti vjetor i monitorimit për punën e Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit të Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut", („Годишен мониторинг извештај за работата на Судскиот совет и Советот на јавни обвинители на Република Северна Македонија").

244 "Nga gjashtë të paraqitur, Këshilli i Prokurorëve Publikë nuk zgjodhi asnjë për Prokurorinë Publike për Ndjekjen e Krimit të Organizuar", („Од шест пријавени, Советот на јавни обвинители не избра ниту еден за ОЈО за гонење организиран криминал").

245 "Vendimi për zgjedhjen e dy prokurorëve publikë në Prokurorinë Publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut, dy prokurorë publikë në Prokurorinë e Lartë Publike Shkup, tre prokurorë publikë në Prokurorinë Themelore Publike për Ndjekjen e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit – Shkup, Prokurorinë Themelore Publike Gostivar, një prokuror publik në Prokurorinë Themelore Publike Kavadar, pesë prokurorë publikë në Prokurorinë Themelore Publike Shkup", („Одлука за избор на два јавни обвинители во Јавното обвинителство на Република Северна Македонија, два јавни обвинители во Вишото јавно обвинителство Скопје, три јавни обвинители во Основното јавно обвинителство за гонење на организиран криминал и корупција – Скопје, основен јавен обвинител на Основното јавно обвинителство Гостивар, еден јавен обвинител во Основното јавно обвинителство Кавадарци, пет јавни обвинители во Основното јавно обвинителство Скопје"), (Këshilli i Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 12 korrik 2023), https://bit.ly/3t4t7cD.

246 Petkovska dhe Tutikj, "Raporti vjetor i monitorimit për punën e Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit të Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut", („Годишен мониторинг извештај за работата на Судскиот совет и Советот на јавни обвинители на Република Северна Македонија").

247 Ibid.

248 "Vilma Ruskovska suspendohet, procedurë disiplinore edhe për dy prokurore", („Вилма Русковска суспендирана, дисциплинска за уште две обвинителки"), 16 gusht 2022, https://netpress.com.mk/vilma-ruskovska-suspendirana-disciplinska-za-ushte-dve-obvinitelki/.

249 "Njoftim – Emërimi zyrtar i prokurorit të ri kryesor publik të Prokurorisë Themelore Publike për Ndjekjen e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit", („Соопштение – Формално именување на новиот основен јавен обвинител на Основното јавно обвинителство за гонење на организиран криминал и корупција"), faqja zyrtare e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 14 nëntor 2022, https://bit.ly/3WhmrAS.

ri për Prokurorët Publikë.[250] Kjo mënyrë e zgjedhjes së prokurorit themelor publik të Prokurorisë Publike është një proces i avancuar që ndikon në forcimin e pavarësisë së prokurorëve publikë dhe kontrollin e brendshëm të profesionit të prokurorit publik. Megjithatë, vlerësimet për procesin e avancuar të përzgjedhjes shpejt u kthyen në kritika nga publiku ekspert për shkak të mungesës së transparencës dhe lëshime të bëra gjatë procedurës së përzgjedhjes.[251] Gjegjësisht, në procesin e përzgjedhjes mungonin të dhëna për karrierën profesionale të katër kandidatëve.[252] Në të njëjtën kohë, biografitë e kandidatëve me kompetencat e tyre profesionale nuk u publikuan në faqen e internetit të KPPRMV.[253] Për më tepër, publiku, dhe veçanërisht publiku ekspert, nuk pati mundësi të njihej me programin e propozuar të kandidatëve, i cili do të ngrinte besimin në proces dhe do të ndihmonte në rritjen e besimit në institucion.[254] Reagimet u drejtuan edhe në media, për shkak të publikimit të informacioneve jozyrtare të zgjedhjeve.[255] Përveç kësaj, pati vërejtje për ndikimet e mundshme dhe lidhjen e drejtuesit të ri me një nga partitë në koalicionin qeverisës,[256] si dhe për rregullat dhe kriteret jo mjaft të rrepta të modelit zgjedhor.[257]

Reagimet e publikut profesional, veçanërisht shoqërisë civile, siç është Grupi Bluprint për Reforma në Gjyqësor, iu nënshtruan sulmeve nga disa anëtarë të KPPRMV-së,[258] gjë që tregoi përsëri mosgatishmërinë e institucionit për t'u marrë me kritikat publike në lidhje me punën e tij.

250 "Ligji për Prokurorinë Publike", („Законот за јавно обвинителство"), Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr. 42/2020.

251 "Transparencë e pamjafatueshme dhe lëshime në zgjedhjen e prokurorit publik themelor të Prokurorisë Publike për Ndjekjen e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit", („Недоволна транспарентност и пропусти при изборот на основен јавен обвинител на Јавното обвинителство за гонење на организиран криминал и корупција"), faqja zyrtare e Grupit Blueprint për Reforma në Gjyqësor, 10 nëntor 2022, https://bit.ly/3GD1ydD.

252 Ibid.

253 Ibid.

254 Ibid.

255 Ibid.

256 Ambasadat e Shteteve të Bashkuara, BE-së dhe Holandës, si partnerë të provuar të vendit në reformën gjyqësore dhe luftën kundër korrupsionit, shprehën pakënaqësinë e tyre nga zgjedhja në përgjigjet ndaj pyetjeve të bëra nga programi "360 stepeni". Ambasadori amerikan madje drejtoi kritika të qarta dhe të ashpra për zgjedhjen. "Shtetet e Bashkuara janë të hutuara nga zgjedhja e Islam Abazit, veçanërisht pas shpenzimit të miliona dollarëve për të trajnuar prokurorët", („САД се збунети од изборот на Ислам Абази, особено по потрошени милиони долари за обука на обвинители"), 360 stepeni, 18 nëntor 2022, https://360stepeni.mk/sad-se-zbuneti-od-izborot-na-islam-abazi-osobeno-po-potrosheni-milioni-dolari-za-obuka-na-obviniteli/.

257 "Zgjedhja e Islam Abazit e vënë në provë nga publiku", („Изборот на Ислам Абази ставен на тест на јавноста"), Deutsche Welle, 9 nëntor 2022, https://www.dw.com/mk/somnezi-i-osporuvana-na-izborot-na-islam-abazi-za-sef-na-organiziran-kriminal/a-63694136.

258 "Reagim pas debatit në seancën e Këshillit të Prokurorëve Publikë në lidhje me qëndrimin e deklaruar publikisht të Grupit Bluprint për zgjedhjen e Prokurorit Themelor Publik të PTHPNKOK", („Реакција по расправата на седницата на Советот на јавни обвинители во врска со јавно искажаниот став на Блупринт групата за избор на основен јавен обвинител на ОЈОГОКК"), faqja zyrtare e Grupit Bluprint për Reforma në Gjyqësor, 14 nëntor 2022, https://bit.ly/3H6p700.

Një konstatim i përgjithshëm për të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët publikë të zgjedhur është se praktika e zgjedhjes së tyre pa shpjegime për arsyet e zgjedhjes dhe mungesës së diskutimit ka vazhduar. Në raste të rralla kur diskutohet për zgjedhjet, nga ana e anëtarëve të KGJRMV dhe KPPRMV zakonisht përporen konkluzionet e përgjithshme me shpjegime abstrakte. Mbetet e paqartë pse anëtarët e KGJRMV nuk e shpjegojnë votën KUNDËR, si dhe pse ekziston mundësia që anëtarët e KPPRMV të votojnë me ABSTENIM gjatë zgjedhjes së prokurorëve publikë;

Për të hequr dyshimet për tregtinë me ndikim dhe ndikimin politik në zgjedhjen e prokurorëve publikë nga KPPRMV, është e nevojshme që Këshilli të miratojë një akt të brendshëm që do të rregullojë në detaje procedurën dhe kriteret e nevojshme për zgjedhjen e prokurorëve publikë, dhe në veçanti krijimin e listës së kandidatëve, e cila aktualisht mungon;

Mbivendosja e konstatuar e kompetencave midis Prokurorit Publik të Prokurorisë Publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe KPPRMV-së, në rast se prokurorët publikë të pazgjedhur nga KPPRMV për një prokurori tjetër publike, më pas referohen nga Prokurori Publik i Prokurorisë Publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut në të njëjtën prokurori publike për të cilën nuk janë zgjedhur, hap nevojën për një debat ekspertësh mbi nevojën reale për pjesëmarrjen e Prokurorit Publik të Prokurorisë Publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut si anëtar i Këshillit. Mbivendosja e kompetencave ndikon edhe në sistematizimin e prokurorëve publikë në prokuroritë publike;

Kërkohet një reagim i shpejtë nga të dy këshillat për zgjedhjen e gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë të caktuar me qëllim parandalimin e vonesave në procedime dhe uljen e afateve kohore dhe cilësisë së punës së gjykatave dhe prokurorive publike.

# CILËSIA E DREJTËSISË

Me mbarimin e mandatit të Bordit të atëhershëm Drejtues të AGJPP-s, më 29 nëntor 2022, u mbajt seanca konstituive e Bordit të ri Drejtues, në të cilën u verifikuan mandatet e anëtarëve dhe zëvendës anëtarëve, të propozuara nga institucionet dhe shoqatat kompetente.[259] Në seancën u emëruan kryetari dhe zëvendëskryetari i Bordit Drejtues, si dhe përfundimi i mandatit të Drejtoreshës të AGJPP-së, e cili emëroi një ushtrues të detyrës drejtor të AGJPP-së.[260] Për shkak të konfliktit të interesit dhe pamundësisë për të kryer tre funksione njëkohësisht, të shpjeguara më sipër,[261] ushtruesi i detyrës drejtor dha dorëheqjen dhe u zgjodh një ushtrues i detyrës drejtor i ri i AGJPP-së.[262]

Thirrja për zgjedhjen e një drejtori të ri të AGJPP-së u publikua më 16 nëntor 2022,[263] në të cilën aplikuan katër kandidatë,[264] përfshirë drejtorin aktual të AGJPP-së, i cili u rizgjodh për pozitën më 9 dhjetor 2022.[265]

AGJPP mbetet pika e vetme e hyrjes në gjyqësor dhe prokurori publike, dhe kjo është e garantuar me Ligjin e ri për Akademinë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë, të miratuar nga Kuvendi më 14 qershor 2023.[266] Renditja përfundimtare e kandidatëve për gjyqtarë dhe prokurorë

259 "Njoftim për seancën konstituive të Bordit Drejtues të Akademisë", („Соопштение за одржана конститутивна седница на Управниот одбор на Академијата").

260 Ibid.

261 Në seancën, anëtari i KGJRMV-së Zoran Gerasimoski u emërua ushtrues detyre drejtori i AGJPP-së deri në zgjedhjen e kryetarit të ri. Vendimi për emërimin e Zoran Gerasimoskit si ushtrues i detyrës së drejtorit të AGJPP-së u kritikua edhe më shumë sesa zgjedhja e tij si anëtar i Bordit Drejtues të AGJPP-së, e cila u përshkrua më lart. Në këtë drejtim, KSHPK-ja njoftoi se ai nuk mund t›i kryejë të tre funksionet në të njëjtën kohë, domethënë nuk mund të jetë anëtar i Këshillit Gjyqësor, anëtar i Bordit Drejtues të Akademisë dhe ushtrues i detyrës drejtor i Akademisë në të njëjtën kohë. Si rezultat i qortimeve nga KSHPK, vetëm pak ditë pas zgjedhjeve, ai dha dorëheqjen dhe u zgjodh si ushtrues i detyrës së drejtorit të AGJPP-së.

262 "Njoftim nga seanca e188-të e AGJPP-së", („Соопштение од 188. седница на АСЈО"), faqja zyrtare e Akademisë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë "Pavell Shatev", 5 dhjetor 2022, https://bit.ly/3kAisCo.

263 "Vendim për shpalljen e shpalljes publike për zgjedhjen e drejtorit të Akademisë së Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë 'Pavell Shatev' Shkup", („Одлука за распишување на јавен оглас за избор на директор на Академијата за судии и јавни обвинители 'Павел Шатев' Скопје"), Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr. 245/2022.

264 Fillimisht, zgjedhja e drejtorit të ri duhej të mbahej më 7 dhjetor 2022, por për shkak të marrjes së vonshme me postë të dokumentacionit të kandidatit, gjyqtarit Andrej Dimovski nga Gjykata Themelore Civile Shkup, zgjedhjet u mbajtën më 9 dhjetor 2022. "Drejtor i Akademisë për Gjyqtarë dhe Prokurorë nuk është zgjedhur: Posta u vonua dhe në minutën e fundit solli një kandidaturë nga gjyqtari Dimovski", („Не се избра директор на Академијата за судии и обвинители: Пошта доцнела и во последен момент донесе кандидатура од судијата Димовски"), A1 on, 7 dhjetor 2022, https://a1on.mk/macedonia/macedonia/ne-se-izbra-direktor-na-akademijata-za-sudii-i-obviniteli-poshtata-docnela-i-vo-posleden-moment-donese-kandidatura-od-sudijata-dimovski/?swcfpc=1.

265 "Natasha Gaber-Damjanovska rizgjidhet drejtoreshë e Akademisë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë", („Наташа Габер-Дамјановска реизбрана за директорка на Академијата за судии и јавни обвинители"), Radio Evropa e Lirë, 9 dhjetor 2022, https://www.slobodnaevropa.mk/a/32169701.html.

266 "Ligji për Akademinë për Prokurorë Publikë dhe Gjyqtarë", („Закон за Академија за судии и јавни обвинители"), Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr. 129/2023.

publikë të gjeneratës së shtatë të AGJPP u publikua më 20 shkurt 2023[267] (me publikimin e renditjes shtesë më 1 mars për shkak të së drejtës së kandidatëve për të ri-marrë provimin përfundimtar),[268] pas së cilës renditja iu dërgua KGJRMV-së dhe KPPRMV-së për ndarjen e tyre të duhur.[269] Më herët, më 30 janar 2023, u publikua një shpallje publik për pranimin e 130 pjesëmarrësve në gjeneratën e nëntë të pjesëmarrësve në trajnimin fillestar në AGJPP.[270]

Për të harmonizuar fazat e provimit pranues të gjeneratës të re, të nëntë të pjesëmarrësve në trajnimin fillestar në AGJPP me ligjin e ri, u ndryshua Rregullorja[271] dhe dinamika kohore për marrjen e pjesës së mëtejshme të provimit pranues,[272] dhe u miratua një statut i ri i AGJPP.[273] Megjithatë, për shkak të vonesave në zbatimin e procedurave të rishikuara të provimit pranues nga institucionet e mbetura përkatëse, testi psikologjik për kandidatët e gjeneratës së nëntë u riplanifikua dy herë në shtator 2023.[274] Pas riplanifikimit të dytë, testi psikologjik pritet të kryhet në tetor 2023.[275] Në periudhën e ardhshme, sipas ligjit të ri, pritet të miratohen aktet nënligjore të mbetura.[276]

267 "Publikimi i renditjes me rezultatet përfundimtare të provimit përfundimtar në Akademinë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë për gjeneratën e shtatë të pjesëmarrësve në trajnimin fillestar dhe renditjen përfundimtare të kandidatëve për gjyqtarë dhe prokurorë publikë", („Објавување на ранг-листата со конечни резултати од полагањето на завршниот испит во Академијата за судии и јавни обвинители за седмата генерација слушатели на почетна обука и конечната ранг-листа на кандидати за судии и јавни обвинители"), faqja zyrtare e Akademisë për Gjyqtarë dhe Prokurorë "Pavell Shatev", 20 shkurt 2023, https://bit.ly/3KhfOul.

268 "Publikimi i një renditjeje shtesë me rezultate përfundimtare nga provimi përfundimtar në Akademinë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë për gjeneratën e shtatë të dëgjuesve të trajnimit fillestar dhe renditjes përfundimtare të kandidatëve për gjyqtarë dhe prokurorë publikë", („Објавување на дополнета ранг-листата со конечни резултати од полагањето на завршниот испит во Академијата за судии и јавни обвинители за седмата генерација слушатели на почетна обука и конечна ранг-листа на кандидати за судии и јавни обвинители"), faqja zyrtare e Akademisë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë "Pavell Shatev", 1 mars 2023, https://bit.ly/3KGPlrB.

269 Gjenerata e shtatë përfundoi me 30 kandidatë për gjyqtarë dhe 28 për prokurorë publikë. Këshilli i Prokurorëve Publikë publikoi një deklaratë për zgjedhjen e prokurorëve publikë në prokuroritë themelore publike nga kandidatët që përfunduan trajnimin bazë më 6 mars 2023, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr. 48/2023. Këshilli Gjyqësor publikoi një deklaratë për zgjedhjen e gjyqtarëve në gjykatat themelore nga kandidatët që përfunduan trajnimin bazë më 29 mars 2023, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr. 69/2023.

270 Shpallje publike për pranim në trajnim fillestar në Akademinë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë "Pavell Shatev", Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr. 19/2023.

271 "Njoftim për miratimin e një Rregulloreje të re për marrjen e provimit pranues në Akademinë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë", („Известување за усвојување на нов Правилник за полагање на приемен испит во Академијата за судии и јавни обвинители"), faqja zyrtare e Akademisë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë "Pavell Shatev", 19 shtator 2023, https://bit.ly/4a8bMkk.

272 "Njoftimi për rrjedhjen e mëtejshme të provimit pranues për pranim në gjeneratën IX të trajnimit fillestar", („Известување за понатамошниот тек од приемниот испит за прием во IX генерација на почетна обука"), faqja zyrtare e Akademisë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë "Pavell Shatev", 23 maj 2023, https://bit.ly/46PMnIZ.

273 "Statuti i Akademisë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë", („Статут на Академијата за судии и јавни Обвинители"),Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr. 172/2023.

274 Fillimisht ishte planifikuar për 5 dhe 6 shtator 2023, por datat u zhvendosën në 23 dhe 24 shtator 2023. "Njoftim për vonesën në kryerjen e testit psikologjik", („Известување за одложување на полагањето на психолошкиот тест"), faqja zyrtare e Akademisë për Gjyqtarë dhe Prokurorë "Pavell Shatev", 22 shtator 2023, https://bit.ly/46OWHSb.

275 Ibid.

276 "Njoftim për Statutin e ri të Akademisë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publik", („Известување за нов Статут на Академијата за судии и јавни обвинители"), faqja zyrtare e Akademisë për Gjyqtarë dhe Prokurorë "Pavell Shatev", 14 gusht 2023, https://bit.ly/4abm5Uv.

AGJPP punon vazhdimisht në drejtim të përmirësimit të cilësisë dhe mënyrës së kryerjes së trajnimeve dhe prezantimit të temave të nevojshme të trajnimit bazuar në vlerësimet e kryera të trajnimeve dhe draft-temat e paraqitura nga KGJRMV, KPPRMV, ekspertë dhe OJQ, si dhe në përputhje me dispozitat e ligjit të ri.[277] Në periudhën raportuese ka një rritje të ndjeshme të numrit të trajnimeve të realizuara. Pra, kundrejt 214 trajnimeve të realizuara në vitin 2021,[278] në vitin 2022, AGJPP ka realizuar 227 trajnime në kuadër të trajnimit të detyrueshëm për gjyqtarët dhe prokurorët publik, si dhe në kuadër të trajnimit vullnetar të shërbimeve profesionale në gjykata dhe prokurori.[279] Për më tepër, në nëntë muajt e parë të vitit 2023, u zhvilluan gjithsej 98 trajnime.[280] Me qëllim përmirësimin e përmbajtjes dhe cilësisë së trajnimeve,[281] si dhe vazhdimin[282] e bashkëpunimit me disa institucione përkatëse, organizata ndërkombëtare dhe joqeveritare, si dhe shkëmbimin e praktikave të mira për konceptimin dhe organizimin e trajnimeve me disa qendra evropiane[283] dhe akademi.[284] Në këtë drejtim, përfshirja e frejtoreshës të AGJPP-së, si anëtare e Trupit Këshillues të Akademisë së së Drejtës Evropiane (ERA), si një institucion që luan një rol kyç në promovimin e trajnimit profesional gjyqësor është gjithashtu e rëndësishme, veçanërisht në kontekstin e çështjeve të lidhura me BE-në.[285] Një nga çështjet prioritare në programin ERA për periudhën e ardhshme është pikërisht strategjia për trajnimin gjyqësor të vendeve të Ballkanit Perëndimor.[286]

277 "Ligji për Akademinë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë", („Закон за Академија за судии и јавни обвинители"), Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr. 129/2023.

278 Akademia për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë, "Përgjigje ndaj kërkesës për qasje të lirë në informacionin publik", („Одговор по барање за слободен пристап до информации од јавен карактер"), 12 prill 2021.

279 Akademia për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë, "Përgjigje ndaj kërkesës për qasje të lirë në informacionin publik", („Одговор по барање за слободен пристап до информации од јавен карактер"), 1 nëntor 2022.

280 Akademia për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë, "Përgjigje ndaj kërkesës për qasje të lirë në informacionin publik", („Одговор по барање за слободен пристап до информации од јавен карактер"), 13 dhjetor 2023.

281 "Nënshkruhet Memorandum bashkëpunimi me Qendrën për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar (CILC) të Mbretërisë së Holandës", („Потпишан меморандум за соработка со Центарот за меѓународна правна соработка (CILC) од Кралството Холандија"), faqja zyrtare e Akademisë për Gjyqtarë dhe Prokurorë "Pavell Shatev", 15 nëntor 2022, https://bit.ly/46IKFt1.

282 "Nënshkruhet Memorandum bashkëpunimi midis Akademisë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë dhe Misionit të OSBE-së në Shkup", („Потпишан Меморандум за соработка помеѓу Академијата за судии и јавни обвинители и Мисијата на ОБСЕ во Скопје"), faqja zyrtare e Akademisë për Gjyqtarë dhe Prokurorë "Pavell Shatev", 27 shkurt 2023, https://bit.ly/3t33uJB.

283 "Shkëmbimi i praktikave të mira për konceptimin dhe organizimin e trajnimeve gjyqësore: modeli spanjoll dhe maqedonas Spanjë, 13-16 shkurt 2023", („Размена на добри практики за концептуализација и организирање судски обуки: шпанскиот и македонскиот модел Шпанија, 13-16 февруари 2023 година"), faqja zyrtare e Akademisë për Gjyqtarë dhe Prokurorë "Pavell Shatev", 20 shkurt 2023, https://bit.ly/3RtElBi.

284 "Përfaqësuesit e Akademisë për Gjyqtarë dhe Prokurorë në një vizitë studimore në Akademinë e së Drejtës Evropiane (ERA)", („Претставници на Академијата за судии и јавни обвинители на студиска посета на Академијата за европско право (ERA)"), faqja zyrtare e Akademisë për Gjyqtarë dhe Prokurorë "Pavell Shatev", 9 maj 2023, https://bit.ly/3GsyHJc.

285 "Drejtoresha e Akademisë është anëtare e re e Trupit Këshillues të Akademisë së së Drejtës Evropiane (ERA)", („Директорката на Академијата е нов член на Консултативното тело (Board of Trustees) на Академијата за европско право (ЕРА)"), faqja zyrtare e Akademisë për Gjyqtarë dhe Prokurorë "Pavell Shatev", 19 shtator 2023, https://bit.ly/48Y0Bd6.

286 Ibid.

Megjithatë, stafi dhe përshtatja teknike, si dhe sigurimi i kushteve të përshtatshme hapësinore mbeten ende një sfidë. Nevoja për përmirësimin e kushteve hapësinore të AGJPP-së, në radhë të parë të dhomave të trajnimit, por edhe ekipimit kadrovik dhe rritjes së buxhetit, përcaktohet si rekomandim i përgjithshëm në raportin e misionit vlerësues të TAIEKS-it.[287] Nevoja për forcimin e kapaciteteve të AGJPP-së, veçanërisht përmirësimin e buxhetit dhe autonomisë së AGJPP-së, përcaktohet në Planin e veprimit për realizimin e prioriteteve urgjente të reformës.[288] Në këtë drejtim, rritja e vërejtur në buxhetin e miratuar në AGJPP në dy vitet e fundit, pavarësisht luhatjeve të vërejtura në shumat e miratuara çdo vit në gjashtë vitet e fundit,[289] është vetëm për shkak të pranimit të gjeneratës të tetë dhe hapjes së thirrjes për gjeneratën e nëntë të kandidatëve për trajnim fillestar në AGJPP. Pra, buxheti i AGJPP ishte 131.793.000,00 MKD për vitin 2022 dhe 124.285.222,00 MKD për vitin 2023,[290] krahasuar me vitin 2021, ku ishte 72.200.000,00 MKD.[291] Prandaj, është e nevojshme të rritet realisht buxheti në dispozicion të AGJPP-së, në përputhje me nevojat e mbetura për funksionimin e pandërprerë dhe mirëmbajtjen e një niveli cilësor të punës.[292]

Lidhur me harmonizimin e praktikës gjyqësore, Departamenti i praktikës gjyqësore në GJSRMV mbajti katër seanca në vitin 2022,[293] ndërsa nga janari deri në shtator 2023 zhvilloi dy seanca.[294] Intensiteti i zvogëluar u konstatua nga mbajtja e takimeve të punës midis gjyqtarëve dhe përfaqësuesve nga katër rrethet e apelit dhe GJSRMV për të harmonizuar praktikën gjyqësore. Konkretisht, gjatë periudhës raportuese, është zhvilluar vetëm një takim për harmonizimin e praktikës gjyqësore,[295] kundrejt tre në periudhën e mëparshme raportuese

287 Raport mbi misionin e kryer të vlerësimit të TAIEX për trajnimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë në Republikën e Maqedonisë, gjyqtari Lenart Johanson dhe gjyqtari Dragomir Jordanov (i pabotuar).

288 “Plani i veprimit për realizimin e prioriteteve urgjente reformuese 2015 (Dokumenti i punës)”, („План на активности за реализација на итните реформски приоритети 2015 (работен документ)“), https://www.sep.gov.mk/post/?id=862.

289 Ardita Abazi Imeri et al. “Analiza – Vlerësimi gjithëpërfshirës i zbatimit të Strategjisë për Reforma në Sektorin Gjyqësor 2017-2022”, („Анализа – Сеопфатна оценка на спроведувањето на Стратегијата за реформа на правосудниот сектор 2017-2022“), (Instituti për Politikë Evropiane – Shkup, 10 nëntor 2022), http://blueprint.org.mk/wp-content/uploads/2022/11/ %D0%90%D0%9D%D0%90%D0%9B%D0%98%D0%97%D0%90_mk-1-1.pdf.

290 Akademia për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë, “Përgjigje ndaj kërkesës për qasje të lirë në informacionin publik”, („Одговор по барање за слободен пристап до информации од јавен карактер“), 13 dhjetor 2023.

291 Akademia për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë, “Përgjigje ndaj kërkesës për qasje të lirë në informacionin publik”, („Одговор по барање за слободен пристап до информации од јавен карактер“), 26 gusht 2022.

292 “Diskutimi i Raportit në hije për Kapitullin 23 për periudhën tetor 2022 – shtator 2023”, („Дискусија за Извештајот во сенка за Поглавје 23 за периодот октомври 2022 – септември 2023 година“), faqja zyrtare e Institutit të Politikave Evropiane – Shkup, 22 dhjetor 2023, https://epi.org.mk/post/25506.

293 Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, “Përgjigje ndaj një kërkese për qasje të lirë në informacionin publik”, („Одговор по барање за слободен пристап до информации од јавен карактер“), 14 dhjetor 2023.

294 Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, “Përgjigje ndaj kërkesës për qasje të lirë në informacione publike”, („Одговор по барање за слободен пристап до информации од јавен карактер“), 7 nëntor 2022.

295 “Takim pune i Gjykatës Supreme dhe katër gjykatave të apelit për harmonizimin e praktikës gjyqësore”, („Работна средба на Врховниот суд и четирите апелациони судови за хармонизирање на судската практика“), faqja zyrtare e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 27 mars 2023, https://bit.ly/46LYaIn.

(shtator 2021 – tetor 2022).[296] Mbështetja financiare për organizimin e këtyre takimeve mbetet me ndihmën e jashtme dhe realizimin e projekteve përmes të cilave në takime përfshihet edhe sektori civil.[297] Për të arritur një barazi më të madhe të praktikës gjyqësore, nevojitet një numër më i madh i takimeve të GJLRMV me gjykatat e apelit, si dhe një rritje e aktivitetit të departamenteve të praktikës gjyqësore. Për të ndjekur drejtimet dhe qëndrimet e gjykatave të apelit në mbledhjet e tyre, konkluzionet e këtyre mbledhjeve duhet të jenë më transparente, gjë që do të thjeshtojë zbatimin e praktikës gjyqësore.[298] Gjithashtu, procesi i publikimit të vendimeve gjyqësore vazhdon pa probleme dhe të gjitha vendimet gjyqësore publikohen në ueb portalin e gjykatave sud.mk, por procesi nuk është i strukturuar në mënyrë që vendimet të përdoren në mënyrë të lehtë dhe të qasshme. Kjo për faktin se nuk ekziston mundësia e gjetjes së saktë dhe të shpejtë të një praktike gjyqësore specifike dhe as metodologjia për nxjerrjen e vendimeve kyçe në lidhje me krijimin e praktikës gjyqësore.[299]

Në periudhën raportuese ka vazhduar roli proaktiv i Departamentit të praktikës gjyqësore për miratimin e qëndrimeve parimore dhe opinioneve parimore ligjore. Gjegjësisht, departamenti i praktikës gjyqësore regjistroi qëndrimet e vendosura parimore dhe mendimet parimore juridike të seancës së përgjithshme të GJSRMV-së, mendimet dhe konkluzionet juridike të departamenteve të specializuara dhe pranoi vendimet gjyqësore të këshillave duke i sistemuar ato sipas fushave ligjore dhe i publikoi në faqen e internetit të GJSRMV-së në seksionin për praktikën gjyqësore. Kështu, gjatë periudhës raportuese, në faqen e internetit të GJSRMV-së u publikuan katër paragrafë kryesorë.[300] Konkretisht, përveç qëndrimeve parimore të lartpërmendura për zbulimin publik të vendimeve nga gjykatat që nuk kanë hyrë në fuqi në lidhje me rastet me interes publik[301] dhe akreditimin e medias në lidhje me lejet për incizimin dhe fotografimin në lëndë të caktuara,[302] është gjithashtu e rëndësishme të miratohet një

296 Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, "Përgjigje ndaj kërkesës për qasje të lirë në informacione publike", („Одговор по барање за слободен пристап до информации од јавен карактер"), 7 nëntor 2022.

297 Ardita Abazi Imeri et al., "Analizë - Vlerësim gjithëpërfshirës i zbatimit të Strategjisë për Reforma në Sektorin Gjyqësor 2017-2022", („Анализа – Сеопфатна оценка на спроведувањето на Стратегијата за реформа на правосудниот сектор 2017-2022"), (Instituti për Politikë Evropiane - Shkup, 10 nëntor 2022), https://bit.ly/3X2noxB.

298 Dushko Georgievski, "Analiza e cilësisë dhe barazisë së vendimeve gjyqësore në fushën e së drejtës civile", („Анализа на квалитетот и изедначеноста на судските одлуки во граѓанско-правната област"), (Instituti për Politikë Evropiane dhe Shoqata "Zenit", gusht 2021)<https://bit.ly/3UfOKPz> .

299 Ardita Abazi Imeri et al., "Analizë - Vlerësim gjithëpërfshirës i zbatimit të Strategjisë për Reforma në Sektorin Gjyqësor 2017-2022", („Анализа – Сеопфатна оценка на спроведувањето на Стратегијата за реформа на правосудниот сектор 2017-2022"), (Instituti për Politikë Evropiane - Shkup, 10 nëntor 2022), https://bit.ly/3X2noxB.

300 Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, "Përgjigje ndaj një kërkese për qasje të lirë në informacionin publik", („Одговор по барање за слободен пристап до информации од јавен карактер"), 14 dhjetor 2023.

301 Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, "Qëndrim parimor për publikimin e vendimeve gjyqësore në faqet e internetit të gjykatave", („Начелен став за објавување на донесените судски одлуки на интернет-страниците на судовите").

302 "Gjykata Supreme ka krijuar një qëndrim parimor për akreditimet e mediave", („Врховниот суд утврди начелен став за акредитациите на медиумите"), faqja zyrtare e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 14 korrik 2023, https://bit.ly/3rY1C4n.

qëndrim parimor për zbatimin e drejtpërdrejtë të dispozitave të Kushtetutës dhe Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ)[303] në procedurat e apelit kundër vendimeve të Këshillit Gjyqësor për shkarkimin e gjyqtarëve ose kryetarëve të gjykatave.[304] Përveç kësaj, u miratua një mendim juridik parimor, tetë mendime juridike, dymbëdhjetë konkluzione dhe shtatë vendime.[305]

Gjatë periudhës raportuese nuk ka pasur ndryshime apo përmirësime të rëndësishme në fushën e ndërmjetësimit. Më 6 qershor 2023, u përgatitën akte nënligjore për rregullimin e mënyrës së kryerjes së punimeve brenda fushëveprimit të Këshillit Kombëtar të Ndërmjetësimit si: Rregullore për mënyrën e kryerjes së punës së Këshillit Kombëtar të Ndërmjetësimit, rregullore për mënyrën e lëshimit dhe revokimit të licencave në ndërmjetësim, rregullore për formën dhe përmbajtjen e licencës për ndërmjetësues, çmimore për shumën e shpenzimeve faktike të bëra për lëshimin e licencave për ndërmjetësues, licenca për ndërmjetësues në fusha specifike, licenca për trajnues të ndërmjetësuesve dhe akreditim të programeve të trajnimit për ndërmjetësues dhe rregullore për metodologjinë dhe mënyrën e monitorimit dhe vlerësimit të cilësisë së punës së ndërmjetësuesve në përputhje me anekset e rregullores.[306] Megjithatë, aktet nënligjore të përgatitura deri në fund të periudhës raportuese ende nuk ishin miratuar nga Qeveria[307] dhe, në praktikë, Këshilli është ende jofunksional. Në periudhën e ardhshme nevojitet zbatimi në kohë dhe i vazhdueshëm i ndryshimeve ligjore, si dhe përmirësimi i sistemit për arritjen e cilësisë në punën e ndërmjetësuesve.

Projektligji për Procedurën Civile, i paraqitur në Kuvend në gusht 2021,[308] përfundimisht kaloi në lexim të dytë më dhjetë prill 2023.[309] Brenda afatit të përcaktuar nga Rregullorja e Punës së Kuvendit, asnjë ndryshim nuk u paraqit nga propozuesit e autorizuar, pas së cilës Komisioni për Çështjet Evropiane dhe Komiteti Legjislativ në maj 2023, e përcollën projektligjin për

303 Konkretisht, Amendamenti XXI (neni 15) dhe neni 50 i Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së Veriut, si dhe nenet 6 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

304 "Gjykata Supreme ka krijuar qëndrim parimor për zbatimin e drejtpërdrejtë të Kushtetutës dhe Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut", („Врховниот суд утврди начелен став за директна примена на Уставот и Европската конвенција за заштита на човековите права"), faqja zyrtare e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 23 shkurt 2023, https://bit.ly/3RFRBDb.

305 Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, "Përgjigje ndaj një kërkese për qasje të lirë në informacionin publik", („Одговор по барање за слободен пристап до информации од јавен карактер"), 14 dhjetor 2023.

306 "Aktet nënligjore – Ndërmjetësimi", („Подзаконски акти – медијација"), Faqja zyrtare e Ministrisë së Drejtësisë, https://www.pravda.gov.mk/resursi/3/7.

307 Aktet nënligjore të listuara u publikuan pas miratimit nga Qeveria më 16 nëntor 2023.

308 "Ligji i ri për procedurën civile - reformë që është ende në procedurë parlamentare", („Новиот Закон за парничната постапка – реформа која сè уште е во собраниска процедура"), 3 maj 2022, https://akademik.mk/noviot-zakon-za-parnichnata-postapka-reforma-koja-se-ushte-e-vo-sobraniska-protsedura/.

309 „Detajet e materialit - propozim-ligji për Procedurë Civile", („Детали на материјал – Предлог на Законот за парничната постапка"), Uebfaqja zyrtare e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, https://www.sobranie.mk/detali-na-materijal.nspx?param=d1d44644-0f3a-4f12-b3da-bea6154d4f87.

procedime të mëtejshme në Kuvend.[310] Projektligji parashikon një reformë gjithëpërfshirëse në një numër institutesh juridike, ushtrimin efektiv të të drejtave dhe interesave të të gjithë pjesëmarrësve në procedurë, si dhe specifikimin dhe harmonizimin e saj me ligjet përkatëse. Miratimi i tij është i një rëndësie të jashtëzakonshme, për të cilën sërish po reagon Komisioni Evropian.[311] Prandaj, është e nevojshme që Kuvendi ta miratojë ligjin pa vonesë, në mënyrë që sa më shpejt të fillojë aktivitetet e nevojshme për përgatitjen e kapaciteteve të gjyqësorit për zbatimin e tij.[312]

Më 18 korrik 2023, u miratua Ligji i ri për ekspertizë[313] Një reformë kyçe që sjell ligji është shfuqizimi i Byrosë për Ekspertizë Gjyqësore si organ më vete i shtetit që kryen ekspertiza. Gjithashtu, përmirësohet kuadri ligjor për funksionimin e Odës së Ekspertëve, rregullohen dispozitat për përgjegjësinë disiplinore të ekspertëve dhe tentohet të eliminohen mangësitë e tjera. Është e nevojshme që me reformat në sistemin e ekspertizës, ndër të tjera, të sigurohet qasje tek ekspertët për përdoruesit e së drejtës për ndihmë juridike falas.[314]

Ndryshimet në Ligjin Penal shpjegohen më poshtë në seksionin “Korrupsioni”.

310 Ibid.

311 Komisioni Evropian, “Dokument i punës i Komisionit – Raporti i Maqedonisë së Veriut 2023”, “COMMISSION STAFF WORKING DOCUMENT – North Macedonia 2023 Report“) 8 nëntor 2023, https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023-11/SWD_2023_693% 20North%20 Macedonia%20report.pdf.

312 Ardita Abazi Imeri et al., “Analizë - Vlerësim gjithëpërfshirës i zbatimit të Strategjisë për Reforma në Sektorin Gjyqësor 2017-2022”, („Анализа – Сеопфатна оценка на спроведувањето на Стратегијата за реформа на правосудниот сектор 2017-2022“), (Instituti për Politikë Evropiane - Shkup, 10 nëntor 2022), https://bit.ly/3X2noxB.

313 “Ligji për ekspertizë”, („Закон за вештачење“), Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 154/2023.

314 Ardita Abazi Imeri et al., “Analizë - Vlerësim gjithëpërfshirës i zbatimit të Strategjisë për Reforma në Sektorin Gjyqësor 2017-2022”, („Анализа – Сеопфатна оценка на спроведувањето на Стратегијата за реформа на правосудниот сектор 2017-2022“ ), (Instituti për Politikë Evropiane - Shkup, 10 nëntor 2022), https://bit.ly/3X2noxB.

Ekipimi teknik, infrastrukturor dhe i personeli mbeten ende një sfidë dhe janë të një rëndësie të jashtëzakonshme për përmirësimin e cilësisë së trajnimeve të kryera nga AGJPP. Sigurimi i hapësirave të reja të Akademisë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë është i nevojshëm për të qenë në gjendje të kryejë plotësisht kompetencat e saj parësore, më saktësisht për të organizuar trajnime në kuadër të trajnimit të vazhdueshëm, si dhe për të pasur mundësi të mjaftueshme për të marrë kandidatë të rinj për trajnim fillestar; është gjithashtu e nevojshme të rritet realisht buxheti në dispozicionin e AGJPP-së, në përputhje me nevojat për funksionimin e pandërprerë dhe mirëmbajtjen e një niveli cilësor të punës;

Roli proaktiv i GJSRMV-së në miratimin e qëndrimeve dhe mendimeve ligjore parimore vazhdoi. Për të arritur një harmonizim më të madh të praktikës gjyqësore, nevojitet një numër më i madh i takimeve të GJSRMV me gjykatat e apelit, si dhe një rritje e aktivitetit të departamenteve të praktikës gjyqësore. Për të ndjekur drejtimet dhe qëndrimet e gjykatave të apelit në mbledhjet e tyre, konkluzionet e këtyre mbledhjeve duhet të jenë më transparente, gjë që do të thjeshtojë zbatimin e praktikës gjyqësore.

Është gjithashtu e nevojshme të avancohet më tej koncepti i ndërmjetësimit përmes aktiviteteve promovuese. Zbatimi i qëndrueshëm dhe në kohë i ndryshimeve ligjore është i nevojshëm, duke siguruar që të mos ketë mbivendosje të kompetencave midis Odës së Ndërmjetësve dhe Këshillit Kombëtar të Ndërmjetësimit, por edhe përmirësim të sistemit për arritjen e cilësisë në punën e ndërmjetësve;

Është e nevojshme që Kuvendi të miratojë pa vonesë Ligjin e ri për Procedurën Civile, në mënyrë që të fillojë sa më shpejt aktivitetet e nevojshme për përgatitjen e kapaciteteve të gjyqësorit për zbatimin e tij.

# EFIKASITETI

Sipas të dhënave nga Raporti Vjetor i Këshillit Gjyqësor për vitin 2022, gjykatat në vitin 2022 nuk kanë arritur të kapërcejnë fluksin e lëndëve dhe kanë zmadhuar numrin e lëndëve të prapambetura me 11.785 lëndë.[315] Nga raportet statistikore për punën e gjykatave, KGJRMV konstaton se në vitin 2022, nga 34 gjykata, 19 gjykata kanë qenë të përditsuara, ndërsa 15 gjykata të pa përditsuara, më saktësisht dy gjykata të apelit dhe 13 gjykata themelore.[316]

Është e nevojshme të përcaktohet efikasiteti dhe efektiviteti i masës shumëvjeçare të marrë për të zvogëluar prapambetjen e lëndëve të vjetra në gjyqësor, më të vjetra se tre, shtatë dhe dhjetë vjet,[317] për shkak të pjesshmërisë të zbatimit të masës. Ritmi me të cilin zgjidhen lëndët e vjetra nuk është mjaft i shpejtë për të kapërcyer fluksin e lëndëve të reja që bëhen lëndë të vjetra, prandaj numri absolut i lëndëve të vjetra që gjykatat kanë në funksion mbetet i njëjtë ndër vite.[318] Kështu, në vitin 2022, sipas të dhënave nga raporti, gjykatat rritën prapambetjen e lëndëve të vjetra gjyqësore me mbi 10% në lëndët gjyqësore më të vjetra se tre dhe shtatë vjet, dhe rritën prapambetjen me 6% në lëndët më të vjetra se dhjetë vjet.[319]

Me miratimin e vendimit për përcaktimin e numrit orientues të lëndëve për vitin 2023 nga Këshilli Gjyqësor, më 30 maj 2023,[320] u përcaktua retroaktivitet në veprim, në kundërshtim me nenin 52 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së Veriut. Gjithashtu, miratimi i vonuar i këtij vendimi vë në pikëpyetje edhe zbatimin e kontrollit mbi ushtrimin e normës orientuese nga gjykatat, si dhe cilësinë e raporteve vlerësuese tremujore për punën e gjykatave.[321]

Gjatë periudhës raportuese, përkatësisht 25 nëntor dhe 16 dhjetor 2022, Gjykata e Apelit Shkup vërtetoi ankesat e të pandehurve në lëndët "Trezor"[322] dhe "Target-Tvrdina",[323] duke rrëzuar kështu

315 Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut, «Raporti vjetor për punën e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2022», („Годишен извештај за работата на Судскиот совет на Република Северна Македонија за 2022 година"), shkurt 2023, https://bit.ly/3RbFZGq.

316 Ibid.

317 Me qëllim të zvogëlimit të numrit të lëndëve më të vjetra se tre, shtatë dhe dhjetë vjet, KGJRMV-ja me vendim, përmes kryetarëve të gjykatave, mandaton gjyqtarët që veprojnë për këto lëndë të përgatisin plan dhe projeksion për zgjidhjen e secilës lëndë. Plani dhe projeksioni janë pjesë përbërëse e raporteve të trupave punues të cilat i dorëzohen çdo muaj KGJRMV-së.

318 Petkovska dhe Tutikj, "Raporti vjetor i monitorimit për punën e Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit të Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut", („Годишен мониторинг извештај за работата на Судскиот совет и Советот на јавни обвинители на Република Северна Македонија").

319 Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut, «Raporti vjetor për punën e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2022», („Годишен извештај за работата на Судскиот совет на Република Северна Македонија за 2022 година"), shkurt 2023, https://bit.ly/3RbFZGq.

320 "Njoftim nga seanca e 443-të e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut – 30.05.2023", („Соопштение за 443. седница на Судскиот совет на РСМ – 30.05.2023 година"), faqja zyrtare e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, https://bit.ly/483rcoB.

321 Petkovska dhe Tutikj, "Raporti vjetor i monitorimit për punën e Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit të Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut", („Годишен мониторинг извештај за работата на Судскиот совет и Советот на јавни обвинители на Република Северна Македонија").

322 "Njoftim për publikun", („Соопштение за јавност"), Gjykata e Apelit Shkup – Portali Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut, 25 nëntor 2022, https://bit.ly/3R0Z2m5.

323 "Njoftim për publikun", („Соопштение за јавност"), Gjykata e Apelit Shkup – Portali Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut, 16 dhjetor 2022, https://bit.ly/3Rg4S3H.

aktgjykimet e shkallës së parë dhe duke i kthyer lëndët në Gjykatën Themelore Penale Shkup për rigjykim. Kështu, i pandehuri kryesor në të dy rastet u lirua nga dënimet e shqiptuara (burgim për tetë vjet,[324] gjegjësisht dymbëdhjetë vjet[325]). Arsyeja e deklaruar për anulimin e vendimeve të shkallës së parë ishte përcaktimi i shkeljeve thelbësore të dispozitave të Ligjit për Procedurën Penale nga Gjykata Themelore Penale Shkup, e cila vuri në pikëpyetje situatën faktike dhe zbatimin korrekt të Ligjit Penal.[326] Me këtë vendim të Gjykatës së Apelit Shkup, u hap mundësia e parashkrimit të veprës penale të të pandehurit të parë në rastin "Target-Tvrdina", përveç nëse arrihet një vendim i ri përfundimtar deri në vitin 2025.[327] Më pas, më 23 mars 2023, Gjykata e Apelit vërtetoi vendimin për lirim të Gjykatës Themelore Penale për të njëjtin të pandehur të parë në lëndën ˝Tortura˝,[328] dhe një ditë më vonë, dënimi me burg i të njëjtit të pandehur të parë në lëndën "Placevite na Vodno" u zëvendësua me një dënim me kusht.[329] Gjithashtu, duke shtyrë seancën më 30 mars 2023, për shkak të mungesës së një numri të madh të palëve dhe caktimit të një seance të re më 13 prill 2023, lënda "Titanik 2" për të njëjtin të pandehur të parë u parashkrua.[330] Kjo ka çuar në kritika nga publiku ekspert dhe misionet diplomatike,[331] si dhe në fillimin e një hetimi mbi efektivitetin e Gjykatës së Apelit Shkup në shqyrtimin e ankesave në dy nga rastet e përmendura,[332] të shpjeguara më hollësisht në seksionin ˝Përgjegjësia˝.

Sipas Raportit Vjetor për punën e Prokurorive Publike për vitin 2022,[333] gjatë punës së Prokurorisë Publike, Prokurorisë së Lartë Publike, Prokurorisë Themelore Publike dhe Prokurorisë

324 "Apeli anuloi vendimin për Mijallkovin me të cilën ai duhet të kishte vuajtur 8 vjet burg dhe të kthente 860 mijë euro në buxhet", („Апелација укина пресуда за Мијалков со која требаше да лежи 8 години во затвор и во буџетот да се вратат 860 илјади евра"), A1 on, 25 nëntor 2022, https://bit.ly/3wkMi0e.

325 "Apeli përmbys vendimin e përgjimit, Mijallkov u lirua nga dënimi me 12 vjet burg", („Апелација ја укина пресудата за прислушувањето, Мијалков ослободен од 12-годишната затворска казна"), A1 on, 16 dhjetor 2022, https://a1on.mk/macedonia/apelacija-ja-ukina-presudata-za-prislushkuvanjeto-mijalkov-osloboden-od-12-godishnata-zatvorska-kazna/.

326 "Njoftim publik", („Соопштение за јавност"), Gjykata e Apelit Shkup – Portali Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut, 25 nëntor 2022, https://bit.ly/3R0Z2m5; Njoftim publik", Gjykata e Apelit Shkup – Portali Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut, 16 dhjetor 2022, https://bit.ly/3Rg4S3H.

327 "Aktgjykimet u anuluan – Drejtësi e parashkruar", („Поништени пресуди – застарена правда"), Radio Evropa e Lirë, 19 dhjetor 2022, https://bit.ly/3QXUzAC.

328 "Njoftim për publikun", („Соопштение за јавност"), Gjykata e Apelit Shkup – Portali Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut, 23 mars 2023, https://bit.ly/3RijFLI.

329 "Njoftim për publikun", („Соопштение за јавност"), Gjykata e Apelit Shkup – Portali Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut, 24 mars 2023, https://bit.ly/3TgYLyz.

330 Vendimi i dytë i Gjykatës Themelore Penale u dha më 23 janar 2023, me të cilin i pandehuri i parë u dënua me dy vjet burgim. Prokuroria theksoi se nuk do të apelojë vendimin me qëllim të mos shtyhet procedimi dhe të mos parashkruhet lënda. "Nga sot, vepra e Mijallkov në 'Titanik 2' është e parashkruar", („Од денеска делото на Мијалков во 'Титаник 2' е застарено"), 360 stepeni, 7 prill 2023, https://360stepeni.mk/od-deneska-deloto-na-mijalkov-vo-titanik-2-e-zastareno/.

331 "Ambasadori amerikan ka qortuar institucionet e gjyqësorit", („Американскиот амбасадор ги прекори правосудните институции"), Alsat M, 25 prill 2023, https://alsat.mk/en/amerikanskiot-ambasador-gi-prekori-pravosudnite-institutsii/.

332 "Do të hetohet pse gjyqtarët e apelit mbajnë në sirtar lëndët e përgjimit me të cilat Mijallkov u dënua me 20 vjet burg", („Ќе се истражува зошто апелационите судии ги држат во фиока предметите за прислушувањето со кои Мијалков неправосилно е осуден на 20 години затвор"), Sakam da kazam,23 nëntor 2022, https://sdk.mk/index.php/makedonija/ke-se-istrazhuva-zoshto-apelatsionite-sudii-gi-drzhat-vo-fioka-predmetite-za-prislushuvaneto-so-koi-mijalkov-nepravosilno-e-osuden-na-20-godini-zatvor/.

333 Prokuroria Publike e Republikës së Maqedonisë së Veriut, "Raport mbi punën e Prokurorive Publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut në vitin 2022", („Извештај за работата на јавните обвинителства на Република Северна Македонија во 2022 година"), korrik 2023, https://jorm.gov.mk/wp-content/uploads/2023/09/izveshtaj-za-rabotata-na-javnite-obvinitelsta_2022_2_mail-2-3.pdf

Themelore Publike për Ndjekjen e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit në vitin 2022, ka vepruar në kohë dhe në mënyrë profesionale. Prokuroritë publike, përkundër problemeve me të cilat ballafaqohen, si numri i dukshëm i reduktuar i prokurorëve publikë, prokurori publike të paplotë dhe mjete të pamjaftueshme financiare për punë, arritën të kapërcejnë fluksin e padive të reja penale dhe të zvogëlojnë numrin e lëndëve të pazgjidhura. 61,6% e kallëzimeve penale janë zgjidhur gjatë vitit 2022, që është një rënie e vogël krahasuar me vitin 2021, ku janë zgjidhur 62,8% e kallëzimeve penale. Më pas, pati një rritje të lehtë të kallëzimeve penale të pazgjidhura deri në fund të vitit 2022, ku mbetën 38,4% e kallëzimeve penale, krahasuar me vitin 2021, kur mbetën 37,2% e kallëzimeve penale të pazgjidhura.

Problemi i mungesës së stafit, si një nga problemet kryesore me të cilat përballen gjyqësori dhe prokuroria publike, edhe pse pak i zbutur nga shpërndarja e duhur e 58 kandidatëve për gjyqtarë dhe prokurorë publikë të gjeneratës së shtatë të AGJPP, ishte gjithashtu i pranishëm gjatë periudhës raportuese. Në periudhën e ardhshme, është e nevojshme të bëhet një analizë me statistika të besueshme për punën e gjyqësorit dhe prokurorisë, në mënyrë që të planifikohet në kohë për stafin e nevojshëm, dhe të jetë në përputhje me rekomandimet dhe metodologjinë e Komisionit Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ).[334]

Në periudhën raportuese, Gjykata Kushtetuese ka vijuar të funksionojë me mungesë personeli. Megjithëse, më 28 tetor 2022, u zgjodhën dy gjyqtarë kushtetues,[335] dhe më 10 prill 2023, u zgjodh një gjyqtar tjetër kushtetues,[336] për shkak të mbarimit të mandatit të një gjyqtari kushtetues,[337] gjykata mbeti të punojë me dy gjyqtarë më pak. Debati për propozimin që Prokurori Publik i Republikës të bëhet gjyqtar kushtetues është bllokuar në Kuvend,[338] ndërsa propozimi për vendin tjetër vakant të janarit 2022 ende nuk është përcaktuar nga Komisioni për Zgjedhje dhe Emërime.[339]

---

334 Komisioni Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ), "Vlerësimi i Sistemeve Gjyqësore (2020-2022): Maqedonia e Veriut (Evaluation of the judicial systems (2020-2022): North Macedonia)" (Këshilli i Evropës, 30 shtator 2022)", https://rm.coe.int/north-macedonia-2020-en/168 5c90.

335 "Fatmir Skenderi dhe Tatjana Vasikj-Bozaxhieva zgjidhen si gjyqtarë të rinj kushtetues", („Фатмир Скендер и Татјана Васиќ-Бозаџиева избрани за нови уставни судии"), Slloboden Peçat, 28 tetor 2022, https://www.slobodenpecat.mk/fatmir-skender-i-tatjana-vasikj-bozhaxhieva-izbrani-za-novi-ustavni-sudii/.

336 "Elizabeta Dukovska nga Apeli i Shkupit është gjyqtare e re kushtetuese", („Елизабета Дуковска од Скопска Апелација е нова уставна судијка").

337 "Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese, Dobrilla Kacarska, me letër e informoi Kryetaren e Këshillit Gjyqësor, Pavlina Cërvenkovska, për skadimin e mandatit të gjyqtares Vangjelina Markudova", („Претседателката на Уставниот суд, Добрила Кацарска, со писмо ја извести претседателката на Судскиот совет, Павлина Црвенковска за истекот на мандатот на судијата Вангелина Маркудова"), faqja zyrtare e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 7 tetor 2022, http://ustavensud.mk/?p=22787.

338 "Dhjetëra ligje dhe vendime në Kuvend presin "gishtat e shpejtë", („Десетици закони и одлуки во Собрание чекаат „брзи прсти"), Radio Evropa e Lirë, 8 dhjetor 2023, https://www.slobodnaevropa.mk/a/desetici-zakoni-i-odluki-vo-sobranie-chekaat-brzi-prsti-/32721155.html.

339 Krijimi i propozimit për zgjedhjen e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë së Veriut u vendos si pikë në rendin e ditës të seancës së Komisionit të Zgjedhjeve dhe Emërimeve më 6 nëntor 2023. Trupi punues: Komisioni për Çështjet e Zgjedhjeve dhe Emërimeve, Detajet e Komisionit, https://www.sobranie.mk/detali-na-komisija.nspx?param=e048a1e0-0892-46ec-8af0-e20d0667fc60

Miratimi i ndryshimeve në Ligjin për Shërbimin Gjyqësor[340] dhe Ligjin për Prokurorinë Publike,[341] nuk shkaktoi kënaqësi të madhe tek zyrtarët e gjyqësorit dhe prokurorisë publike,[342] para së gjithash për shkak të vendimit të Gjykatës Kushtetuese për shfuqizimin e nenit 4 të Ligjit për ndryshimin e pagave dhe shtesave të tjera të personave të zgjedhur dhe të emëruar në Republikën e Maqedonisë të vitit 2010[343] dhe nenit 1 të Ligjit për ndryshimin e Ligjit për pagat dhe shtesave të tjera të personave të zgjedhur dhe të emëruar në Republikën e Maqedonisë të vitit 2014,[344] i cili përcaktoi një shumë fikse që shërbebte si bazë për përcaktimin e pagave të zyrtarëve.[345] Konkretisht, shfuqizimi i këtyre dispozitave rezulton nga dualiteti në rregullimin e bazës së pagës së personave të zgjedhur dhe të emëruar përmes ekzistencës së njëkohshme të dy normave (norma tjetër është neni 11) në të njëjtin ligj.[346] Mbetet në fuqi neni 11, sipas të cilit baza përcaktohet sipas pagës mesatare të arritur në vitin paraardhës siç përcaktohet nga Enti Shtetëror i Statistikave (ESHS), shumëzohet me koeficientin e përcaktuar dhe rritet me përqindjen e përvojës së punës nga 2.2 në 4.5 përqind.[347] Domethënë, me vendimin, pagë më e lartë prej 78% nga prilli 2023 morën 1,060 zyrtarë.[348] Vendimi, i cili shkaktoi reagime të forta në publik,[349] u theksua më pas si arsye nga zyrtarët e prokurorisë gjyqësore dhe publike për shkurtimin dhe mospagimin e shtesave të pagave. Zgjidhja urgjente e problemit të shtesave të pagave dhe rritjes së pagave për punonjësit në të dy shërbimet u kërkua fillimisht në qershor 2023.[350] Problemi u përshkallëzua me mospajtimin

340 Ligji për ndryshimin e Ligjit për Shërbimin Gjyqësor, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr. 235/2022.

341 Ligji për ndryshimin e Ligjit për Shërbimin e Prokurorisë Publike, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr. 235/2022.

342 Ndryshimet në Ligjin për Shërbimin Gjyqësor arrijnë barazinë midis punonjësve të sektorit privat dhe publik, duke përcaktuar të njëjtën sasi të pagës minimale ligjore dhe duke harmonizuar (në nivele) shpërblimet e tjera të nëpunësve gjyqësorë në të gjitha nivelet, si dhe duke siguruar vazhdimësinë e ndryshimeve në pagat e punonjësve të administratës gjyqësore në raport me pagën minimale në nivel kombëtar, si një qëllim afatgjatë. Me harmonizimin e Ligjit për Shërbimin Gjyqësor me Ligjin për Pagën Minimale, pagat e punonjësve të shërbimit gjyqësor rriten me 15%. Përmirësimi i kapaciteteve të shërbimit të Prokurorisë Publike synon të harmonizojë Ligjin për Shërbimin e Prokurorisë Publike me Ligjin për Punonjësit e Sektorit Publik dhe Ligjin për Zyrtarët Administrativë sepse ka pasaktësi në vendimin aktual ligjor në mënyrën e përcaktimit dhe pagesës së shtesave të pagave për zyrtarët e prokurorisë publike. Projektligji për ndryshimin e Ligjit për Shërbimin e Prokurorisë Publike përcakton të njëjtën shumë të pagës minimale ligjore dhe një harmonizim gradual të pagave të mbetura të nëpunësve të prokurorisë publike në të gjitha nivelet, si dhe për të siguruar vazhdimësinë e ndryshimeve të pagave në administratën e prokurorisë publike në lidhje me pagën minimale në nivel kombëtar.

343 "Ligji për ndryshimin e Ligjit për pagën dhe shtesat e tjera të personave të zgjedhur dhe të emëruar në Republikën e Maqedonisë", Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 97/2010.

344 "Ligji për ndryshimin e Ligjit për pagën dhe shtesat e tjera të personave të zgjedhur dhe të emëruar në Republikën e Maqedonisë", Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 139/2014.

345 "U. nr. 113/2022-1", faqja zyrtare e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 21 mars 2023, https://ustavensud.mk/?p=23879.

346 U. nr. 113/2022-1.

347 Ibid.

348 "Paga më të larta për 78 përqind kanë marrë 1060 zyrtarë", („Повисоки плати за 78 проценти добиле 1060 функционери"), Radio Evropa e Lirë, 15 maj 2023, https://www.slobodnaevropa.mk/a/32412337.html.

349 "Sindikatat kalkuluan që pagat e zyrtarëve, kryetarëve të komunave dhe gjyqtarëve do të rriten për 78%", („За 78% ќе се зголеми платата на функционерите, градоначалниците, судиите, пресметаа синдикатите"), Tellma TV, 31 mars 2023, https://telma.com.mk/2023/03/31/za-78-kje-se-zgolemi-platata-na-funkcionerite-gradonachalnicite-sudiite-presmetaa-sindikatite/.

350 "Gjasat për grevë në gjykata janë gjithnjë e më të mëdha nëse nuk zgjidhet problemi i shtesave të pagave dhe shuma e pagave të punonjësve në Shërbimin Gjyqësor", („Сè поизвесен е штрајкот во судовите доколку не се реши проблемот со додатоците на плата и висината на платите на вработените во Судската служба"), faqja zyrtare e Sindikatës së Punëtorëve të Administratës, Autoriteteve Gjyqësore dhe Shoqatave të Qytetarëve të Republikës së Maqedonisë, 6 qershor 2023, https://www.upoz.org.mk/mk/novosti/353-se-poizvesen-e-strajkot-vo-sudovite-dokolku-ne-se-resi-problemot-so-dodatocite-na-plata-visinata-na-plat-na-vrabotenite-vo-sudskata-sluzba.

dhe refuzimin e kërkesës, dërguar nga Këshilli i Buxhetit Gjyqësor në Ministrinë e Financave për rishpërndarjen e fondeve për pagesën e shtesave të pagave,[351] e cila më 28 shtator 2023 rezultoi në një grevë të përgjithshme të gjykatës[352] dhe prokurorisë publike.[353] Greva, e udhëhequr kryesisht nga Sindikata e Punëtorëve Administrativë, Autoriteteve Gjyqësore dhe Shoqatave të Qytetarëve të Republikës së Maqedonisë (Sindikata e PAOGJSHQ), udhëhiqet nga kërkesat për një rritje të pagave prej 78% dhe kthimin e shtesave të pagave prej 35%.[354]

Është e nevojshme të miratohet një metodologji për mbajtjen e statistikave unike dhe absolutisht të sakta për ngarkesën e punës së gjykatave dhe prokurorive me qëllim planifikimin në kohë për stafin e nevojshëm dhe kryerjen e analizave të sakta dhe ndërmarrjen e veprimeve të duhura për të kapërcyer pasivitetin e gjykatave dhe prokurorive, me koordinim dhe bashkëpunim të përbashkët midis KGJRMV dhe GJSRMV nga njëra anë dhe KPPRMV dhe PPRMV nga ana tjetër;

Është e nevojshme të përcaktohet efikasiteti dhe efektiviteti i masës shumëvjeçare të marrë nga ana e KGJRMV për të zvogëluar prapambetjen e lëndëve të vjetra në gjyqësor, më të vjetra se tre, shtatë dhe dhjetë vjet, për shkak të pjesshmërisë së zbatimit të masës;

Rritja e efikasitetit të gjyqësorit dhe prokurorisë publike kërkon më shumë burime financiare, rritje të burimeve njerëzore dhe rritje të kushteve hapësinore dhe teknike të punës. E patjetërsueshme është të zëvendësohen pajisjet e vjetruara të TI të shumicës të shërbimit të prokurorisë publike.

Është e nevojshme të zgjidhet në mënyrë adekuate problemi i shtesave të pagave dhe të rriten pagat e gjyqësorit dhe prokurorisë publike, në proporcion me miratimin e ndryshimeve të duhura ligjore për uljen e pagave të personave të zgjedhur dhe të emëruar në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

351 Në seancën e mbajtur më 07.07.2023, Këshilli i Buxhetit Gjyqësor vendosi të sigurojë fonde për pagesën e shtesave të pagave për muajin qershor 2023 në masën 15% për nëpunësit gjyqësorë dhe punonjësit e Këshillit Gjyqësor dhe Akademisë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë. Megjithatë, Ministria e Financave raportoi se nuk kishte hapësirë fiskale për pagesën e shtesave të pagave për muajin qershor, duke shpjeguar se në përputhje me rregulloret e operacioneve buxhetore, nuk duhet të bëhen angazhime mbi kufirin e fondeve të miratuara nga buxheti. "Njoftim nga Ministria e Financave", („Известување од Министерство за финансии"), 11 korrik 2023, https://bit.ly/48RsOCs.

352 "Shërbimi gjyqësor, përsëri në rrugë", („Судската служба, повторно на улица"), faqja zyrtare e Sindikatës e Punëtorëve nga Administrata, Autoritetet Gjyqësore dhe Shoqatat e Qytetarëve (Sindikata e PAOGJSHQ), 29 shtator 2023, https://www.upoz.org.mk/mk/novosti/368-sudska-ta-sluzba-povtorno-na-ulica.

353 "Filloi greva në prokuroritë publike", („Започнат штрајк во јавните обвинителства"), faqja zyrtare e Sindikatës e Punëtorëve nga Administrata, Autoritetet Gjyqësore dhe Shoqatat e Qytetarëve (Sindikata e PAOGJSHQ), 29 shtator 2023, https://www.upoz.org.mk/mk/novosti/367-zapoc-nat-strajk-vo-javnite-obvinitelstva.

354 "Ose paga më të larta ose grevë – punonjësit e prokurorive dhe gjykatave me ultimatum", („Или повисоки плати или штрајк – вработените во Обвинителствата и судовите со ултиматум"), Telma TV, 19 shtator 2023, https://telma.com.mk/2023/09/19/ili-povisoki-plati-ili-shtrajk-vrabo-tenite-vo-obvinitelstvata-i-sudovite-so-ultimatum/.



# 2. Lufta kundër korrupsionit

Republika e Maqedonisë së Veriut ka treguar përmirësim në luftën kundër korrupsionit, por megjithatë problemi i korrupsionit mbetet një sfidë e madhe për qytetarët. Raportet nga burime të ndryshme, përfshirë Transparency International,[355] Departamenti Amerikan i Shtetit[356] dhe Freedom House,[357] tregojnë përparim, por gjithashtu tregojnë nevojën për përmirësim në luftën kundër korrupsionit, me fokus në rritjen e burimeve dhe mbështetjen për institucionet që zbatojnë masat anti-korrupsion.

Raporti i KE[358] dhe Raporti i shqyrtimit[359] për Republikën e Maqedonisë së Veriut theksojnë nevojën për të rritur burimet për të luftuar korrupsionin dhe konfliktin e interesit, si dhe mbështetjen për institucionet që zbatojnë masat anti-korrupsion.

Rekomandimet përfshijnë rritjen e burimeve të institucioneve, përfshirë ekspertët financiarë, zbatimin e rekomandimeve të GRECO-s dhe sigurimin e llogaridhënies efektive për rastet e korrupsionit të nivelit të lartë. Gjithashtu thekson nevojën e rritjes së numrit të dënimeve përfundimtare në këto lloje rasti korrupsioni.

355 Transparency International, "Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit 2022" (2023), https://www.transparency.org/en/cpi/2022/index/mkd.

356 Departamenti Amerikan i Shtetit, 'Raporti i Gjendjes së të Drejtave të Njeriut për Maqedoninë e Veriut 2022', 21 mars 2023, https://www.state.gov/reports/2022-country-reports-on-human-rights-practices/north-macedonia/.

357 "Raporti i Freedom House": Për Maqedoninë, nota më e ulët për korrupsion", („Извештај на 'Фридом хаус': За Македонија, најниска оценка за корупција"), 24 news, 24 maj 2023, https://24.mk/details/izveshtaj-na-fridom-khaus-za-makedonija-najniska-ocenka-za-korupcija.

358 Komisioni Evropian, "Dokumenti i punës së Komisionit – Raporti Maqedonia e Veriut 2022", 12 tetor 2022, https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/north-macedonia-report-2022_en.

359 Komisioni Evropian, "Raporti i shqyrtimit – Maqedonia e Veriut", 24 korrik 2023, https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/screening-report-north-macedonia_en.

# KUADRI INSTITUCIONAL

## Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit

KSHPK ka marrë 698 raporte nga qytetarët gjatë vitit 2022 për rastet e korrupsionit dhe shpërdorimit të detyrës publike. Ai formoi 127 lëndë me iniciativën e tij dhe lëshoi 403 urdhërpagesa për kundërvajtje. Në fushën e korrupsionit ka marrë vendime për 509 lëndë, në fushën e konfliktit të interesit ka marrë vendime për 161 lëndë, në fushën e financimit të fushatave zgjedhore ka vendosur për 14 lëndë dhe në aspektin e pasurisë ka vendosur për 372 lëndë (gjithsej 1,056 vendime).[360] Raporti vjetor për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit për vitin 2022 tregoi se vetëm 10% e aktiviteteve të planifikuara për vitin 2022 janë zbatuar plotësisht, 35% janë në proces të zbatimit , dhe 55% nuk janë zbatuar fare, me përparimin më të madh në gjyqësor dhe arsim.[361] U iniciuan punëtori për të ndryshuar Strategjinë, ndërsa KSHPK bashkëpunoi me institucione të tjera për të shkëmbyer informacion mbi rastet e korrupsionit dhe konfliktit të interesit.[362]

Në mes të shkurtit 2023, u zhvillua një mision ekspertësh i TAIEX për të krijuar një qendër analitike brenda KSHPK-së, qëllimi i së cilës do të ishte rritja e kapaciteteve të institucioneve dhe organizatave për të luftuar korrupsionin dhe për të rritur integritetin dhe besimin e qytetarëve.[363]

Në periudhën raportuese, KSHPK-ja tërhoqi vëmendje të konsiderueshme për shkak të një sërë hetimesh të kryera kundër zyrtarëve aktualë dhe ish-zyrtarëve. Hetimet mbuluan mosdorëzimin e deklarimeve të pasurisë nga disa zyrtarë, dhe Komisioni arriti në përfundimin se asnjë interes material nuk mund të provohej në asnjë rast.[364] Gjithashtu, KSHPK refuzoi një raportim kundër punës së një ish-zëvendësministri të Kulturës në lidhje me pretendimin e

360 Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, "Raporti vjetor për punën e Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit për vitin 2022", („Годишен извештај за работата на Државната комисија за спречување на корупција за 2022 година"), mars 2023, https://dksk.mk/wp-content/uploads/2023/03/GI-2022-final.pdf.

361 Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, "Raporti vjetor për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit 2021-2025 për periudhën 01.01.2022 deri më 31.12.2022", („Годишен извештај за спроведување на Националната стратегија за спречување на корупцијата и судирот на интереси 2021-2025 за период 01.01.2022 година до 31.12.2022 година"), mars 2023,https://dksk.mk/wp-content/uploads/2023/03/ Annual-report-NCCSI_final.pdf.

362 "Punëtori për ndryshimin e Strategjisë Kombëtare për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit 2021-2025", („Работилници за изменување и дополнување на Националната стратегија за спречување на корупцијата и судирот на интереси 2021-2025"), faqja zyrtare e Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, 8 maj 2023, bit.ly/3MxuX5k.

363 "Misioni i ekspertëve TAIEX për krijimin e një Qendre Analitike brenda KSHPK-së", („TAIEX експертската мисија за формирање на Аналитички центар во рамки на ДКСК"), faqja zyrtare e Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, 14 shkurt 2023, https://bit.ly/3KotXGf.

364 "KSHPK mbylli disa lëndë për mosdorëzimin e deklarimit të pasurisë të zyrtarëve", („ДКСК затвори повеќе предмети за недоставување на анкетен лист од функционери"), Pravdiko, 14 tetor 2022, https://www.pravdiko.mk/dksk-zatvori-poveke-predmeti-za-nedostavuvane-na-anketen-list-od-funktsioneri/.

shpërdorimit të detyrës dhe përfitimit material duke zhvatur para,[365] por procedimet penale janë ende duke u zhvilluar kundër një ish-ministri tjetër të Kulturës për të njëjtin krim.[366] Gjatë hetimit rreth provimit të jurisprudencës që e ka kaluar djali i kryetarit aktual të Kuvendit, u konkluduа se ekziston mundësia t'i merret vërtetimi për provimin e jurisprudencës, sepse iu dha e drejta me vendim diskrecional nga një ish-ministër i Drejtësisë, pa i plotësuar kushtet e përcaktuara për nivelin arsimor.[367] Megjithatë, ai arriti të regjistrohet dhe të përfundojë Akademinë për Gjyqtarë dhe Prokurorë me atë certifikatë, kështu që emri i tij ishte në listën e prokurorëve të ardhshëm publikë të botuar nga Akademia në mes të shkurtit 2023.[368]

Hetimet e KSHPK-së u zgjeruan në raste të tjera të korrupsionit të mundshëm, përfshirë kryetarin e bashkisë së Strugës, përfshirja e të cilit në praktika korruptive e futi atë në listën e zezë të SHBA-së.[369] Ky procedim kulmoi me kallëzim penal ndaj kryetarit të bashkisë dhe personave të lidhur me të për dyshime në lidhje me shitjen e pasurisë shtetërore dhe pastrimin e mundshëm të parave.[370] Hetime të tjera zbuluan raste të parregullsive në prokurimin publik[371] dhe kontrata të pavlefshme me kompani që lidhen me figura politike,[372] të cilat ngritën pyetje serioze në lidhje me transparencën e prokurimit publik në vend. Këto veprime të KSHPK-së shkaktuan reagime dhe diskutime të rëndësishme rreth nevojës për të forcuar mbikëqyrjen dhe transparencën e institucioneve dhe proceseve qeveritare në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

---

365 "KSHPK mbylli disa lëndë për mosdorëzimin e deklarimit të pasurisë të zyrtarëve", („ДКСК затвори повеќе предмети за недоставување на анкетен лист од функционери"), Pravdiko, 14 tetor 2022, https://www.pravdiko.mk/dksk-zatvori-poveke-predmeti-za-nedostavuvane-na-anketen-list-od-funktsioneri/.

366 "Diskutimi i Raportit në hije për Kapitullin 23 për periudhën tetor 2022 – shtator 2023", („Дискусија за Извештајот во сенка за Поглавје 23 за периодот октомври 2022 – септември 2023 година"), faqja zyrtare e Institutit të Politikave Evropiane – Shkup, 22 dhjetor 2023, https://epi.org.mk/post/25506.

367 "Djali i Xhaferit u zgjodh prokuror edhe pse Antikorrupsioni udhëheq një lëndë për të", („Синот на Џафери избран за обвинител иако Антикорупциска води случај за него"), Alsat M, 21 shkurt 2023, https://alsat.mk/en/sinot-na-dhaferi-izbran-za-obvinitel-iako-antikoruptsiska-vodi-sluchaj-za-nego/.

368 "Djali i Xhaferit në mesin e kandidatëve të përzgjedhur për prokurorë publikë, edhe pse antikorrupsioni udhëheq një lëndë për të", („Синот на Џафери меѓу избраните кандидати за обвинители, иако антикорупциска води случај за него"), Tellma, 22 shkurt 2023, https://telma.com.mk/2023/02/22/sinot-na-dzhaferi-izbran-za-obvinitel-iako-antikorupciska-vodi-sluchaj-za-nego/.

369 "Masa për Merko – i padëshirueshëm në Shtetet e Bashkuara, i pari në 'listën e zezë' të zgjeruar", („Мерка за Мерко – непожелен во САД, прв на проширената 'црна листа'"), Slobodnaevropa.mk, 21 qershor 2023, https://bit.ly/3JIaXD7.

370 "KSHPK-ja filloi procedurë penale kundër Merkos, vërtetoi dokument të falsifikuar për shpronësim të tokës shtetërore në Strugë", („ДКСК иницира кривична постапка против Мерко, заверил фалсификуван документ за отуѓување државно земјиште во Струга"), 360 stepeni, 11 shtator 2023, https://360stepeni.mk/dksk-initsira-krivichna-postapka-protiv-merko-zaveril-falsifikuvan-dokument-za-otuguvane-na-drzhavno-zemjishte-vo-struga/.

371 "KSHPK do të hapë një çështje për 'Eurovia' – kompaninë që mori tenderin nga MPJ për përshtatjen e sallës 'Boris Trajkovski', („ДКСК ќе отвори предмет за 'Еуровиа' – фирмата што го доби тендерот од МНР за адаптација на салата 'Борис Трајковски'), 360 stepeni, 29 gusht 2023, https://360stepeni.mk/dksk-ke-otvori-predmet-za-eurovia-firmata-shto-go-dobi-tenderot-od-mnr-za-adaptatsija-na-salata-boris-trajkovski/.

372 "Antikorrupsioni do t'i vë 'në shënjestër' nipërit e Ahmetit", („Антикорупциска ќе ги стави 'на тапет' внуците на Ахмети"), 360 stepeni, 3 korrik 2023, https://360stepeni.mk/antikoruptsiska-ke-gi-stavi-na-tapet-vnutsite-na-ahmeti/.

Megjithëse KSHPK dhe PPRMV u takuan për të forcuar bashkëpunimin e tyre, hetimi i[373] KSHPK për çështjen “Trust” e ndërpreu këtë bashkëpunim, pasi zbuloi parregullsi dhe abuzime të shumta nga aktorë të rëndësishëm, përfshirë PTHPNKOK.[374] Më pas, KSHPK parashtroi kërkesë në PPRMV për hetimin e dëmit të qëllimshëm të kreditorëve përmes falsifikimit të dokumentacionit dhe shkeljeve të tjera, dhe PPRMV u përgjigj se ky hetim është i panevojshëm dhe shërben për të ndikuar në hetimin e kryer nga PTHPNKOK.[375] Megjithëse aktivitetet e parashikuara në memorandumin e bashkëpunimit midis KSHPK-së dhe PPRMV-së u ngrinë përkohësisht,[376] KSHPK-ja vazhdoi të komunikonte me PPRMV-në në lidhje me procedurat e mundshme penale të nxitura nga rastet e korrupsionit.[377]

KSHPK nënshkroi marrëveshje për përdorimin elektronik të të dhënave nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut,[378] nga Agjencia për Kadastrën e Patundshmërive[379] dhe nga Depozituesi Qendror i Letrave me Vlerë,[380] ndërsa me Ministrinë e Punëve të Brendshme (MPB) nënshkruan një marrëveshje për bashkëpunim dhe shkëmbim të të dhënave në formë elektronike dhe një memorandum bashkëpunimi.[381] KSHPK gjithashtu lidhi një memorandum bashkëpunimi me Ministrinë e Shoqërisë së Informacionit dhe Administratës (MSHIA)[382] dhe me PPRMV[383].

373 “Intensifikimi i bashkëpunimit midis KSHPK-së dhe Prokurorisë Publike”, („Интензивирање на соработката меѓу ДКСК и Јавното обвинителство“) faqja zyrtare e Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, 17 korrik 2023, https://bit.ly/3Mqx7v9.

374 “Antikorrupsioni vuri në lëvizje rastet e Sead Koçan, Transmet dhe Pucko Petrol, shteti i dëmtuar me miliona dollarë, të përfshirë prokurorë, gjyqtarë, noterë, përmbarues dhe vlerësues.”, („Антикорупциска го одмота клопчето на Сеад Кочан, Трансмет и Пуцко Петрол, државата оштетена за милионски суми, вмешани обвинители, судии, нотари, извршители и проценители“), Slloboden Peçat, 19 korrik 2023, https://bit.ly/3QM2Yc8.

375 “Njoftimi nga 23.07.2023”, („Соопштение од 23.07.2023 г.“), faqja zyrtare e Prokurorisë Publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 23 korrik 2023, https://jorm.gov.mk/soopshtenie-119/.

376 “Trust” ngriu marrëdhëniet e PP dhe KSHPK: Zyrtarët e antikorrupsionit përpiqen të ndikojnë në veprimet e prokurorisë”, („Труст“ ги замрзна односите на ЈО и ДКСК: Антикорупционерите се обидуваат да влијаат врз постапките на обвинителството“), Slloboden Peçat, 21 korrik 2023, https://bit.ly/47kb0yg.

377 “Diskutimi i Raportit në hije për Kapitullin 23 për periudhën tetor 2022 – shtator 2023”, („Дискусија за Извештајот во сенка за Поглавје 23 за периодот октомври 2022 – септември 2023 година“), faqja zyrtare e Institutit të Politikave Evropiane – Shkup, 22 dhjetor 2023, https://epi.org.mk/post/25506.

378 “Marrëveshje e nënshkruar për përdorimin elektronik të të dhënave me Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut”, („Потпишан договор за електронско користење на податоци со Централниот регистар на Република Северна Македонија“), faqja zyrtare e Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, 6 tetor 2022, https://bit.ly/3ZVQfWF.

379 “KSHPK merr qasje elektronike në të dhënat e Agjencisë së Kadastrës të Patundshmërive”, („ДКСК добива електронски пристап до податоците на Агенцијата за катастар на недвижности“), faqja zyrtare e Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, 28 tetor 2022, https://bit.ly/3iVdPSZ.

380 “KSHPK do të marrë në mënyrë elektronike të dhëna nga Depozituesi Qendror i Letrave me Vlerë”, („ДКСК електронски ќе добива податоци од Централниот депозитар за хартии од вредност“), faqja zyrtare e Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, 26 korrik 2023, https://bit.ly/48OMIOF.

381 “Kryetarja e KSHPK-së Biljana Ivanovska dhe Ministri i Brendshëm Oliver Spasovski nënshkruan marrëveshje për bashkëpunim dhe shkëmbim të të dhënave në formë elektronike dhe Memorandum për përmirësimin e sistemit të mbrojtjes së sinjalizuesve si mjet efektiv në luftën kundër korrupsionit”, („Претседателката на ДКСК, Билјана Ивановска, и министерот за внатрешни работи, Оливер Спасовски, потпишаа Договор за соработка и размена на податоци во електронска форма и Меморандум за унапредување на системот на заштита на укажувачите, како ефективна алатка во борбата против корупцијата“), faqja zyrtare e Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, 14 tetor 2022, https://bit.ly/3HqgJbU.

382 “Nënshkruhet memorandum bashkëpunimi me Ministrinë e Shoqërisë Informatike dhe Administratës”, („Потпишан Меморандум за соработка со Министерството за информатичко општество и администрација“), faqja zyrtare e Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, 3 nëntor 2022, https://bit.ly/3wqsFUF.

383 “Nënshkruhet memorandum bashkëpunimi me Prokurorinë Publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut”, („Потпишан меморандум за соработка со Јавното обвинителство на Република Северна Македонија“), faqja zyrtare e Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, 20 shkurt 2023, https://bit.ly/3KqDc8J.

## Prokuroria Publike

Raporti i fundit për prokuroritë publike vë në dukje sfidën me të cilën përballen në rritjen e numrit të lëndëve në raport me numrin e reduktuar të prokurorëve publikë, ku secili prokuror trajton rreth 170 lëndë të reja në vit. Mungesa e pajisjeve teknike dhe pavarësia financiare, së bashku me stafin e kufizuar të prokurorive publike, mbeten sfidat kryesore për këto institucione. Po ndërmerren përpjekje intensive për të rritur besimin e publikut duke rritur transparencën e procedurave dhe bashkëpunimin ndërinstitucional dhe ndërkombëtar për të forcuar kapacitetet.[384]

Megjithëse deri më tani janë krijuar katër qendra hetimore në Prokurorinë Publike, përfshirë Prokurorinë Themelore Publike për Ndjekjen e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit, asnjë qendër e re nuk është hapur që nga viti 2018.[385]

Në shtator 2023, PPRMV nënshkroi një deklaratë për pjesëmarrjen në Rrjetin Global Operacional të Autoriteteve Kundër Korrupsionit (GlobE), së bashku me autoritetet antikorrupsion të vendeve të tjera të rajonit. Pjesëmarrja në këtë rrjet është e rëndësishme për inkurajimin e shkëmbimit të përvojave dhe bashkëpunimit ndërkombëtar në ndjekjen penale të rasteve të korrupsionit.[386]

Ndryshimet në Kodin Penal, të cilat parashikojnë uljen e dënimeve për krime, shpërdorim detyre dhe autorizim dhe shoqërim kriminal, u vunë në provë në disa raste të spikatura korrupsioni. Prokurori Publik në fjalën përmbyllëse për rastin Titanik[387] njoftoi tërheqjen e akuzës së shoqërimit kriminale, ku gjykimi do të vazhdonte për shkak të akuzave shtesë që nuk janë të parashkruara.[388] Gjykimi në lëndën “Traektorija” ndoqi një rrjedhë të ngjashme, me që debati kryesor nuk i mbuloi ndryshimet në Kodin Penal.[389] Në të kundërt, prokurorët publikë në

384 Prokuroria Publike e Republikës së Maqedonisë së Veriut, “Raport mbi punën e Prokurorive Publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut në vitin 2022”, („Извештај за работата на јавните обвинителства на Република Северна Македонија во 2022 година“), korrik 2022, https://jorm.gov.mk/wp-content/uploads/2023/09/izveshtaj-za-rabotata-na-javnite-obvinitelsta_2022_2_mail-2-3.pdf.

385 Ibid.

386 “Prokuroria Publike – nënshkruese e Deklaratës për krijimin e një komponenti rajonal të rrjetës GlobE për Ballkanin Perëndimor”, („Јавното обвинителство – потписник на Декларацијата за формирање на регионална компонента на GlobE-мрежата за Западен Балкан“), faqja zyrtare e Prokurorisë Publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 5 shtator 2023, https://bit.ly/46XCdqI.

387 “Ndryshimet në Kodin Penal sot vihen në test në seancën e “Titanik”", („Измените на Кривичниот законик денеска на тест на рочиштето за 'Титаник'“), Tellma TV, 18 shtator 2023, https://telma.com.mk/2023/09/18/izmenite-na-krivichniot-zakonik-deneska-na-test-na-rochishteto-za-titanik/.

388 “Prokurori në “Titanik” do të tërheqë akuzën e shoqërimit kriminal në fjalët mbyllëse, gjykimi vazhdon sepse të pandehurit janë gjithashtu përgjegjës për krime të tjera që nuk janë të parashkruara”, („Обвинителката во 'Титаник' во завршен збор ќе го повлече обвинението за злосторничко здружување, судењето продолжува зашто обвинетите одговараат и за други кривични дела што не застаруваат“), Tellma TV, 18 shtator 2023, https://bit.ly/3FOb39V.

389 “Duke pritur që Prokuroria të thotë se çka pas ndryshimeve në Kodin Penal, gjykimet vazhdojnë me një ritëm tjetër”, („Додека се чека Обвинителството да каже што по измените на КЗ, судските процеси течат со различен ритам“), 360 stepeni, 22 shtator 2023, https://360stepeni.mk/dodeka-se-cheka-obvinitelstvoto-da-kazhe-shto-po-izmenite-na-kz-sudskite-protsesi-techat-so-razlichen-ritam/.

lëndën ˝Target-Tvrdina˝ kërkuan shtyrjen e seancës për të analizuar ndikimin e ndryshimeve në kualifikimin ligjor të krimeve për të cilat akuzohen të pandehurit.[390]

Para miratimit të këtyre ndryshimeve në Kodin Penal, ka pasur progres të dukshëm në rastet e korrupsionit të lartë. Në rastin Titanik, ish-ministri i Transportit dhe Lidhjeve mori një dënim me burg prej tre vjet e gjashtë muaj.[391] Në rastin "Softveri", përfundoi procedura e provës,[392] pas së cilës ish-Sekretari i Përgjithshëm i Qeverisë mori një dënim me burg prej tetë vjetësh.[393]

Më 8 mars 2023, u nënshkrua kontrata për ndërtimin e Korridoreve 8 dhe 10 nga Ministria e Transportit dhe Lidhjeve, Ndërmarrja Publike për Rrugët Shtetërore dhe Konsorciumi Behtel dhe Enka. Marrëveshja rregullon një investim qeveritar me vlerë 1.3 miliardë euro, që synon përmirësimin e cilësisë së infrastrukturës rrugore dhe trafikut përmes ndërtimit të katër seksioneve të autostradës me një total prej 110 km.[394] Pas pretendimeve për një sërë parregullsish,[395] PTHPNKOK[396] dhe KSHPK[397] hapën hetime për marrëveshjen e lartpërmendur, pas së cilës Qeveria u siguroi atyre tekstin e marrëveshjes,[398] [399] por në një version të redaktuar për shkak të klauzolës së konfidencialitetit.[400] Ndërkohë, Kuvendi miratoi[401] ndryshime

390 ""Target-Fortresa" shtyhet ndërsa prokurorët analizojnë se cilat vepra parashkruhen dhe cilat jo", („'Таргет-Тврдина' се одложи додека обвинителите анализираат кои дела застаруваат, а кои остануваат"), Tellma, 19 shtator 2023, https://telma.com.mk/2023/09/19/target-tvrdina-se-odlozhi-dodeka-obvinitelite-analiziraat-koi-dela-zastaruvaat-a-koi-ostanuvaat/.

391 "Ish-ministri Janakieski u nis për në Idrizovë me çanta të paketuara mbi shpinë dhe nën qetësues", („Поранешниот министер Јанакиески замина во 'Идризово' со спакувани торби на грб и под седативи"), Mkd.mk, 6 korrik 2023, https://mkd.mk/node/519894.

392 "Rashkovski pretendon se softueri është prokuruar vetëm për analizë dhe i kërkon gjykatës ta testojë atë drejtpërdrejt", („Рашковски тврди дека софтверот бил набавен само за анализи и бара од судот да го тестира во живо"), 360 stepeni, 1 nëntor 2022, https://360stepeni.mk/rashkovski-tvrdi-deka-softverot-bil-nabaven-samo-za-analizi-i-bara-od-sudot-da-go-testira-vo-zhivo/; "Spasovski: Nuk isha i njohur me softuerin e Rashkovskit, Ministria e Brendshme po bënte analizat e veta për përmirësimin e "Sejf Siti" me kërkesë të Zaevit", („Спасовски: Не бев запознаен со софтверот на Рашковски, МВР правеше свои анализи за надградба на 'Сејф сити' на барање на Заев"), 360 stepeni, 1 nëntor 2022, https://bit.ly/3Dq47if.

393 "Rashkovski i dënuar me tetë vjet burg", („Рашковски осуден на осум години казна затвор"), Makfaks, 6 korrik 2023, https://bit.ly/3FkYi6C.

394 "Nënshkruhet kontrata për ndërtimin e Korridorit 8 dhe 10 d, fillon realizimi i një prej projekteve më të mëdha infrastrukturore", („Потпишан договорот за изградба на Коридорот 8 и 10 д, започнува реализацијата на еден од најголемите инфраструктурни проекти"), faqja zyrtare e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, 8 mars 2023, https://vlada.mk/node/32389.

395 Partia më e madhe politike e opozitës VMRO-DPMNE vuri në dukje një sërë parregullsish të pretenduara në lidhje me këtë kontratë, për shembull, njëra nga kompanitë e angazhuara mori lejen e saj gjatë procedurës së prokurimit publik, se e njëjta kompani ka një aktivitet tjetër kryesor të regjistruar, jo ndërtimin e rrugëve, dhe se shuma që do të paguhet për mbikëqyrjen e projektit do të jetë shtatë herë më e shtrenjtë në krahasim me projektet e tjera.

396 "Prokuroria hapi lëndë për mbikëqyrjen e korridoreve 8 dhe 10 d", („Обвинителството отвори предмет за надзорот врз коридорите 8 и 10 д"), Televizioni Nova, 28 mars 2023, https://novatv.mk/obvinitelstvoto-otvori-predemet-za-nadzorot-vrz-koridorite-8-i-10-d/.

397 "Antikorrupsioni hap lëndë për ndërtimin e korridoreve 8 dhe 10", („Антикорупциска отвора предмет за изградбата на коридорите 8 и 10"), Republika, 9 mars 2023, https://republika.mk/vesti/makedonija/antikoruptsiska-otvara-predmet-za-izgradbata-na-koridorite-8-i-10/.

398 "Kontrata me 'Behtel dhe Enka' e dorëzuar në Prokurorinë Publike", („Договорот со 'Бехтел и Енка' доставен до Јавното обвинителство"), Slloboden Peçat, 5 maj 2023, https://bit.ly/3QPbqaF.

399 "Kontrata me 'Behtel dhe Enka' në byronë e Antikorrupsionit", („Договорот со 'Бехтел и Енка' на биро кај Антикорупционерите"), Tellma TV, 19 maj 2023, https://telma.com.mk/2023/05/19/dogovorot-so-behtel-i-enka-na-biro-kaj-antikorupcionerite/.

400 "Grubi – Antikorrupsioni mori një version të redaktuar të kontratës me 'Behtel dhe Enka'", („Груби – Антикорупциска доби редактирана верзија од договорот со 'Бехтел и Енка'"), Evropa e Lirë, 1 qershor 2023, https://www.slobodnaevropa.mk/a/32438910.html.

401 "Në ditën e rezervuar për pyetje parlamentare, shumica parlamentare miratoi pesë ligjet për ndërtimin e autostradave të 'Behtel dhe Enka'", („На денот резервиран за пратенички прашања, парламентарното мнозинство ги донесе петте закони за градбата на автопатите од 'Бехтел и Енка'"), Sakam da Kazam, 26 maj 2023, https://bit.ly/3QL2dA6.

në ligje[402] me qëllim që ndërtimi të bëhet më i shpejtë dhe më i lirë.[403] Ligjet u shënuan me flamurin evropian, gjë që ngriti shqetësime nga Delegacioni i BE-së, duke deklaruar se ndryshimet në ligje mund të mos jenë në përputhje me legjislacionin dhe standardet e BE-së.[404] Përveç të gjitha këtyre indikacioneve, aktivitetet përgatitore për ndërtimin e korridoreve vazhduan[405], ndërsa ndërtimi filloi në mes të shtatorit 2023.[406]

Një dokumentar i shkurtër i titulluar "Vrasja në Tetovë", i përgatitur nga Laboratori për Gazetari Hulumtuese (IRL), zbuloi se tenderi fillestar për zgjedhjen e një kontraktori spitalor modular gjatë pandemisë Covid-19 u anulua për shkak të dyshimit për mospërputhje procedurale dhe favorizim. Më pas prokurimin Qeveria ia ka besuar Ministrisë së Shëndetësisë. Dokumentet e paraqitura në film sugjerojnë se si Ministria e Shëndetësisë ashtu edhe kontraktori i përzgjedhur ishin të njohur me ndërtesat me cilësi të dobët, të cilat më vonë u dogjën.[407] PPRMV paralajmëroi për përhapjen e informacionit potencialisht të rremë dhe i bëri thirrje gazetarisë së përgjegjshme për shkak të ankesave të vazhdueshme dhe lëndëve të hapura që mund të ndikohen negativisht.[408] Ndërkohë, Platforma Kundër Korrupsionit kërkoi dorëheqjen e Prokurorit Publik të Prokurorisë Publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut, duke përmendur dyshimet e iniciuara nga filmi se hetimi i Prokurorisë Publike mund të mos ketë tërësi dhe shqyrtimin e duhur të gjetjeve të ekspertëve.[409]

402 Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për marrëdhëniet e punës; Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për shpronësimin; Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për ndërtimin; Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për planifikimin urban dhe ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për përcaktimin e interesit publik dhe për emërimin e partnerit strategjik për zbatimin e projektit për ndërtimin e korridorit 8 (pjesa: Projekti i autostradës Tetovë-Gostivar-Bukojqani dhe Trebenishta-Strugë-Qafasan) dhe korridorit 10 g (pjesë e autostradës Prilep-Manastir) në Republikën e Maqedonisë së Veriut, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr. 111/2023.

403 "Grubi: Pesë projektligje të reja për korridoret 8 dhe 10 d, varet nga deputetët nëse do të jetë më e shpejtë dhe më e lirë ose më e ngadaltë dhe më e shtrenjtë", („Груби: Нови пет предлог-закони за коридорите 8 и 10 д, од пратениците зависи дали ќе биде побрза и поевтина и побавна и поскапа"), Brif.mk, 5 maj 2023, https://www.brif.mk/grubi-novi-pet-predog-zakoni-za-koridorite-8-i-10d-od-pratenicite-zavisi-dali-izgradbata-ke-bide-pobrza-i-poevtina-ili-pobavna-i-poskapa/.

404 "Nga Delegacioni i BE-së: për 'Slloboden Peçat': Flamuri evropian në projektligjet për korridoret nuk është i justifikuar", („Од Делегацијата на ЕУ: за 'Слободен печат': Не е оправдано европското знаме на предлог-законите за коридорите"), Slloboden Peçat, 5 maj 2023, https://www.slobodenpecat.mk/od-delagacijata-na-eu-za-sloboden-pechat-ne-e-opravdano-evropskoto-zname-na-predlog-zakonite-za-koridorite/.

405 "Nënshkruhet kontrata me Behtel dhe Enka për korridoret 8 dhe 10-d: Për Qeverinë, ky është një projekt historik", („Потпишан договорот со 'Бехтел и Енка' за коридорите 8 и 10-д: За Владата ова е историски проект"), 360 stepeni, 8 mars 2023, https://360stepeni.mk/video-potpishan-dogovorot-so-behtel-i-enka-za-koridorite-8-i-10-d-za-vladata-ova-e-istoriski-proekt/.

406 "'Behtel dhe Enka' filluan punën ndërtimore në Korridorin 8", („'Бехтел и Енка' почна со градежните работи на Коридорот 8"), 360 stepeni, 12 shtator 2023, https://360stepeni.mk/behtel-i-enka-pochna-so-gradezhnite-raboti-na-koridorot-8/.

407 "Dokumentari IRL rindezi zjarrin për tragjedinë në spitalin modular në Tetovë", („Документарецот на ИРЛ повторно го распламте огнот за трагедијата во модуларната болница во Тетово"), 360 stepeni, 14 gusht 2023, https://360stepeni.mk/video-dokumentaretsot-na-irl-povtorno-go-rasplamte-ognot-za-tragedijata-vo-modularnata-bolnitsa-vo-tetovo/.

408 "PP për regjistrimin audio të IRL: Urgjentisht të ndalohet abuzimi i këtij procesi, është gënjeshtër që ekspertiza e ekspertëve gjermanë u mbulua", („ЈО за аудиоснимката од ИРЛ: Итно да престане злоупотребата на овој процес, лага е дека била прикриена експертизата од германските стручни лица"), 360 stepeni, 18 gusht 2023, https://360stepeni.mk/jo-za-audiosnimkata-od-irl-itno-da-prestane-zloupotrebata-na-ovoj-protses-laga-e-deka-bila-prikriena-ekspertizata-od-germanskite-struchni-litsa/.

409 "Platforma Kundër Korrupsionit kërkon dorëheqjen e Prokurorit Publik Ljubomir Joveski", („Платформата за борба против корупција бара оставка од јавниот обвинител Љубомир Јовески"), TV 21, 17 gusht 2023, https://en.tv21.tv/platformata-za-borba-protiv-koruptsija-bara-ostavka-od-javniot-obvinitel-lubomir-joveski/.

PTHPNKOK mbylli lëndët e hapura[410] kundër ish-drejtorit të Drejtorisë të Policisë Financiare (DPF), pasi konstatoi se i pandehuri nuk ka kryer krimet e shpërdorimit të detyrës, ryshfetit, dhunës dhe ngacmimit.[411] Ish-drejtori i liruar akuzoi ish-kreun e PTHPNKOK për shpërdorim detyre të prokurorit publik në këto lëndë dhe njoftoi padi civile ndaj saj për dhënie informacioni të rremë dhe shpifje ndaj tij.[412]

Më 29 qershor 2023, një ish-kryetar bashkie dhe disa të tjerë u ndaluan në hetimin "Feniks" për pastrim parash në prokurimin publik të monumenteve.[413] Ndër të dyshuarit janë përfaqësues të qeverisë,[414] dhe gjykata ka caktuar masën e paraburgimit për disa prej tyre.[415]

410 "Cili do të jetë rezultati i betejës së Muaremit me Ruskovskën dhe Stafën", („Каква разврска ќе има битката на Муареми со Русковска и Стафа"), Evropa e Lirë, 29 korrik 2022, https://bit.ly/3ryiXQX.

411 "PTHPNKOK mbylli lëndët për Arafat Muaremin të hapura në mandatin e shefes të mëparshme Ruskovska", („ОЈОГОКК ги затвори предметите за Арафат Муареми отворени во мандатот на претходната шефица Русковска"), 360 stepeni, 9 qershor 2023, https://360stepeni.mk/ojo-gokk-gi-zatvori-predmetite-za-arafat-muaremi-otvoreni-vo-mandatot-na-prethodnata-shefitsa-ruskovska/?fbclid=IwAR0_HzGmnPF56dxX-RuFJmRUckIDUCMO-uhJ7m-mDzHH0LqjksR6Gi7Y.

412 "Muaremi padit Ruskovskën", („Муареми ја тужи Русковска"), Sitell TV, 10 qershor 2023, https://sitel.com.mk/muaremi-ja-tuzhi-ruskoska.

413 "Todorovikj dhe një duzinë të tjerë të ndaluar në aeroportin e Shkupit", („Тодоровиќ и уште десетина лица приведени на скопскиот аеродром"), Shkup info, 30 qershor 2023, https://bit.ly/3FL0Fjl.

414 "Feniks": Monumentet nga 'Shkupi 2014' janë paguar në mënyrë drastike më shtrenjtë se çmimet për të cilat janë bërë në Itali", („'Феникс': Споменици од 'Скопје 2014' биле плаќани драстично поскапо од цените за кои биле направени во Италија"), 360 stepeni, 30 qershor 2023, https://360stepeni.mk/video-feniks-spomenitsi-od-skopje-2014-bile-plakani-drastichno-poskapo-od-tsenite-za-koi-bile-izleani-vo-italija/.

415 "Ndalimi i Vlladimir dhe Aleksandar Zdravev, të dyshuar për pastrim parash nga monumentet e 'Shkupi 2014', ish-kryetari Todoroviq mori arrest shtëpie", („Притвор за Владимир и Александар Здравев, осомничени за перење пари од споменициte од 'Скопје 2014', поранешниот градоначалник Тодоровиќ доби куќен притвор") Sakam da kazam, 30 qershor 2023, https://bit.ly/3OhYCIl.

# KUADRI LIGJOR

Në shkurt 2023, u miratuan ndryshimet në Kodin Penal, duke futur krime të reja në lidhje me dhunën me bazë gjinore, duke reformuar konfiskimin e pasurisë dhe duke përshtatur aktet për sigurinë e gazetarëve.[416] Megjithatë, gjashtë muaj më vonë pasoi një ndryshim i ri në Kodin Penal, i cili zvogëloi dënimet për krimet e shpërdorimit të detyrës dhe autorizimit dhe shoqërimit kriminal,[417] i cili ngriti shqetësime për shkak të procesit të përshpejtuar legjislativ dhe përdorimit të flamurit evropian pa zhvilluar një diskurs publik gjithëpërfshirës, debat ekspertësh ose analizë të pasojave të mundshme.[418]

Në nëntor 2022, u publikua projekt-verzioni i Ligjit të ri për Procedurën Penale, që synon harmonizimin me direktivat e reja të BE-së në lidhje me të drejtën e interpretimit dhe përkthimit në procedurat penale, mbrojtjen e të dhënave personale gjatë bashkëpunimit në çështjet penale dhe mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave të krimeve.[419]

Në prill 2023, filloi debati në Kuvend për projektligjin për luftën kundër formave të rënda të krimit të organizuar dhe korrupsionit të profilit të lartë, i cili parashikon krijimin e një agjencie të pavarur për luftën kundër krimit të organizuar.[420]

Megjithëse ekzistojnë mekanizma të caktuar për zbulimin e pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme, projekt-ligji për origjinën e pasurisë nuk është publikuar ende.[421]

416 Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Penal, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut", nr. 36/2023.

417 Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Penal, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut", nr. 188/2023.

418 "Komisioni Evropian është i shqetësuar për ndryshimet në Kodin Penal", („Европската комисија е загрижена поради измените на Кривичниот законик"), Evropa e Lirë, 12 shtator 2023, https://www.slobodnaevropa.mk/a/32589801.html.

419 Ministria e Drejtësisë, "Projektligji për Procedurën Penale", („Предлог на Законот за кривичната постапка"), ENER, 9 nëntor 2022, https://ener.gov.mk/Default.aspx?item=pub_regulation&subitem=view_reg_detail&itemid=76038.

420 "Kuvendi duhet të fillojë sot me debat për themelimin e Agjencisë për Luftimin e Korrupsionit të Lartë", („Собранието денеска треба да почне со расправа за формирање на Агенција за борба против висока корупција"), Tellma TV, 19 prill 2023, https://telma.com.mk/2023/04/19/sobranieto-deneska-treba-da-pochne-so-rasprava-za-formiranje-na-agencija-za-borba-protiv-visoka-korupcija/.

421 „Tupançeski: Ekzistojnë instrumente dhe mekanizma për vërtetimin dhe zbulimin e gjendjes së pasurisë të përfituar në mënyrë të paligjshme", („Тупанчески: Постојат инструменти и механизми за докажување и откривање на состојбата со незаконски стекнатиот имот"), faqja zyrtare e Ministrisë së Drejtësisë, 25 tetor 2022, https://pravda.gov.mk/vest/6430.

Lufta e suksesshme kundër korrupsionit dhe progresit kërkon ndjekjen e rekomandimeve të KE-së;

Është e rëndësishme të mbështeten përpjekjet e institucioneve shtetërore për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Luftimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit;

Zbatimi i rekomandimeve të GRECO-s është thelbësor, siç është sigurimi i burimeve të mjaftueshme për KSHPK-në dhe PTHPNKOK, duke përfshirë pavarësinë financiare, për të siguruar llogaridhënie efektive për rastet e korrupsionit të lartë;

Është e nevojshme të punohet në përmirësimin e personelit dhe pajisjeve teknike të prokurorive publike, si dhe të bëhet përparim në krijimin e qendrave të reja hetimore;

Ndryshimet e reja në Kodin Penal duhet të zbatohen me kujdes dhe të monitorohen nëse ato do të ndikojnë negativisht në rezultatin e rasteve të larta të korrupsionit;

Është e nevojshme të miratohen ligje dhe procese të reja për të luftuar krimin e organizuar dhe korrupsionin, si dhe të përgatitet një ligj për origjinën e pasurisë.



# 3. Të drejtat themelore

Ndërsa mund të vërehet një përparim në fushën e të drejtave themelore në Republikën e Maqedonisë së Veriut, problemet e mëposhtme janë ende të pranishme, të cilat vërehen edhe nga Raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit: trajtimi çnjerëzor dhe degradues dhe mbipopullimi në disa objekte burgu, dhuna dhe kërcënimet për dhunë ndaj gazetarëve, mungesa e llogaridhënies për dhunën me bazë gjinore dhe në familje, dhe krimet e dhunës dhe kërcënimet ndaj personave nga komuniteti LGBTI+.[422]

422 Departamenti Amerikan i Shtetit, 'Raporti i Gjendjes së të Drejtave të Njeriut për Maqedoninë e Veriut 2022', 21 mars 2023, https://www.state.gov/reports/2022-country-reports-on-human-rights-practices/north-macedonia/.

# PRAKTIKA GJYQËSORE E GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAVE TË NJERIUT

Gjatë vitit 2022, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) vendosi për 314 kërkesa kundër Maqedonisë së Veriut, prej të cilave 302 u refuzuan ose u shpallën si të papranueshme. Gjykata dha gjashtë vendime në katër raste, duke gjetur shkelje të së drejtës për një gjykim të drejtë, të mbrojtur nga neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.[423] Në shtatë muajt e parë të vitit 2023, GJEDNJ vendosi për 163 kërkesa kundër Maqedonisë së Veriut.[424]

Në gjysmën e parë të vitit 2023, Byroja për Përfaqësim e Republikës së Maqedonisë së Veriut para GJEDNJ-së publikoi Raportin vjetor për punën e saj në vitin 2022,[425] në të cilën u deklarua se këtë vit vazhdon trendi i rritjes së numrit të kërkesave të paraqitura në GJEDNJ kundër Republikës së Maqedonisë së Veriut, por në vitin 2022 numri i kërkesave kundër shtetit pas të cilit është marrë një vendim është ulur me 54 aplikime. Raporti tregon se, si në vitet e mëparshme, edhe në vitin 2022 ky numër është mbi mesataren evropiane sipas indeksit të aplikimeve të paraqitura për 10 mijë banorë, që është 2.00 në vend dhe 0.54 në nivel europian.[426] Njëkohësisht është publikuar edhe Raporti Vjetor për punën e Komisionit Ndërinstitucional për Ekzekutimin e Vendimeve të GJEDNJ për vitin 2022.[427]

Në një nga rastet kundër Republikës së Maqedonisë së Veriut para Gjykatës, kërkuesja Dimçevska u ankua se ajo nuk arriti të fitojë një rigjykim pasi u dënua në mungesë. GJEDNJ konstatoi se asaj nuk i ishte dhënë një mundësi mjaft e sigurt për të marrë një vendim të ri nga gjykata për thelbin e akuzave kundër saj dhe e drejtë e plotë e mbrojtjes, duke rezultuar në shkelje të së drejtës së saj për një gjykim të drejtë.[428]

Në një rast tjetër, paditësit Kitanovska dhe Barbullovski u ankuan për refuzimin e apeleve të tyre kundër urdhërpagesave nga gjykata. GJEDNJ pranoi pjesërisht ankimin për qasjen në gjykatë, duke konstatuar shkelje të të drejtave të tyre.[429]

423 Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut – Përmbledhje e shkurtër për Vendin (2023), https://echr.coe.int/Documents/CP_Republic_of_North_Macedonia_ENG.pdf, aksesuar më 19 shkurt 2022.
424 Ibid.
425 Ministria e Drejtësisë, "Raporti vjetor për punën e Byrosë së Përfaqësimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut para GJEDNJ-së për vitin 2022", („Годишен извештај за работата на Бирото за застапување на РСМ пред ЕСЧП за 2022 година"), maj 2023, https://bit.ly/48e4quu.
426 Ibid.
427 Ministria e Drejtësisë, "Raporti vjetor për punën e Komisionit ndërministror për zbatimin e vendimeve të GJEDNJ-së për vitin 2022", („Годишен извештај за работата на Меѓуресорската комисија за извршување на одлуките на ЕСЧП за 2022 година"), maj 2023, https://bit.ly/3LoqpFp.
428 GJEDNJ, "Çështja Dimçevska kundër Maqedonisë së Veriut", Kërkesa nr. 13919/18, 4 prill 2023, https://bit.ly/43HqGK6.
429 GJEDNJ, "Çështja e Kitanovska dhe Barbulovski kundër Maqedonisë së Veriut", Kërkesat nr. 53030/19 dhe 31378/20, 9 maj 2023, https://hudoc.echr.coe.int/eng# {%22itemid%22:[%22001-224560%22]}.

Në mes të korrikut 2023, GJEDNJ vendosi në rastin e D.H. dhe të tjerëve kundër Republikës së Maqedonisë së Veriut, që është një rast i rëndësishëm për të drejtat e punonjësve të seksit në vend. Në këtë rast, kërkuesit kanë paraqitur kërkesa për verifikimin e ligjshmërisë së heqjes së lirisë. Ata pretenduan se ishin ndaluar në mënyrë të pajustifikuar; se nuk ishin informuar për arsyet e arrestimit të tyre; se nuk ishin pajisur me të dhëna zyrtare të sendeve të sekuestruara; se nuk ishin siguruar me ushqim, ujë dhe përdorim të tualetit; se nuk u ishte dhënë kujdes mjekësor dhe se mostrat e gjakut ishin marrë prej tyre pa urdhër gjykate. Mbi bazën e këtyre pretendimeve, GJEDNJ vendosi se ka pasur shkelje të nenit 3 dhe nenit 8 të GJEDNJ-së dhe vendosi që shteti duhet të kompensojë paditësit.[430]

430 GJEDNJ, "Çështja D.H. dhe të tjerët kundër Maqedonisë së Veriut", Kërkesa Nr. 44033/17, 18 korrik 2023, https://bit.ly/3LBRUv2.

# AVOKATI I POPULLIT

Sipas të dhënave në Raportin Vjetor për vitin 2022, Avokati i Popullit në vitin paraprak ka proceduar/shqyrtuar gjithsej 3,482 parashtresa, nga të cilat 3,209 parashtresa janë nga viti 2022, ndërsa 273 lëndët e tjera janë transferuar nga viti paraprak. Nga numri i përgjithshëm i parashtresave, Avokati i Popullit ka iniciuar procedura në 2.173 raste (ose 62,41%). Në këtë vit raportues, numri më i lartë i shkeljeve të raportuara ka qenë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve (103 raste), në fushën e drejtësisë (89 raste), në fushën e kushteve civile dhe punëve të tjera të brendshme (58 raste), të drejtat e konsumatorit (53 raste), mbrojtja sociale (47 raste), mbrojtja e të drejtave që rrjedhin nga marrëdhëniet e punës (44 raste), sigurimi pensional dhe invalidor (42 raste) dhe të tjera.[431]

Në Raportin Vjetor 2022 të Mekanizmit Kombëtar Parandalues,[432] Avokati i Popullit theksoi problemet urgjente të pranishme në spitalet psikiatrike dhe institucionet ndëshkuese-korrektuese dhe shprehu shqetësimin për higjienën e dobët dhe praninë e pajisjeve të torturës në spitalet psikiatrike në Shkup dhe Demir Hisar.[433] U theksua se nuk ka punonjës të mjaftueshëm. Në burgun e Idrizovës u konstatuan kushte çnjerëzore, mbipopullim dhe mungesë e personelit të burgut, përfshirë personelin mjekësor. Ka shembuj të të burgosurve që ndajnë një krevat dhe flenë në tokë, me qasje të kufizuar në strukturat adekuate sanitare.[434]

Në nëntor 2022, Avokati i Popullit publikoi Raportin për Monitorimin e Zbatimit të Parimit të Përfaqësimit të Përshtatshëm dhe të Barabartë për vitin 2021.[435] Sipas tij, ky vit raportues, krahasuar me vitin e kaluar, ka pasur një rënie të përqindjes së komunitetit shumicë me 5% ndërsa rritje më të madhe prej 4% është regjistruar nga komuniteti shqiptar. Megjithatë, Avokati i Popullit përsëri theksoi se ka institucione në të cilat komunitetet më të vogla nuk janë të

431 Avokati i Popullit i Republikës së Maqedonisë së Veriut, "Raporti vjetor për shkallën e sigurimit të respektimit, promovimit dhe mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të njeriut 2022", („Годишен извештај за степенот на обезбедување почитување, унапредување и заштита на човековите слободи и права 2022"), mars 2023,https://ombudsman.mk/CMS/Upload/NarodenPravobranitel/upload/Godisni %20izvestai/GI-2022/GI-2022.pdf.

432 Avokati i Popullit i Republikës së Maqedonisë së Veriut, "Raporti vjetor i Mekanizmit Kombëtar Parandalues për vitin 2022", („Годишен извештај на националниот превентивен механизам за 2022 година"), 26 qershor 2023, https://bit.ly/3K2ldWN.

433 "Në një spital psikiatrik në Demir Hisar, Avokati i Popullit gjeti rripa fiksues, zinxhirë me dryna dhe një kordon të trashë", („Во психијатриска болница во Демир Хисар Народниот правобранител нашол каиши за врзување, синџири со катанци и дебел кабел"), Sakam da Kazam, 26 qershor 2023, https://sdk.mk/index.php/makedonija/vo-psihijatriskata-bolnitsa-demir-hisar-narodniot-pravobranitel-nashol-kaishi-za-vrzuvane-sindhiri-so-katantsi-i-debel-kabel/.

434 "Kushte të këqija dhe trajtim çnjerëzor në spitalet psikiatrike dhe burgjet, konstanton Avokati i Popullit", („Лоши услови и нечовечки третман во психијатриските болници и затворите констатира омбудсманот"), Evropa e Lirë, 26 qershor 2023, https://www.slobodnaevropa.mk/a/32476533.html.

435 Avokati i Popullit i Republikës së Maqedonisë së Veriut "Raport për monitorimin e zbatimit të parimit të përfaqësimit adekuat dhe të barabartë për vitin 2021", („Извештај за следењето на примената на начелото на соодветна и правична застапеност за 2021 година"), nëntor 2022, https://bit.ly/3PCPhf0.

përfaqësuara fare, dhe në veçanti i bëri thirrje MANU-së, Gjykatës së Lartë Administrative dhe Këshillit të Prokurorëve Publikë që të zbatojnë planet vjetore të punësimit duke zbatuar parimin e përfaqësimit adekuat dhe të barabartë. Me krijimin e Ministrisë së re të Sistemit Politik dhe Marrëdhënieve Ndëretnike, Raporti vëren një ndryshim në raportin e përfaqësimit në favor të komuniteteve më të vogla krahasuar me komunitetin shumicë me 3.2%.[436]

Avokati i Popullit dhe Komisioni për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi (KPMD) nënshkruan një Memorandum Bashkëpunimi, i cili thekson angazhimin e të dy palëve për të punuar së bashku për të promovuar dhe mbrojtur të drejtat e të gjithë qytetarëve.[437]

## TORTURA OSE LLOJ TJETËR I TRAJTIMEVE OSE DËNIMEVE MIZORE, ÇNJERËZORE OSE POSHTËRUESE

Gjatë vitit 2022, Avokati i Popullit ka vepruar mbi 11 parashtresa për torturë, trajtim çnjerëzor dhe johuman nga punonjësit e policisë dhe pjesëtarët e policisë së burgjeve.[438] Nga parashtresat e paraqitura, dy kishin të bënin me përdorimin e forcës së tepruar dhe abuzimin fizik të kryer nga anëtarët e policisë së burgjeve, dhe nëntë kishin të bënin me malltretim gjatë kryerjes së detyrës nga punonjësit e policisë.[439] Gjatë procedurës, Avokati i Popullit paraqiti tre kërkesa për përcaktimin e përgjegjësisë penale, me ç'rast u lëshua një dënim përfundimtar për njërën nga ato kërkesa nga Gjykata Themelore Penale Shkup, me ç'rast i pandehuri u shpall fajtor për një vepër penale, malltretim në kryerjen e detyrës, ndërsa për rastet e mbetura procedura është në vazhdim.

Gjatë vitit 2022, Departamenti për Kontroll të Brendshëm, Hetime Kriminale dhe Standarde Profesionale në Ministrinë e Punëve të Brendshme (MPB) ka marrë masa për shqyrtimin e gjithsej 1.269 rasteve të pretenduara për keqpërdorim të autoritetit dhe keqpërdorim të pozitës dhe autoritetit të zyrtarëve, nga të cilat janë ngritur padi penale për katër vepra

436 Ibid.
437 "Nënshkruhet Memorandum Bashkëpunimi me Komisionin për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi", („Потпишан Меморандум за соработка со Комисијата за спречување и заштита од дискриминација"), faqja zyrtare e Avokatit të Popullit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 7 mars 2023, https://bit.ly/3MIElkN.
438 Avokati i Popullit i Republikës së Maqedonisë së Veriut, "Raporti vjetor për shkallën e sigurimit të respektimit, promovimit dhe mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të njeriut 2022", („Годишен извештај за степенот на обезбедување почитување, унапредување и заштита на човековите слободи и права 2022), mars 2023,https://ombudsman.mk/CMS/Upload/NarodenPravobranitel/upload/Godisni %20izvestai/GI-2022/GI-2022.pdf.
439 Ibid.

të malltretimit në kryerjen e detyrës.[440] Për krahasim, në nëntë muajt e parë të vitit 2023, Departamenti ka marrë masa për të hetuar gjithsej 866 raste të pretenduara të sjelljeve të paligjshme, joprofesionale dhe joetike të punonjësve të Ministrisë, dy prej të cilave i referohen malltretimeve në kryerjen e detyrës.[441]

Në fund të vitit 2022, Gjykata dënoi dy punonjës të policisë të cilët u shpallën fajtorë për malltretim gjatë kryerjes së detyrës. Dy policët iu afruan një personi dhe i kërkuan letërnjoftim. Personi u përgjigj, pas së cilës e kontrolluan vrazhdë dhe e goditën në kokë. Pastaj e prangosën dhe filluan ta godasin përsëri, pas së cilës morën të dëmtuarin për ta çuar në stacion policor.[442] Të dy policët u dënuan me një vit burg dhe u pezulluan për tre vjet.

Prej tre vitesh në Drejtorinë për Zbatimin e Sanksioneve nuk është paraqitur asnjë parashtresë për torturë dhe trajtim çnjerëzor nga ana e një personi të dënuar.[443]

440 Ministria e Brendshme, "Raport mbi funksionimin e Departamentit të Kontrollit të Brendshëm, Hetimeve Penale dhe Standardeve Profesionale në vitin 2022", („Извештај за работата на Одделот за внатрешна контрола, криминалистички истраги и професионални стандарди во 2022 година"), janar 2023, https://bit.ly/40iZkcP.

441 Ministria e Brendshme, "Raport mbi funksionimin e Departamentit të Kontrollit të Brendshëm, Hetimeve Penale dhe Standardeve Profesionale në nëntë muajt e parë të vitit 2023", („Извештај за работата на Одделот за внатрешна контрола, криминалистички истраги и професионални стандарди во првите девет месеци од 2023 година"), 25 tetor 2023, https://mvr.gov.mk/Upload/Editor_Upload/png2pdf.pdf.

442 Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut i Republikës së Maqedonisë së Veriut, "Vendimi i ri gjyqësor që sanksionon brutalitetin policor", („Нова судска одлука што ја санкционира полициската бруталност"), 19 dhjetor 2022, https://mhc.org.mk/news/nova-sudska-odluka-shto-ja-sankcioni-ra-policiskata-brutalnost/.

443 Shoqata e Maqedonase e Jursitëve të Rinj, "Raporti vjetor mbi efektivitetin e mbrojtjes ligjore të të drejtave të njeriut në Republikën e Maqedonisë së Veriut – 2022", („Годишен извештај за ефикасноста на правната заштита на човековите права во Република Северна Македонија – 2022 година"), dhjetor 2022, https://myla.org.mk/wp-content/uploads/2022/12/MYLA-Annual-Report-2022-WEB_compressed.pdf.

# BURGJE DHE PARABURGIME

Në mes të shtatorit 2023, Ministria e Drejtësisë (MD) hartoi një projektligj të ri për amnistinë që synon zbutjen e situatës alarmante në burgjet e vendit, gjë që është theksuar në raporte të shumta ndërkombëtare, përfshirë ato të Këshillit të Evropës.[444] Projektligji propozon lirimin e plotë të të dënuarve deri në gjashtë muaj burg, ndërsa të dënuarit me më shumë se gjashtë muaj burg propozohet të lirohen nga vuajtja e 30 përqind të të gjithë dënimit.[445] Më 26 shtator, projektligji u miratua në Qeveri, pas së cilës hyri në procedurë parlamentare.[446]

Në të njëjtën kohë, Qeveria miratoi ndryshimet në ligjin për arsimin fillor, me qëllim të ofrimit të arsimit të rregullt për të miturit në institucionet edukative-korrektuese dhe ndëshkuese-korrektuese. Këto ndryshime janë bërë me qëllim respektimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit[447] dhe KPMD-së.[448]

Pas rekomandimit të Avokatit të Popullit pas vizitës në Burgun e Idrizovës,[449] Ministri i Drejtësisë konfirmoi se vajzat e mitura që vuajnë dënimet në atë institucion do të transferohen në Institucionin Korrektues të Vollkovës.[450]

Në të njëjtën kohë, KPMD nxori rekomandime të përgjithshme për përgatitjen e planeve të veprimit për rindërtimin ose ndërtimin e institucioneve të hapura dhe gjysmë të hapura për të dënuarit, pasi të gjitha gratë e dënuara në vend vuajnë dënime me burg vetëm në insitucionin ndëshkues-korrektues të Idrizovës. Kjo situatë i vendos gratë në një pozitë të pabarabartë, në

444 "Ministria e Drejtësisë ka përgatitur një projektligj për amnisti: autorët e krimeve të lehta do të lirohen nga burgu ose do të marrin dënime më të vogla", („Министерството за правда го подготви предлог-законот за амнестија: сторителите на лесни кривични дела ќе се ослободат од затвор или ќе добијат помали казни"), 360 stepeni, 13 shtator 2023, https://360stepeni.mk/pravda-go-podgotvi-predlog-zakonot-za-amnestija-storitelite-na-lesni-krivichni-dela-ke-se-oslobod-od-zatvor-ili-ke-dobijat-pomali-kazni/.

445 "Lloga: Situata në burgje është alarmante, kërkoj nga të gjitha partitë politike të mbështesin projektligjin për amnisti", („Лога: Состојбата во затворите е алармантна, ги замолувам сите политички партии да го поддржат предлог-законот за амнестија"), 360 stepeni, 14 shtator 2023, https://360stepeni.mk/loga-sostojbata-vo-zatvorite-e-alarmantna-gi-zamoluvam-site-politichki-partii-da-go-poddrzhat-predlog-zakonot-za-amnestija/.

446 "Ligji për amnistinë ka kaluar filtrin qeveritar, nesër hyn në procedurë parlamentare", („Законот за амнестија го помина владиниот филтер, утре влегува во собраниска процедура"), Kanall 5, 26 shtator 2023, https://kanal5.com.mk/zakonot-za-amnestija-go-pomina-vladiniot-filter-utre-vleguva-vo-sobraniska-procedura/a602552.

447 "Për të njëjtën masë, djemtë në institucione ndëshkuese-korrektuese, vajzat në burg", („За истата мерка, момчињата во казнено-поправниот дом, девојчињата во затвор"), 24 Vesti, 2 prill 2022, https://24.mk/details/za-ista-merka-momchinjata-vo-vospitno-popraven-dom-devojchinjata-vo-zatvor.

448 "KPMD me rekomandim të përgjithshëm për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës dhe Drejtorinë për Zbatimin e Sanksioneve për Ofrimin e Arsimit të Detyrueshëm në Institucionet Edukative-Korrektuese dhe në shtëpitë ndëshkuese-korrektuese", („КСЗД со општа препорака кон МОН и Управата за извршување санкции за обезбедување задолжително образование во воспитно-поправните установи и казнено-поправните домови"), faqja zyrtare e Komisionit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi, 29 mars 2023, https://bit.ly/3nQdtyY.

449 "Për të njëjtën masë, djemtë në institucione edukative-korrektuese, vajzat në burg", („За иста мерка, момчињата во воспитно-поправен дом, девојчињата во затвор"), 24 Vesti, 2 prill 2022, https://24.mk/details/za-ista-merka-momchinjata-vo-vospitno-popraven-dom-devojchinjata-vo-zatvor.

450 "Ministria e Drejtësisë, "Tupançeski: Të miturit të cilëve u është shqiptuar masa 'dërgim në institucion edukativ-korrektues' atë do ta mbajnë në "Vollkovia", („Тупанчески: Во 'Волковија' ќе се издржува мерката 'упатување во ВПД' за малолетничките на кои име е изречена"), faqja zyrtare e Ministrisë së Drejtësisë, 20 tetor 2022, https://pravda.gov.mk/vest/6424.

krahasim me të dënuarit meshkuj, të cilët kanë mundësi të vuajnë dënimet në institucionet e tjera ndëshkuese gjysmë të hapura dhe të hapura.[451]

KPMD gjithashtu publikoi një mendim dhe një rekomandim tjetër të përgjithshëm për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës (MASH) për diskriminimin e kryer ndaj fëmijëve që i nënshtrohen masave korrektuese në Institucionin Edukativ-Korrektues në Tetovë. Konkretisht, KPMD përcaktoi diskriminim të drejtpërdrejtë dhe të vazhdueshëm nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës sepse institucioni nuk kishte qasje në arsimin e detyrueshëm. Rekomandimi i përgjithshëm kërkon që Ministria e Arsimit dhe Shkencës të bashkëpunojë me Drejtorinë e Zbatimit të Sanksioneve për të siguruar qasje sistematike, të qëndrueshme dhe të vazhdueshme në arsimin e detyrueshëm për të gjithë personat e dënuar ose fëmijët gjatë vuajtjes të dënimeve me burg ose masave edukative-korrektuese.[452]

Më 12 qershor 2023, u botuan ndryshimet në Rregulloren për vendosjen dhe klasifikimin e të dënuarve në institucionet ndëshkuese-korrektuese, me qëllim që gratë që vuajnë dënimet me burg të kenë të njëjtat të drejta dhe përfitime si burrat.[453] Zbatimi i ndryshimeve filloi menjëherë, me pesë kërkesa të paraqitura nga të dënuarit për përdorimin e përfitimeve në dy javët e para,[454] pas botimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Në fillim të vitit 2023, Drejtoria e Zbatimit të Sanksioneve zbatoi masa dhe aktivitete për krijimin, zhvillimin dhe promovimin e një shërbimi të provës.[455] Drejtuesit njoftuan se ata krijuan një shërbim funksional të provës në vend me gjithsej 11 zyra funksionale të provës, për fushat e gjykatave themelore në Shkup, Kumanovë, Tetovë, Manastir, Shtip, Veles, Strumicë, Ohër, Prilep, Kavadar dhe Gjevgjeli dhe gjithsej 33 oficerë të provës ishin të angazhuar në Sektorin e Provës. Të dhënat e tyre tregojnë se numri i lëndëve po rritet çdo vit. Ndërsa numri i rasteve të provës në vitin 2019 ka qenë 165, në vitin 2020 ka qenë 276. Në vitin 2021 ishin 451 dhe në

451 "Rekomandim i përgjithshëm", („Општа препорака"), Komisioni për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi, 23 mars 2023, https://bit.ly/3UxOddn.

452 "KPMD me rekomandim të përgjithshëm për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës dhe Drejtorinë për Zbatimin e Sanksioneve për Ofrimin e Arsimit të Detyrueshëm në Institucionet Edukative-Korrektuese dhe në ato Ndëshkuese-Korrektuese", („КСЗД со општа препорака кон МОН и Управата за извршување санкции за обезбедување задолжително образование во Воспитно-поправните установи и Казнено-поправните домови"), faqja zyrtare e Komisionit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi, 29 mars 2023, https://bit.ly/3nQdtyY.

453 "Rregullore për plotësimin e rregullores për vendosjen, klasifikimin dhe zhvendosjen e personave të dënuar në institucionet ndëshkuese-korrektuese", („Правилник за дополнување на Правилникот за распоредување, класификација и разместување на осудените лица во казнено-поправните установи"), Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr. 120/2023.

454 "Pas gati tre vjetësh, Jankulloska për herë të parë në pushim të fundjavës – pesë gra dolën nga Idrizova me ndryshimin e Rregullores", („По скоро три години, Јанкулоска за првпат на викенд отсуство – пет жени излегоа од 'Идризово' со измената на Правилникот"), Makfaks, 1 korrik 2023, https://bit.ly/3ZuELtq.

455 "Masat dhe aktivitetet e ndërmarra nga Drejtoria e Zbatimit të Sanksioneve me qëllim krijimin, zhvillimin dhe promovimin e shërbimit të provës", („Преземени мерки и активности на Управата за извршување на санкциите во насока на воспоставување, развој и унапредување на пробациската служба"), faqja zyrtare e Zyrës së Ekzekutimit të Sanksioneve, 2 janar 2023, https://bit.ly/40biTTs.

vitin 2022 ishin 475 raste.[456] Për përmirësimin e mëtejshëm të shërbimit të provës në vend, Drejtoria njoftoi bashkëpunimin me institucione të ndryshme shtetërore dhe disa ndryshime ligjore.[457]

Në fillim të dhjetorit 2022, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut (KHDNJ) publikoi raportin e tij mbi situatën dhe kushtet në institucionet ndëshkuese korrektuese dhe shtëpitë korrektuese për vitin 2022.[458] Gjetjet e raportit tregojnë përmirësimin e kushteve materiale në disa institucione ndëshkuese-korrektuese, si dhe përpjekjet për edukimin e stafit, por edhe ekzistencën e mangësive sistemike, siç janë: niveli i ulët i bashkëpunimit multisektorial midis institucioneve kompetente, mungesa e qasjes në kujdesin shëndetësor dhe arsimin, ekzistenca e korrupsionit, kushtet nën standarde të jetesës në disa institucione ndëshkuese-korrektuese, si dhe mungesa e kushteve të përshtatshme për zbatimin e programeve të risocializimit, si dhe aktivitetet e lira dhe profesionale të të dënuarve.

Problemet më serioze në sistemin penitenciar mbeten kushtet e këqija materiale në burgun më të madh "Idrizovë", qasja në kujdesin shëndetësor, korrupsioni, vendosja e stafit joprofesional në pozita menaxheriale dhe drejtorë të institucioneve, si dhe mekanizmat e brendshëm dhe të jashtëm jo mjaftueshëm efektivë për raportimin dhe ndjekjen penale të rasteve të torturës dhe trajtimit çnjerëzor të të dënuarve.[459]

456 Ibid.

457 Ibid.

458 Ina Xhugumanova, "Raport mbi situatën dhe kushtet në institucionet penitenciare dhe institucionin korrektues për vitin 2022", („Извештај за состојбите и условите во казнено-поправните установи и воспитната установа за 2022 година"), Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut i Republikës së Maqedonisë së Veriut, 6 dhjetor 2022, https://mhc.org.mk/wp-content/uploads/2022/12/borba-protiv-tortura-i-nehuman-tretman.pdf.

459 Shoqata Maqedonase e Juristëve të Rinj, «Raporti vjetor mbi efektivitetin e mbrojtjes ligjore të të drejtave të njeriut në Republikën e Maqedonisë së Veriut – 2022», („Годишен извештај за ефикасноста на правната заштита на човековите права во Република Северна Македонија – 2022 година"), dhjetor 2022, https://myla.org.mk/wp-content/uploads/2022/12/MYLA-Annual-Report-2022-WEB_compressed.pdf.

# MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE

Sa i përket numrit të parashtresave, në vitin 2022 janë paraqitur gjithsej 300 parashtresa në Agjencinë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (AMDP), nga të cilat 232 parashtresa (77%) kanë të bëjnë me abuzimin me rrjetet sociale. Të tjerat janë për arsye të tjera, për shembull, marketingu i drejtpërdrejtë, pamundësia për të tërhequr pëlqimin, mos sigurimi i kushteve për ushtrimin e të drejtave të subjekteve, në lidhje me të dhënat personale, e të tjera. Lidhur me abuzimin me rrjetet sociale, shumica e parashtresave i referohen profileve të rreme, ndërhyrjeve të paautorizuara në profile, publikimit të videove dhe incizimeve audio të të tjerëve, fyerjeve, shpifjeve dhe shantazheve në internet. Rrjeti social më i zakonshëm të cilit i referohen parashtresat është Facebook (116), pastaj Instagram (103), ndërsa parashtresat e tjera kanë të bëjnë me YouTube, Tiktok, Twitter, Snapchat dhe të tjera.[460]

Në vitin 2023, Ministria e Brendshme raportoi një rritje të rasteve të keqpërdorimit të të dhënave personale të personave të tjerë për të marrë kredi të shpejta, krahasuar me vitin e kaluar kur u regjistruan 43 raste, ndërsa 76 raste u regjistruan midis 2019 dhe 2021. Megjithëse Ministria e Financave mbikëqyr kompanitë tregtare që punojnë me financa, ajo ende nuk zgjidh parregullsitë që lidhen me keqpërdorimin e të dhënave, duke ia atribuar përgjegjësinë Ministrisë së Brendshme dhe AMDP-së. Ata, nga ana e tyre, deklaruan se softueri i identifikimit në distancë i përdorur nga këto kompani mund të lehtësojë keqpërdorimin e të dhënave dhe u kërkuan personave të raportojnë keqpërdorimin me qëllim të kryhet një hetim.[461] Në këtë drejtim, në fund të korrikut, AMDP vendosi pesë sanksione kundërvajtëse në shumën totale prej 1.318.384 denarë, duke përfshirë një sanksion për një kompani që miratoi kredi online për individët që kanë keqpërdorur të dhënat personale të dikujt tjetër.[462]

KSHPK-ja filloi procedurë kundër dy ish-drejtorëve të Drejtorisë për udhëheqjen e librave amë (DULA) lidhur me dyshimin për tregti me të dhëna personale të shtetasve të Maqedonisë, lidhur me digjitalizimin e miliona dokumenteve në regjistrat e të vdekurve, të lindurve dhe të martuarve. Sipas tyre, në dy procedura tenderimi nuk janë dhënë masat e duhura mbrojtëse për ruajtjen e privatësisë së të dhënave personale të qytetarëve. AMDP kreu një mbikëqyrje të jashtëzakonshme të DULA, ku u konkludua se ata nuk kanë përcaktuar plotësisht proceset dhe procedurat që lejojnë respektimin e rregulloreve për mbrojtjen e të dhënave personale

460 Agjencia për Mbrojtjen e të Dhënave Personale e Republikës së Maqedonisë së Veriut, “Raporti vjetor 2022”, („Годишен извештај за 2022“), 31 mars 2023, https://bit.ly/43hA8oe.

461 “Kredi të shpejta në kurriz të dikujt tjetër”, („Брзи кредити на туѓ грб“), Prizma, 29 maj 2023, https://prizma.mk/brzi-krediti-na-tug-grb/.

462 “Agjencia për Mbrojtjen e të Dhënave Personale vendosi pesë sanksione kundërvajtëse në shumën totale prej 1.318.384 denarë”, („Агенцијата за заштита на личните податоци изрече пет прекршочни санкции во вкупен износ од 1.318.384 денари“), faqja zyrtare e Agjencisë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, 26 korrik 2023, https://bit.ly/3RDPvUy.

në lidhje me menaxhimin me sistemin e mbrojtjes së të dhënave personale dhe në lidhje me sigurinë e të dhënave personale të përpunuara në procesin e digjitalizimit të regjistrave të mbajtura në letër ose në formë elektronike.[463]

Në tetor 2022, AMDP përfundoi me zbatimin e tuining-projektit “Mbështetje për zbatimin e kornizës së modernizuar kombëtare për mbrojtjen e të dhënave personale”, të financuar nga Bashkimi Evropian, objektivi kryesor i të cilit ishte përmirësimi i mbrojtjes së të drejtave themelore të njeriut dhe sistemit për mbrojtjen e të dhënave personale në Republikën e Maqedonisë së Veriut në përputhje me standardet e legjislacionit të Bashkimit Evropian.[464]

Përmes TAIEX, në fund të vitit 2022, AMDP-së iu miratuan një sërë ngjarjesh përmes të cilave do të fillojë përgatitja e Strategjisë së re për Zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (2024-2030), i cili është një dokument kyç për mbrojtjen e të dhënave personale të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe një instrument që do të përshkruajë situatën e sistemit të mbrojtjes së të dhënave personale në nivel kombëtar dhe do të parashikojë një qasje të plotë dhe të modernizuar për mbrojtjen e të drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale.[465]

Është e nevojshme të zbatohen rekomandimet e Avokatit të Popullit për problemet që duhet të trajtohen urgjentisht, dhe janë të pranishme në spitalet psikiatrike dhe institucionet ndëshkuese-korrektuese burgjeve: higjiena e dobët, prania e pajisjeve të torturës në spitalet psikiatrike, mungesa e punonjësve, kushtet çnjerëzore dhe mbipopullimi i burgjeve;

Është e nevojshme t›i sigurohet autonomi financiare Zyrës së Avokatit të Popullit për të përdorur buxhetin e saj pa kërkuar miratimin e Ministrisë së Financave;

Është e nevojshme që gjykatat të ndjekin shembullin pozitiv të Gjykatës Themelore Penale Shkup për caktimin e një dënimi efektiv me burgim për punonjësit e policisë, për malltretim në kryerjen e detyrave zyrtare;

Bashkëpunimi midis institucioneve kompetente është i nevojshëm për të kapërcyer trendin negativ të keqpërdorimit të të dhënave personale të njerëzve të tjerë për të marrë kredi të shpejta.

463 “Informacion mbi mbikëqyrjen e jashtëzakonshme në Drejtorinë për udhëheqjen e librave amë”, („Информација за вонредната супервизија во Управата за водење на матичните книги“), faqja zyrtare e Agjencisë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, 21 korrik 2023, https://bit.ly/3Pya567.

464 Agjencia për Mbrojtjen e të Dhënave Personale të Republikës së Maqedonisë së Veriut, “Përgjigje ndaj kërkesës për qasje të lirë në informacionin publik”, („Одговор по барање за слободен пристап до информации од јавен карактер“), 2 dhjetor 2023.

465 Ibid.

# LIRIA E MENDIMIT, NDËRGJEGJES DHE FESË

Në raportin për Lirinë Fetare në Republikën e Maqedonisë së Veriut të Departamentit të Shtetit për vitin 2022 vërehet se Gjykata Civile Themelore mori gjashtë kërkesa gjatë vitit për regjistrimin e kishave dhe komuniteteve/grupeve fetare. Në dy prej tyre gjykata ka prurë vendim, ndërsa katër të mbeturat janë ende në procedurë.[466] Raporti vuri gjithashtu në dukje se KHDNJ regjistroi 2 incidente të gjuhës së urrejtjes me komponentë fetare gjatë vitit, duke shënuar një rënie të rëndësishme nga viti i mëparshëm.[467]

# LIRIA E SHPREHJES

Më 17 nëntor 2022, Kuvendi miratoi Ligjin e ri për përgjegjësinë civile për shpifje dhe fyerje, i cili zvogëlon dënimet për gazetarët, redaktorët dhe personat juridikë për shpifje dhe fyerje deri në pesë herë në krahasim me ligjin e mëparshëm.[468]

Në gjysmën e dytë të korrikut, u miratuan ndryshimet në Ligjin për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele,[469] në lidhje me financimin e shërbimit publik, Radiotelevizionit të Maqedonisë (RTM) dhe rregullimin e përmbajtjes multimediale, që përmban tekst, audio dhe video, ndërsa portalet e internetit do të mbulohen në aktet nënligjore të ardhshme.[470]

PTHP Shkup emëroi një nga prokurorët e tyre publik si person kontakti në lidhje me rastet që lidhen me sigurinë e gazetarëve, të cilat janë në kompetencë të këtij institucioni.[471] Ky qëndrim synon të shërbejë si një lidhje e drejtpërdrejtë për komunikim midis gazetarëve të

466 Zyra e Lirisë Fetare Ndërkombëtare pranë Departamentit të Shtetit të Shteteve të Bashkuara, "Raport mbi Lirinë Fetare Ndërkombëtare: Maqedonia e Veriut 2022" (2023) <https://www.state.gov/reports/2022-report-on-international-religious-freedom/north-macedonia/>.

467 Ibid.

468 Ligji për përgjegjësinë civile për fyerje dhe shpifje, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr. 251/22.

469 Ligji për ndryshimin e Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr. 154/23.

470 "Nga seanca e 149-të e Qeverisë: Është shtyrë afati për ngrirjen e çmimeve të produkteve të caktuara; është përcaktuar propozimi i Ligjit për ASHMAA; konkluzione në lidhje me lëndën e terminalit në Aleksandropolis", („Од 149. седница на Владата: Продолжен е рокот за замрзнување на цените на определени продукти; утврден е предлогот на Законот за АВМУ; заклучоци околу предметот на терминалот во Александрополис"), faqja zyrtare e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, 25 prill 2023, https://vlada.mk/node/33034.

471 „SHGM: 'Prokuroria Publike Shkup caktoi një prokuror publik si person kontakti për rastet që lidhen me sigurinë e gazetarëve', („ЗНМ: 'ОЈО Скопје назначи јавен обвинител како лице за контакт за предмети поврзани со безбедноста на новинарите'"), faqja zyrtare e Shoqatës së Gazetarëve të Maqedonisë, 4 tetor 2022, https://bit.ly/3QtqZmw.

sulmuar dhe Prokurorisë Publike Shkup dhe të koordinojë procedurat në lidhje me shkatërrimin e pronës që u përket gazetarëve dhe punonjësve të medias, kur lidhet me punën e tyre.[472]

Misioni Ndërkombëtar i Vlerësimit të Situatës së Medias i organizuar nga SHGM shprehu shqetësim për vonesën në emërimin e anëtarëve të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (ASHMAA) dhe të Këshillit të Programit të RTM-së nga Kuvendi. Për shkak të mungesës së konsensusit politik, këto organe aktualisht funksionojnë me anëtarë të cilëve iu ka kaluar mandati, dhe ende punojnë dhe funksionojnë si ushtrues të detyrës.[473]

Republika e Maqedonisë së Veriut ka përmirësuar renditjen e saj sipas Indeksit të Lirisë së Medias të "Gazetarëve pa Kufij". Vendi është aktualisht i 38-ti nga 180 vende, duke u rritur ndjeshëm nga renditja e mëparshme e 57-të. Megjithatë, raporti thekson sfidat, të tilla si dezinformimi i përhapur, mungesa e profesionalizmit dhe besimi i zvogëluar në media, të cilat i ekspozojnë gazetarët e pavarur ndaj kërcënimeve dhe sulmeve. Raporti gjithashtu vë në dukje problemin e vazhdueshëm të sjelljes armiqësore dhe degraduese të zyrtarëve shtetërorë ndaj gazetarëve.[474]

Në periudhën raportuese, SHGM nënshkroi memorandum bashkëpunimi me RTM-në[475] dhe Këshillin Gjyqësor-Mediatik.[476]

472 "Bashkëpunimi i SHGM-së me prokuroren për sulmet mbi gazetarët ka filluar, aktivizohen edhe hetimet e vjetra të pazgjidhura", („Почна соработката на ЗНМ со обвинителката за нападнати новинари, се активираат и старите нерешени истраги"), faqja zyrtare e Shoqatës së Gazetarëve të Maqedonisë, 31 tetor 2022, https://bit.ly/3ivQHKw.

473 Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë, "Liria e medias në Maqedoninë e Veriut: Përparim në këmbë prej qelqi Raport nga Misioni i Vlerësimit të Lirisë së Medias", („Слободата на медиумите во Северна Македонија: Напредок на стаклени нозе Извештај од Мисијата за процена на состојбата со слободата на медиумите"), (2023)<https://znm.org.mk/wp-content/uploads/2023/11/MK-Fact-Finding-PFM-Report-251023-web-final.pdf>.

474 "Maqedonia e Veriut përparon sipas lirisë së medias", („С. Македонија напредува според слободата на медиумите"), Deutsche Welle, 3 maj 2023, https://www.dw.com/mk/s-makedonija-napreduva-spored-slobodata-na-mediumite/a-65500645?maca=maz-rss-maz-pol_makedonija_timemk-4727-xml-mrss.

475 "Memorandum bashkëpunimi midis SHGM-së dhe RTM-së: Trajnime të përhershme për gazetarë dhe kameramanë në shërbimin publik ", („Меморандум за соработка помеѓу ЗНМ и МРТ: Постојани обуки за новинарите и снимателите во јавниот сервис"), faqja zyrtare e Shoqatës së Gazetarëve të Maqedonisë, 15 nëntor 2022, https://bit.ly/3XmEFSx.

476 "Memorandum bashkëpunimi midis SHGM-së dhe Këshillit Gjyqësor-Mediatik", („Потпишан меморандум за соработка помеѓу ЗНМ и Судско-медиумскиот совет"), faqja zyrtare e Shoqatës së Gazetarëve të Maqedonisë, 24 shkurt 2023, https://bit.ly/3lfYY6R.

## Presion mbi gazetarë

Më 13 shkurt 2023, u miratuan ndryshimet e shumëpritura të Kodit Penal,[477] të cilat ofrojnë mbrojtje më të madhe për gazetarët dhe punonjësit e medias, pasi sulmet ndaj tyre do të trajtohen si sulme ndaj persona zyrtarë.[478]

SHGM regjistroi gjithsej shtatë sulme dhe kërcënime më serioze gjatë vitit 2022, gjë që tregon një rritje të lehtë në krahasim me vitin 2021, kur u regjistruan pesë incidente të tilla.[479] Megjithatë, gazetarët dhe punonjësit e medias ende nuk raportojnë një numër të madh incidentesh dhe ndihen të pasigurt për shkak të inercisë së prokurorisë dhe gjyqësorit në zgjidhjen e rasteve të kaluara të sulmeve.[480]

Indeksi i sigurisë së gazetarëve në Ballkanin Perëndimor shënon një rënie të lehtë në krahasim me vitin e kaluar. Nga 3.95 në 2021 në 3.92 në 2022, për shkak të rritjes së numrit të lëndëve gjyqësore për shpifje ose fyerje ndaj gazetarëve dhe mediave në 2022, si dhe rritjes së numrit të sulmeve fizike dhe kërcënimeve ndaj gazetarëve, pasuar nga hetime të ngadalta dhe një shkallë e lartë mosndëshkimi.[481]

Incidentet e shumta midis mediave dhe përfaqësuesve nga Qeveria[482] kulmuan me një marshim proteste për mbrojtjen e dinjitetit gazetaresk të organizuar nga SHGM dhe Sindikata e Pavarur e Gazetarëve dhe Punonjësve Mediatik (SPGPM) në mes të shkurtit 2023. Me këtë rast, gazetarët kërkuan miratimin e menjëhershëm të ligjeve përkatëse, të rëndësishme për të drejtat e tyre dhe për punën e mediave dhe zbatimin e tyre të qëndrueshëm. Përveç kësaj, ata kërkuan që zyrtarët publikë dhe politikanët të respektojnë gazetarët dhe punonjësit e medias, t’i japin fund marrëdhënieve publike agresive shtetërore, më shumë mbështetje për

477 “Kaluan ndryshimet në Kodin Penal”, („Минаа измените на Кривичниот законик“), 24.mk, 13 shkurt 2023, https://24.mk/details/minaa-izmenite-na-krivichniot-zakonik.

478 “Gazetarët kërkojnë miratimin urgjent të ndryshimeve në Kodin Penal për mbrojtjen e tyre më të madhe”, („Новинарите бараат итно усвојување на измените на Кривичниот законик за нивна поголема заштита“), Radio MOF, 2 nëntor 2022, https://www.radiomof.mk/novinarite-baraat-itno-usvojuvanje-na-izmenite-na-krivichniot-zakonik-za-nivna-pogolema-zashtita/.

479 Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë, “Maqedonia e Veriut: Treguesit e shkallës së lirisë së medias dhe sigurisë së gazetarëve 2022”, („Северна Македонија: Показатели за степенот на слобода на медиумите и за безбедноста на новинарите 2022“), (2023)<https://znm.org.mk/wp-content/uploads/2023/03/MK-MK-2022.pdf>.

480 Ibid.

